RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë

të ushtruar në

BASHKINË TEPELENË

Tiranë, 2021

PËRMBAJTJA

SHKURTIME **3**
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE **4**
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit 4
2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore 4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit 15
II. HYRJE **19**
1. Objekti i Auditimit 19
2. Qëllimi i auditimit 19
3. Identifikimi i çështjes 19
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 19
5. Përgjegjësitë e audituesve 20
6. Kriteret e vlerësimit 20
7. Standardet e auditimit 23
8. Metodat e auditimit 23
9. Dokumentimi i auditimit 24
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT **25**
1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Tepelenë 25
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit 28
   2.1. Auditimi mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm 28
   2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit 32
   2.3. Vlerësimi i Raportimit Financiar 48
   2.4. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik 67
   2.5. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme 78
   2.6. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit 90
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET **91**
V. ANEKSET ..... Error! Bookmark not defined.

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare eKontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
Sh.P.K.	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet për një qeverisje të mirë, në përmbushje të objektivave të institucionit të BashkisëTepelenë dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe tëkontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga baza e të dhënave të thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 ñpagaò, 602 ñshpenzime operativeò dhe 230-231 ñinvestimeò, u audituan prokurimet publike të zhvilluara nga Bashkia Tepelenë nga data 01.01.2018 deri në datën 30.06.2020, etj.

2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	Në Bashkinë Tepelenë, për vitin 2020, numri i përgjithshëm i punonjësve dhe niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 91, datë 20.12.2019, e konfirmuar nga Prefekti Gjirokastër me shkresën nr. 1794/1 Prot., datë 06.01.2020, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, në përbërje të së cilës është Sektori i zhvillimit ekonomik, përgjegjës për të ardhurat Vendore. Ky Sektor ka në përbërje 3 punonjës, nga të cilët 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Vendi i Përgjegjësit të sektorit ka qenë vakant për të gjithë periudhën e audituar, duke ndikuar shumë në problematikat e krijuara në lidhje me mënyrën e menaxhimit dhe vjeljes së detyrimeve vendore, përfshirë edhe njoftimet e debitorëve, zbatimin e masave shtrënguese, gjë që ka shkaktuar nivele të larta detyrimesh të paarkëtuara, si nga biznesi, ashtu edhe nga popullata. Në njësitë administrative nuk ka persona të ngarkuar posaçërisht me vjeljen dhe ndjekjen e taksave e tarifave vendore. Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015, ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, neni 9 ñ*Të drejtat dhe përgjegjësitë*ò, pika 1.1, germa c); neni 54 ñ*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*ò, germa ç); neni 64, ñ*Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë*ò, germa j); ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, nenet 1, 2, 7, 42, 54, ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, nenet 2, 4, 5, 13, 15, VKB për miratimin e strukturës dhe pagave në	*Pika 2.2, faqe 30-46*	E lartë	Këshilli Bashkiak, të marrë masat e duhura për të rishikuar organikën, duke krijuar një strukturë të posaçme tatimore, të veçuar nga struktura e menaxhimit dhe mbledhjes së të ardhurave të tjera, (siç është aktualisht në varësi të drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar), në mënyrë që të mos krijohen mangësi në mbledhje e të ardhurave tatimore dhe të minimizohet numri dhe vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat. Kryetari i Bashkisë Tepelenë, deri në rishikimin dhe miratimin e strukturës së posaçme tatimore nga Këshilli Bashkiak, të marrë masa për të plotësuar vendet vakante në strukturën aktuale, deri në miratimin e strukturës së re nga Këshilli Bashkiak.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	Bashkinë Tepelenë, etj.			
2	Nga analiza e llogarive kontabël të pasqyrave financiare, konstatohet: ***Për vitin 2019***. ***- Gjendja e llogarive debitore*** është në shumën totale 135,278 mijë lekë përkatësisht; Llogaria 468, ñ*Debitorë të ndryshëm*ò për shumën 134,024 mijë lekë e cila është e analizuar për 1052 subjekte juridike dhe persona fizikë nga të cilat për 10,449 mijë lekë janë evidentuar debitorë për tatim taksat lokale nga viti 2008 dhe diferenca debitorë të tjerë nga viti 2013. Llogari 429, ñ*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*ò për shumën 1,254 mijë lekë, është e analizuar për 43 subjekte debitorë nga viti 2000-2008. - ***Gjendja e llogarive kreditore*** në pasqyrat financiare të fundvitit është në shumën totale 82,305 mijë lekë. Nga auditimi u konstatua ***se nuk janë evidentuar si detyrim në llogaritë kreditore në dy raste për shumën 6,663 mijë lekë,*** përkatësisht faturat nr. 38, datë 10.07.2019 subjekti ñN.ò Sh.P.K. dhe nr. 49, datë 04.09.2018 subjekti ñN.ò Sh.P.K. Llogaritë 401-408, ñ*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*ò për shumën totale 26,834 mijë lekë është e analizuar për 58 subjekte kreditorë nga viti 2016. Llogaria 431, ñ*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksat*òpër shumën 4,088 mijë lekë, tatim mbi të ardhurat personale për disa mujorë. Llogaritë 435, 436, ñ*Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore*ò për shumën 11,409 mijë lekë për periudha disa mujore. Llogaria 467, ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò për shumën 39,974 mijë lekë e analizuar për 19 subjekte kreditorë nga viti 2015. ***Për vitin 2020***. - ***Gjendja e llogarive debitore*** është në shumën 136,967 mijë lekë përkatësisht: Llogaria 468 për shumën 135,713 mijë lekë e cila është e analizuar për 1129 subjekte juridike dhe fizike nga të cilat për 13,412 mijë lekë janë evidentuar debitorë për tatim taksat lokale nga viti 2008 dhe diferenca janë debitorë të tjerë nga viti 2013. Llogaria 429 për shumën 1,254 mijë lekë. - ***Gjendja e llogarive kreditore*** në pasqyrat financiare të fundvitit është në shumën totale 58,057 mijë lekë përkatësisht: Llogaritë 401-408, ñ*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*ò për shumën totale 26,767 mijë lekë është e	*Pika 2.3, faqe 46-65*	E lartë	Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, bazuar në kërkesat ligjore, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke përcaktuar radhën e pagesave. Të procedojë në rrugë gjyqësore ndaj debitorëve, për vjeljen e detyrimeve të krijuara në vite.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	analizuar për 151 subjekte kreditorë nga viti 2017. Llogaria 467, ñ*Kreditorë të ndryshëm"* për shumën 31,290 mijë lekë e analizuar për 151 subjekte kreditorë nga viti 2018. ***Nuk është proceduar në rrugë gjyqësore*** për vjeljen e kërkesave debitore në vite si dhe nuk janë marë masat e duhura për shlyerjen e detyrimeve kreditore ***në kundërshtim*** me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar si dhe UMF nr. 5, datë 27.02.2014 ñ*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*ò, i ndryshuar.			
3	U konstatua se për vitin 2019 dhe 2020, janë përgatitur pasqyrat financiare, pa kryer më parë inventarizimin e të gjitha Aktiveve Afatgjata, ***në kundërshtim*** me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò, neni 15, pikat 1 dhe 2, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik*ò i ndryshuar, pika 74 dheUMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në në Njësite e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, Kap. III, pika 30 dhe Kap. IV, pika 104. Konkretisht, për vitin 2019 dhe 2020, me urdhër të Titullarit të Intitucionit, janë ngritur komisionet ñ*Për kryerjen e inventarizimit te aktiveve të qëndrueshme, inventarit të imët dhe materialeve*ò. Inventarizimi është kryer për llogaritë inventariale 31, ñ*Materiale*ò, 32, ñ*Inventar i imët*ò dhe 218, ñ*Inventar ekonomik*ò. Nuk janë verifikuar me inventarizim fizik gjendja e llogarive të tjera kontabël të Aktiveve Afatgjatë materiale	*Pika 2.3, faqe 46-65*	E lartë	Bashkia Tepelenë, të marë masat e nevojshme, të kryejë invenarin fizik për gjithë asetet në pronësi të saj. Për këtë është e nevojshme të ngejë komisione me specialitë të fushës.
4	Nga testimi i disa llogarive të shpenzimeve, në 3 raste u konstatuan procedura jo të plota në përdorimin e fondeve të vlerësuara me risk, konkretisht: **1**- Evidentimi i shpenzimeve për karburant, në disa raste nuk është i plotë, pasi në fletët e udhëtimit, nuk është përcaktuar qëllimi i shërbimit ose objekti i punës si dhe nuk janë të firmosuara nga personi udhëtues ose personi që ndjek kryerjen e shërbimit sipas projektit, ***në kundështim*** me pikat 35/b dhe 36 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*ò i ndryshuar. **2**- Për vitin 2020, janë alokuar fonde për ñ*Futboll Klub Tepelena*ò me NIPT L32608791F, për 13 raste në shumën totale 4,542,000 lekë, sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 90, datë	*Pika 2.3, faqe 46-65*	E lartë	Bashkia Tepelenë, të nxjerë përgjegjësitë dhe të marrë masat e nevojshme me qëllim përmirësimin e procedurave ligjore për mirëmenaxhimin e fondeve publike për rastet e sipërcituara në zbatim të kërkesave ligjore.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	20.12.2019. Nga auditimi i procedurave mbi llogaritjen e fondeve limit për financimin e aktivitetit të ñ*Futboll Klub Tepelena*ò, të paraqituar për miratim në Këshillin e Bashkisë, konstatohet se nuk ka analiza dhe preventiv për mënyrën e llogaritjes së këtij fondi, në kundërshtim mekërkesat e neneve 8, 19, 39 të ligjit nr. 79/2017 ñ*Për sportin*ò, i ndryshuar dhe VKM nr. 1720, datë 29.10.2008 ñ*Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sporteve që i arijnë këto nivele si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sporteve*ò. **3**- Me Vendimin nr. 22 datë 02.04.2020 të Këshillit Bashkiak ñ*Për trajtimin me bonus qiraje për familjet në nevojë të cilat nuk mund ta përballojnë qiranë e tregut të lirë*ò, janë miratuar për të përfituar financiarisht 44 familje. Vendimi miratues, është referuar në mbështetje të ligjit 139/2015 ñ*Për vetqeverisjen vendore*ò, ligjit 22/2018 ñ*Për strehimin social*ò si dhe akteve të tjera nënligjore. Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020, janë paguar bonus qira banese për ***27 raste në shumën totale 2,411,800 lekë.*** Pagesa është përballuar tërësisht nga fondet buxhetore pa kontributin e Bashkisë Tepelenë, ***në kundërshtim*** me kërkesat e pikave 2, 3 të VKM nr. 459, datë 3.07.2019 ñ*Për rregullat për Administrimin e kërkesave të Vetëqeverisjes Vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvensionimin e qirasë ose uzurfruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehimin*ò.			
5	Në pasqyrat Financiare të fund vitit 2020, gjendja e llogarisë 466 *"Kreditorë për mjetet në ruajtje*ò, sipas analizës të rakorduar me Degën e Thesarit, është për ***vlerën 3,294,275 lekë***, e analizuar sipas objekteve për 11 raste. Nga analiza e përmbajtjes së kësaj llogarie, konstatohet së për 3 objekte në shumën 1,310,514 lekë ***gjenden në ngurtësuara fonde nga viti 2018*** për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës dhe nuk është bërë zhbllokimi i tyre. Drejtoria e Financës, nuk ka kryer asnjë veprim, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse, për zhbllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin për interes publik, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat*	*Pika 2.3, faqe 46-65*	E lartë	Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar fondet si garanci për punimet e kryera dhe për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës. Të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Tepelenë për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 ñ*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*ò i ndryshuar, Kap. II, pika 10.			tyre në interes publik.
6	Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratave me nr. 895/3 prot., datë 25.06.2019, me objekt ñ*Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit), Bashkia Tepelenë*ò dhe me nr. 1185/4 prot., datë 06.11.2020, me objekt ñ*Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit), Bashkia Tepelenë*ò, nuk administrohej leja e ndërtimit, në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 ñ*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*ò, neni 39, ñ*Leja e ndërtimit*ò.	*Pika 2.4 faqe 67-78*	E lartë	Nga Bashkia Tepelenë të merren masa që para fillimit të punimeve, të shqyrtohen të dhënat teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit.
7	Nga verifikimi i zbatimit të detyrave të lëna nga auditimi i fundit, për rikërkimin e zbatimit të rekomandimeve, u konstatua se nga 6 Masa Organizative të rikërkuara për zbatim, 1 masë është zbatuar plotësisht dhe 5 masa vazhdojnë të jenë në proces zbatimi; nga 2 masa për shpërblim dëmi të rikërkuara, të dyja vazhdojnë të jenë në proces, por nuk është arkëtuar detyrimi dhe nuk kanë filluar procedimet gjyqësore për vlerën **1,281,616 lekë** nga zbatimi i kontratave ñ*Rikonstruksion i qendrës së fshatit Veliqot*ò, Bashkia Tepelenë, për vlerën **456,518 lekë** pa TVSh. dhe ñ*Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatin Luzat NjA Qendër*ò, Bashkia Tepelenë, për vlerën **825,098 lekë** pa T.V.Sh.; 1 masë për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike e rikërkuar vazhdon të jetë në proces; 7 masa të rikërkuara për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), vazhdojnë të jenë në proces. Aktualisht, nga totali prej **31,578,552 lekë** është arkëtuar gjithsej vlera prej **1,811,644 lekë** dhe ka mbetur për tû arkëtuar vlera **29,795,715 lekë**.	*Pika 2.5, faqe 75-86*	E lartë	Nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë,Drejtoria ligjore dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomiktë vazhdojë ndjekja me përgjegjësi e procedurave ligjore, për masat shpërblim dëmi dhe të ardhura të munguara të konsideruara në proces zbatimi, me qëllim arkëtimin e vlerës në buxhetin e bashkisë. Për këtë të ndiqen të gjitha rrugët e mundshme ligjore deri në hapjen e proceseve gjyqësore. Për masat organizative dhe të tjera, nga titullari të monitorohet zbatimi i planit të veprimit dhe personat përgjegjës për zbatimin e tij.
8	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñ*Pastrimi i rezervuarit dhe rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj*ò, Bashkia Tepelenë, me vlerë të kontratës (me T.V.Sh.) 11,966,064 lekë, lidhur me kontraktorin ñSh.ò Sh.P.K., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 393,306 lekë pa T.V.Sh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 895/3 prot., datë 25.06.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë dhe kontraktori ñSh.ò	*Pika 2.4, faqe 65-75*	E lartë	Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **393,306lekë pa T.V.Sh.**nga Kontraktori ñSh.ò Sh.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 895/3 prot., datë 25.06.2019, me objekt ñ*Pastrimi i rezervuarit dhe rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj*ò, Bashkia Tepelenë, vlerë që përfaqëson dëm

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	Sh.P.K.			ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
9	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñ*Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit)*ò, Bashkia Tepelenë, me vlerë të kontratës (me T.V.Sh.) 20,899,027 lekë, të lidhur me ñSh.ò Sh.P.K., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 141,651 lekë pa T.V.Sh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1185/4 prot., datë 06.11.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë dhe kontraktorit ñSh.ò Sh.P.K.	*Pika 2.4, faqe 65-75*	E lartë	Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **141,651 lekë pa T.V.Sh.**nga kontraktori ñSh.ò Sh.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1185/4 prot., datë 06.11.2020, me objekt ñ*Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit)*ò, Bashkia Tepelenë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
10	Nga verifikimi i kontratave të qirasë për terrenet shtetërore (troje, lulishte, trotuare, etj.), u konstatua se për vitin 2019 janë lidhur gjithsej 21 kontrata, me të ardhura të pritshme në vlerën 3,013,157 lekë, ndërsa për vitin 2020, janë lidhur 20 kontrata, shumica e të cilave ekzistuese nga viti 2019, me të ardhura të pritshme në vlerën 2,831,157 lekë. Gjatë vitit 2019 janë arkëtuar 2,786,697 lekë ndërsa gjatë vitit 2020 janë arkëtuar 1,487,611 lekë. Diferenca prej **1,570,006 lekë**, (226,460 lekë nga viti 2019 dhe 1,343,546 lekë nga viti 2020), përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Gjatë viteve 2019 dhe 2020, në Njësinë Administrative Lopës, janë lidhur gjithsej 30 kontrata qiraje për tokë bujqësore, me afat nga 6 muaj, deri në 1 vit. Nga auditimi i kontratave, u konstatua se nuk kanë paguar detyrimet 2 qiramarrës për vitin 2019, në vlerën totale 20,000 lekë dhe 11 qiramarrës për vitin 2020, në vlerën totale 269,600 lekë. Vlera prej **289,600 lekë** (20,000 lekë nga viti 2019 dhe 269,600 lekë nga viti 2020), përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, nga mosvjelja e qirasë së tokave bujqësore në Njësinë Administrative Lopës. Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 ñ*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*ò i ndryshuar; ligjin nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò; ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 ñ*Për tokën*ò, i ndryshuar; ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 ñ*Për tokat*	*Pika 2.2, faqe 30-46*	E lartë	Sektori i zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa) në Bashkinë Tepelenë, në bashkëpunim me Njësitë Administrative dhe Drejtorinë ligjore dhe të shërbimeve organizative, të marrin masa për të nxjerrë njoftim-vlerësimet për detyrimet e papaguara nga qiramarrësit e listuar në pastyrat 2.2.6.5. dhe 2.2.6.6., në vlerën neto **1,859,606 lekë** duke llogaritur kamatëvonesat dhe sanksionet e tjera përkatëse (nëse ka), për secilin rast, si dhe të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara, për të gjitha detyrimet kontraktuale të pa mbledhura.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	*bujqësore të pandara*ò, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, ñ*Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*ò, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për tôu lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò, etj. Për vlerat debitore nga Bashkia Tepelenë nuk janë llogaritur kamatëvonesat, sipas kërkesave të kontratës tip dhe VKM-së nr. 373, datë 20.06.2018, ñ*Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*ò, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò, etj.			
11	Nga auditimi i pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara, u konstatua se gjatë vitit 2019 nuk e kanë paguar këtë taksë 3 persona, në vlerën totale 21,772 lekë dhe gjatë vitit 2020 nuk e kanë paguar 5 persona në vlerën totale 99,143 lekë. Vlera prej **120,915 lekë** (21,772 lekë për vitin 2019 dhe 99,143 lekë për vitin 2020) përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, nga mosvjelja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara. Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, ñ*Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*ò i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar; VKB Tepelenë ñ*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Tepelenë*ò, etj.	*Pika 2.2, faqe 30-46*	E lartë	Bashkia Tepelenë nëpërmjet bashkëpunimit institucional tôi kërkojë ASHK-së, Drejtoria Tepelenë, që të mos lëshojë dhe të pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Tepelenë. Drejtoria e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga individët e listuar si debitorë në Pasqyrat 2.2.6.9. dhe 2.2.6.10, bazuar në legjislacionin tatimor.
12	Numri i debitorëve nga biznesi si në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklamës, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesat	*Pika 2.2, faqe 30-46*	E lartë	Bashkia Tepelenë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pavjela

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	përkatëse), nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu fund të vitit 2019 numri i debitorëve ishte 197 subjekte në vlerën 10,341,288 lekë, ndërsa në fund të vitit 2020 numri i debitorëve ishte 247 subjekte në **vlerën 13,364,487 lekë**. Kamatëvonesa për këtë shumë detyrimesh është në **vlerën 2,926,822 lekë.** Vlera debitore për vitin 2020 ka qenë 3,023,199 lekë, e cila përfaqëson taksat dhe tarifat vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Nga auditimi i pagesave të kryera nga institucionet që operojnë në Bashkinë Tepelenë, u konstatuan detyrime të pavjela nga 4 institucione, në vlerën **499,741 lekë**, konkretisht 343,600 lekë detyrime dhe 75,248 lekë kamatëvonesa për periudhën 2012-2019 dhe 66,360 lekë detyrime dhe 14,533 lekë kamatëvonesa për vitin 2020). Vlera prej **16,791,051 lekë** (13,364,487 lekë detyrime dhe 2,926,822 lekë kamatëvonesa nga biznesi dhe 409,960 lekë detyrime dhe 89,781 lekë kamatëvonesa nga institucionet), përbën të ardhura të munguara (borxh tatimor) për buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore*ò, me ndryshime, Kreut XI, ñ*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*ò, ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 ñ*Kodi Penal i RSh*ò me ndryshime, neni 181, ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, i ndryshuar neni 9 ñ*Të drejtat dhe përgjegjësitë*ò pika 1.3., neni 35, ñ*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*ò, ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.			nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj 247 subjekteve dhe 4 institucioneve në vlerën prej **16,791,051 lekë***(sipas **Pasqyrave**në Anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit)*, duke ndjekur rrugët e mëposhtme: ***a. T'u dërgohen bankave*** të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare. ***b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit***, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme). ***c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar***, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar. ***Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset***, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Tepelenë, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
13	Nga auditimi i pagesave për taksën e tokës bujqësore, u konstatua se rezulton një numër mjaft i madh i familjeve debitore për taksën e tokës, gjithsej 2,292 familje, për një vlerë totale **10,468,765 lekë**, konkretisht 5,008,132 lekë për NjA Qendër, 2,176,081 lekë për NjA Kurvelesh dhe 3,284,552 për NjA Lopës, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Regjistrat e familjeve fermere, duhet të ishin	*Pika 2.2, faqe 30-46*	E lartë	a. Bashkia Tepelenë, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për të hartuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Tepelenë dhe Qarku Gjirokastër). Për familjet fermere debitore të nxirren njoftim-vlerësimet e

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	përditësuar sipas të dhënave që duhet të disponojë ZAMT në Bashki, nga ZAMT në Qark apo nga AKSH Tepelenë për numrin e familjeve që kanë përfituar tokë në bazë të ligjit për ndarjen e tokës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, nenet 23 dhe 24. Referuar akt-rakordimeve të bashkisë Tepelenë me UK sha Tepelenë, rezulton se për periudhen objekt auditimi për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit,**vlera debitore është 3,979,274 lekë**, e ndarë në 1,138,711 taksë ndërtese dhe 2,840,563 lekë tarifë pastrimi, ku debia për taksën e ndërtesës është 540,711 lekë për vitin 2019 dhe 598,000 lekë për vitin 2020, ndërsa debia për tarifën e pastrimit është 1,388,563 lekë për vitin 2019 dhe 1,452,000 lekë për vitin 2020. Nga auditimi i pagesave për taksat dhe tarifat vendore nga familjarët, u konstatua se këto detyrime llogariten vetëm për Njësinë Adminstrative Tepelenë, pasi për NjA Qendër, Kurvelesh dhe Lopës, për periudhën objekt auditimi 2019-2020 nuk është planifikuar dhe realizuar e ardhura nga **taksa e ndërtesës** dhe **tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit** për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sha Tepelenë, pasi kanë munguar të dhënat nga Administratorët e Njësive Administrative se bashku me Kryetarët e Fshatrave, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë detyrimet vendore. Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, etj.			detyrimeve për të gjithë kohën e papaguar për vlerën **10,468,765 lekë** dhe për mospagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit. b. Bashkia Tepelenë, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerave debitore. Gjithashtu Bashkia Tepelenë të bashkëpunojë me UK sha për arkëtimin e vlerës debitore prej **3,979,274 lekë** dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative këtij agjenti tatimor. c. Bashkia Tepelenë, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Tepelenë, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në,

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
				DRRT-në, ASHK-në, etj,) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.
14	Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Sektori i zhvillimit ekonomik, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit, të pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Tepelenë 6 subjekte, nga të cilët 3 prej tyre nuk kanë paguar detyrimet vendore në vlerën totale **75,360 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Tepelenë. Nga detyrimet vendore të papaguara prej OE të cilët zbatojnë investimet e ndryshme në territorin e Bashkisë Tepelenë rezulton një vlerë debitore prej **1,981,440 lekë,** e cila përbën të ardhura të munguara (borxh tatimor) për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit pa e regjistruar adresën sekondare dhe mospagimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë. Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore*ò neni 40, ñ*Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare*ò, pika 1, neni 43 ñ*Përditësimi i të dhënave të regjistrimit*ò pika 1/1; ligjin nr. 9723 dt.03.05.2007 ñ*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*ò, i ndryshuar, neni 22, ñ*Detyrimi për regjistrim*ò, pika 4; ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar; ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, VKB, etj.	*Pika 2.2, faqe 30-46*	E lartë	Bashkia Tepelenë të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit të cilat kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokuruara për vitet 2019-2020, pavarësisht nëse kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Tepelenë dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, si dhe të nxjerrin njoftim detyrimet për taksat dhe tarifat vendore. Sipas listimit në Anekse, Pasqyrat 2.2.6.26., 2.2.6.28. dhe 2.2.6.29., të ndjekin të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës totale **2,056,800 lekë** nga këto detyrime vendore.
15	Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Tepelenë ushtrojnë aktivitetin 5 subjekte të cilat tregtojnë hidrokarbure, karburante. Subjekte të licencuar për tregtimin e lëndëve djegëse nuk ka. SubjektetA.Sh.P.K. dhe S.Sh.P.K., nuk e ushtrojnë më aktivitetin, pasi janë prishur për shkak të ndërtimeve të infrastrukturës. Subjektet K. Sha, B.Sh.P.K. dhe A.Sh.P.K. vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet të papajisur me autorizimet përkatëse, ndërsa subjektet O. Sh.P.K., dhe K.Sh.P.K. vazhdojnë aktivitetin ndërsa pagesat e autorizimit janë bërë të pjesshme dhe do të vazhdojnë të shlyhen me këste për një periudhë 5 vjeçare. Pagesat e pakryera deri në momentin e auditimit dhe	*Pika 2.2, faqe 30-46*	E lartë	Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, në shumën debitore prej **4,400,000 lekë,** sipas Anekseve, **Pasqyra 2.2.6.30**. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	vlerat debitore, të cilat pavarësisht se në disa raste është rënë dakord që të paguhen me këste, gjithsesi përbëjnë detyrime të paarkëtuara dhe dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Tepelenë janë paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.30**, në vlerën **4,400,000 lekë**. Sa më sipër, është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa ñbò, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.			arkëtimin e plotë të tarifës së licencës/autorizimit dhe në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.
16	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 1185/4 prot., datë 06.11.2020 me objekt *"Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit), Bashkia Tepelenë,* me vlerë të kontratës (me T.V.Sh.)20,899,027 lekë, kontraktuar me ñSh.ò Sh.P.K., rezultoi se është bërë çmontimi dhe largimi i një tubacioni me Ø 609.6 mm x 6.3 mm, me vlerë të situacionuar 2,296,800 lekë pa T.V.Sh., si tubacion i amortizuar dhe jashtë funksionit. Çmontimi dhe largimi i këtij tubacioni, pas konstatimit si i amortizuar, i bllokuar dhe jashtë funksionit, ishte i panevojshëm, pasi vlera e skrapit, nëse do të ishte shitur, është më e vogël se shpenzimet e kryera dhe për pasojë është rritur kostoja e objektit me vlerën **2,296,800 lekë**.	*Pika 2.4, faqe 65-75*	E lartë	Titullari i njësisë vendore të analizojë, të nxjerrë përgjegjësitë për efektin negativ që ka sjellë realizimi i panevojshëm i këtij zëri pune dhe të marrë masa që për marrjen në dorëzim të projekteve të realizuara në Bashkinë Tepelenë, të ngrejë grupe pune të specializuara, në mënyrë që të implementohen projekte cilësore dhe sa më afër gjendjes reale.
17	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 895/3 prot., datë 25.06.2019, me objekt *"Pastrimi i rezervuarit dhe rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj, Bashkia Tepelenë*ò,me vlerë të kontratës (me T.V.Sh.)11,966,064 lekë, të lidhur me kontraktorinñSh.ò Sh.P.K., rezultuan se punimet kanë përfunduar 34 ditë jashtë afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, duke përfshirë edhe amendamentin e kontratës nr. 895/7 prot., datë 23.09.2019, i cili ka bërë shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 45 ditë. Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se nuk janë mbajtur penalitete për ditëvonesat në përfundimin e punimeve në masën **481,562 lekë** (0.004 x 34 ditë x 3,540,900 lekë (pjesa e mbetur e kontratës, deri në përfundim të afatit kontraktual të punimeve).	*Pika 2.4, faqe 65-75*	E lartë	Titullari i AK të marrë masa që për kontratat publike, të caktojë nëpunës për monitorimin e kontratës, i cili të pasqyrojë gjendjen faktike të realizimit të kontratës, cilësinë e punimeve dhe grafikut të punimeve, para çertifikimit të punimeve të realizuara. Gjithashtu, të nxjerrë përgjegjësitë për efektin negativ prej **481,562 lekë**, që ka sjellë mosrespektimi i nenit 27 të kontratës, që ka të bëjë me penalitetet për shkak të vonesave në përfundimin e punimeve sipas afatit kontraktual, me qëllim që objektet të realizohen për ti shërbyer komunitetit në kohë.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Konkluzioni i përgjithshëm

Ne kemi audituar veprimtarinë ekonomiko financiare e Bashkisë Tepelenë, për periudhën nga data nga 01.10.2019 deri më 31.12.2020, përfshirë çështjet e menaxhimit financiar dhe kontrollit, auditimit të brendshëm, pasqyrat financiare, planifikimin dhe realizimin e të ardhurave e shpenzimeve, zbatimin e kontratave, etj.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe paraqitjen në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimii parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në përfundim të auditimit të fushave të mësipërme, për vitet 2019 - 2020, pas vlerësimit të dokumentacionit, grupi i auditimit të KLSH-së arrin në konkluzionin se përsa i takon shkallës së zbatimit të standardeve mbi raportimin financiar nga subjekti Bashkia Tepelenë, në përgjithësi jepet një pamje e drejtë dhe e sinqertë e pozicionit financiar dhe performancës financiare, si dhe për lëvizjet e mjeteve monetare, kjo referuar UMF dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, duke përjashtuar disa anomali materiale por jo të përhapura që janë baza për dhënien e një opinioni të kualifikuar mbi pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e veprimtarisë të subjektit Bashkia Tepelenë me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi.

<u>I. Opinion i kualifikuar mbi pasqyrat financiare</u>[1]

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të periudhave ushtrimore 2019 dhe 2020 në Bashkinë Tepelenë, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh të dokumenteve që mbështesin shumat e llogarive të pasqyrave financiare, duke bërë vlerësimin e parimeve kontabël të aplikuara, vlerësimet të bëra nga drejtuesit si dhe vlerësimine paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, përsa i takon shkallës së zbatimit të standardeve mbi raportimin financiar për vitin 2019 dhe 2020 nga subjekti Bashkia Tepelenë, pasqyrat financiare në përgjithësi japin një pamje të drejtë dhe të sinqertë të pozicionit financiar, të performancës financiare dhe lëvizjet e mjeteve monetare, kjo referuar UMFEnr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, duke përjashtuar ndonjë anomali jo materiale që është baza për dhënien e ***një opinioni të kualifikuar***.

Baza për opinionin e Pasqyrave Financiare:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se disa llogari, megjithëse nuk janë krijuar në periudhën ushtrimore të viteve 2019 dhe 2020, nuk kanë pasur lëvizje në debi ose në kredi, përgjegjësi kjo e raportuesit për saktësinë dhe vërtetësinë e këtyre llogarive.

Gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale *(të përhapura)*, të cilat sipas mendimit tonë kanë efekt në pozicionin financiar të llogarive. Për këto arsye kemi dalë me *"Opinion të kualifikuar"*.

---

[1] **Një opinion i kualifikuar** jepet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë ose kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

II. Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë[2]

Ne kemi audituar përputhshmërinë[3] e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërinë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e Bashkisë Tepelenë, gjatë periudhave ushtrimore të vitit 2019 dhe 2020. Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së Bashkisë Tepelenë, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e ñ*Bazës për Opinionin e Kualifikuar*ò, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura.

Baza për opinionin e Përputhshmërisë:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se u konstatuan devijime nga kuadri rregullator përsa i përket, menaxhimit financiar dhe kontrollit, auditimit të brendshëm, zbatimin e kontratave, etj., të cilat nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor financiar në fuqi.

- Në Bashkinë Tepelenë, sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe Auditimi i brendshëm, nisur edhe nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

- Nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Tepelenë dhe Njësitë Administrative, për mos pagimin në afat të detyrimit tatimore subjektet më datën 31.12.2020 vlera e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore në shkallë bashkie është në shumën prej **39,801,310 lekë**, e cila përbëhet nga:

Mosvjelja e qerasë së tokave bujqësore:	1,859,606 lekë
Mosvjelja e taksës së ndikimit në infrastrukturë	120,915 lekë
Mosvjelja e detyrimeve tatimore dhe tarifore të biznesit	16,291,310 lekë
Mosvjelja e taksës së tokës	10,468,765lekë
Mosvjelja e detyrimeve të familjarëve	3,979,274lekë
Biznese pa adresa sekondare dhe pa paguar detyrimet vendore	1,981,440 lekë
Subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre	5,100,000 lekë

-Në fund të viti 2020, kanë rezultuar të pa përdoruara fonde në shumën 2,353 mijë lekë të cilat janë transferuar për llogari të vitit 2021, ndërkohë që kanë rezultuar detyrime të pa paguara në shumën 62,008 mijë lekë.

-Në zbatimin e punimeve të 8 kontratave u konstatuan devijime materiale në zërat e matshëm, fakt që tregon se mbikëqyrja e punimeve të investimeve është një zonë me risk në menaxhimin e investimeve publike, duke evidentuar një dëm ekonomik në vlerën **2,511 mije lekë**.

-Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, janë konstatuar veprime jo në përputhje me kërkesat ligjore në 11 procedura ku është evidentuar përdorim jo sipas 3-E të shumës prej 16,127 mijë lekë.

- Nga auditimi i dosjes teknike të objektit ñ*Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit), Bashkia Tepelenë*ò, u konstatua se nuk është dhënë leja e ndërtimit.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñ*Pastrimi i rezervuarit dhe rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj*ò, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera nga

[2] **ISSAI 4100 –** Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

[3] Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së*ò.

kontraktori ñSh.ò Sh.P.K., në fakt në vlerën 393,306 lekë pa T.V.Sh., në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 895/3 prot., datë 25.06.2019 .

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñ*Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit)*ò, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera nga kontraktori ñSh.ò Sh.P.K., në fakt në vlerën 141,651 lekë pa T.V.Sh., në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1185/4 prot., datë 06.11.2020.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 1185/4 prot., datë 06.11.2020 me objekt *"Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit),* rezultoi se nga kontraktori ñSh.ò Sh.P.K., është bërë çmontimi dhe largimi i një tubacioni me Ø 609.6 mm x 6.3 mm, me vlerë të situacionuar 2,296,800 lekë pa T.V.Sh., si tubacion i amortizuar dhe jashtë funksionit. Çmontimi dhe largimi i këtij tubacioni, pas konstatimit si i amortizuar, i bllokuar dhe jashtë funksionit, ishte i panevojshëm, pasi vlera e skrapit, nëse do të ishte shitur, është më e vogël se shpenzimet e kryera dhe për pasojë është rritur kostoja e objektit me vlerën **2,296,800 lekë**.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 895/3 prot., datë 25.06.2019 me objekt *"Pastrimi i rezervuarit dhe rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj, Bashkia Tepelenë*ò,me vlerë të kontratës (me T.V.Sh.) 11,966,064 lekë, kontraktuar me ñSh.ò Sh.P.K., rezultuan se punimet kanë përfunduar 34 ditë jashtë afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, duke përfshirë edhe amendamentin e kontratës nr. 895/7 prot., datë 23.09.2019, i cili ka bërë shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 45 ditë. Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se nuk janë mbajtur penalitete për vonesa në përfundimin e punimeve në masën **481,562 lekë** (0.004 x 34 ditë x 3,540,900 lekë (pjesa e mbetur e kontratës, deri në përfundim të afatit kontraktual të punimeve).

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Tepelenë:

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* dhe të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 08, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme[4], nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur

[4] **ISSAI 300**Parimet Bazë të Auditimit në lidhje me përputhshmërinë pohojnë se auditimi duhet të japë siguri tëarsyeshme për zbulimin e gabimeve, parregullsive dhe veprimeve të paligjshme që mund të cenojnëndjeshëm objektivat e auditimit.

vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 363/1 Prot., datë 06.04.2021, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Tepelenë nga data 07.04.2021 deri në datën 21.05.2021, u krye ñ*Auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë*ò, për periudhën nga 01. 10.2019 deri më 31.12.2020, nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J. P., Përgjegjës Grupi;
2. A. Z
3. J. L.;
4. R. G.;

1. Objekti i Auditimit

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme për vitet 2019 dhe 2020, nëse transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve;

2. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me: realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim; Auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e procedurave ligjore në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Planit të detajuar vendor; Auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e regjistrit të territorit. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në marrjen e vendimeve për leje zhvillimi, ndërtimi dhe përdorimi, etj.

Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Tepelenë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë, z. T. P., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, z. S. K. në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit

të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, ñ*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH*ò, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a. Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
b. Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
c. Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
d. Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
e. Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
f. fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Tepelenë, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

6. Kriteret e vlerësimit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò;
- ***<u>Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:</u>***

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò;
- Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ñ*Për auditimin e brendshëm publik*ò;
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*ò;
- VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñ*Për Miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit*

*të Brendshëm në Sektorin Publik*ò.

- Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 28, datë 15.12.2011 ñ*Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë. e sistemit te kontrollit te brendshëm në njësite publike*ò;
- Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò i ndryshuar
- Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*ò
- Urdhëri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 ñ*Për miratimin e manualit të MFK*ò;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik urdhri i ministrit Financave nr. 100, datë 16.10.2017.

▪ ***<u>Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:</u>***

- Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò
- Ligji nr. 99/2018, datë 31.12.2018 ñ*Për buxhetin e vitit 2019*ò, Ligji nr. 88/18.12.2019 ñ*Për buxhetin e vitit 2020*ò dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje.
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 ñ*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*ò
- Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 ñ*Per pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.903.2015;
- VKM 783 datë 22.11.2006 ñ*Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël*ò;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 ñ*Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore*ò;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*ò;
- UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*ò, etj;
- Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar;
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 ñ*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*ò ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
- Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 ñ*Për përgatitjen e buxhetit vendor*ò;
- Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 ñ*Për buxhetin e vitit 2018*ò, pikat 82-91 ñ*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*ò,
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*ò,
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 ñ*Për buxhetin e vitit 2019*ò, pikat 106-110, ñ*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*ò, dhe pikat 116-117- *Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore''*.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, ñ*Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive*ò), Fletore zyrtare 196/2014;

▪ ***<u>Në fushën e mbajtjes së Kontabilitetit dhe Hartimit tëPasqyrave Financiare:</u>***

- Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuarligjin nr. 9477 datë 9.2.2006*ò, aktualisht i shfuqizuar;
- VKM nr. 248, datë 10.4.1998 ñ*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre*ò i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñ*Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*ò;

- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ñ*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*ò;
- Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 ñ*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj*ò;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 ñ*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*ò.

▪ ***<u>Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:</u>***

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në RSH*ò, i ndryshuarò;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 ñ*Për Sistemin e Taksave Lokale*ò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre*ò, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, ñ*Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*ò;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar;

▪ ***<u>Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:</u>***

- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, ñ*Për kundravajtjet administrative*ò
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 ñ*Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë*ò;
- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, ñ*Për lejet e mjedisit*ò;
- Ligji nr. 107-2014, ñ*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*ò;
- Ligji nr. 44/2015 ñ*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*ò;
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015, ñ*Për miratimin e manualeve të ndërtimit*ò;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ñ*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar*ò;
- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 ñ*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*ò;
- Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore;

▪ ***<u>Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:</u>***

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 ñ*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*ò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, ñ*Për Nëpunësin Civil*ò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, ñ*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*ò, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, ñ*Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë*ò, i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, ñ*Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore*ò, i ndryshuar;

▪ *Rregullore e brendshme "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH";*
▪ *Rregullore e brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLS-së";*
▪ *Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.*
▪ *Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;*

- *Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.*

7. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 ñ*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*ò, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 ñ*Udhëzues të Auditimit Financiar*ò;
- ISSAI 2300 ñ*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*ò;
- INTOSAI GOV 9100 ñ*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik"* si dhe INTOSAI GOV 9110 ñ*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*ò;
- ISSAI 400 ñ*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*ò, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 ñ*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*ò; si dhe ISSAI 4200 ñ*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*ò;
- INTOSAI ñ*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*ò; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

8. Metodat e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

- ***<u>Kontrolli aritmetik</u>***

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe

rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

- ***Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese***

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò, i ndryshuar.

- ***Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese***

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- ***Kontrolli i vlerësimeve***

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- ***Konfirmimi nga të tretët***

Transaksionet e përzgjedhura për tëju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- ***Kontrolli sipas një treguesi***

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna ñjashtë normalesò, të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- ***Intervista***
- ***Raporte dhe Informacione***
- ***Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK***

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme.Rezultatete këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera tërëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akt-Konstatimeve, Akt-Verifikimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe Projektraportit të auditimit, u përgatit ky Raportit PërfundimtarAuditimi.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme tëauditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;

- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

- ***Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim***

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.
Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.
Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.
Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.
Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

- ***Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës***

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.
Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.
Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.
Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

- ***Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese***

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.
Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi BashkinëTepelenë

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik



Tepelena kufizohet në veri me bashkinë Memaliaj, në lindje me bashkinë Këlcyrë, në jug me Bashkinë Gjirokastër dhe në perëndim me bashkitë Himarë dhe Selenicë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Tepelenës. Sipas Censusit të vitit 2011, Bashkia ka një popullsi prej 8.949 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo Bashki numëron 16.371 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 431.24 km^2 me një densitet prej 12.1 banorë/km^2

(disafish më e ulët se mesatarja në rang vendi, për shkak të sipërfaqes së madhe me zonë malore). Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 24 fshatra. Bashkia e Tepelenës zgjerohet me disa zona rurale, të cilat merren kryesisht me blegtori. Shërbimet e vogla tregtare dhe mbledhja e bimëve medicinale sigurojnë pak të ardhura për familjet. Një nga projektet më të rëndësishme është ai i qendrës së qytetit të Tepelenës, ku synohet edhe rivitalizimi i kalasë së Ali Pashës në funksion të nxitjes së turizmit. Kjo kala, por edhe pasuri të tjera si kanioni i Bënçës, ura e Beçishtit apo Uji i Ftohtë mund të shërbejnë për nxitjen e turizmit kulturor dhe natyror.
Të dhënat e vitit 2015 flasin për një numër total prej 16,4 mijë banorësh të regjistruar në gjendjen civile, krahasuar me rreth 20 mijë në vitin 2000. Duket se rënia sistematike e numrit të popullsisë aktualisht është frenuar, si në territorin e ish-komunave, ashtu edhe në qytetin e Tepelenës. Raporti gjinor, sipas të dhënave të censusit të vitit 2011 rezulton të jetë 104.9, pak më i lartë se mesatarja kombëtare prej 100.4, gjë që mund të shpjegohet me fenomenin më të lartë të migrimit tek gjinia femërore.
Në Bashkinë e Tepelenës, grupmosha 15 ï 64 vjeç përbën 66.9% të totalit të banorëve, duke qenë thuajse afër mesatares kombëtare (68%), po ashtu si edhe grupmosha e fëmijeve: 19% (mesatarja në rang vendi 20%).[5]

Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

Emri i Njësive	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Tepelenë	**Qyteti Tepelenë**
Qendër Tepelenë	**Fshatrat:** Dukaj, Salari, Turan, Mamaj, Veliqot, Bënçë, Dragot, Beçisht, Mezhgoran, Peshtan, Hormovë, Lekël, Kodër, Luzat
Lopës	**Fshatrat:** Sinanaj, Matohasanaj, Dorëz, Dhëmblan, Lab Martalloz
Kurvelesh	**Fshatrat:** Progonat, Lekdush, Gusmar, Nivicë, Rexhin

Zhvillimi ekonomik

Ekonomia e Bashkisë Tepelenë karakterizohet nga prezenca e informalitetit dhe mbizotërimi i bizneseve të vogla dhe familjare. Numërohen në total rreth 353 biznese, nga të cilat pjesa më e madhe e zhvillojnë aktivitetin në territorin e njësisë administrative Tepelenë. Tregtia dhe shërbimet përqendrojnë mbi gjysmën e aktiviteteve të biznesit në total.
Sektori i shërbimeve është më i zhvilluari, ai është përgjegjëse për gati gjysmën e *output*-it dhe punësimit. Rritmi i rritjes së ketij sektori ka qenë konstant edhe gjatë 4-5 viteve të fundit me një normë mesatare prej 1-2% në vit. Rritja e shpejtë e këtij sektori është e lidhur ngushtë me shfrytëzimin e potencialeve turistike që ka bashkia. Atëherë, shërbimet mund të luajnë rolin e motorrit të rritjes eknomike në vitet në vazhdim.
Krahas sektorit të shërbimeve, po tenton të rritet gradualisht aktiviteti me natyrë industriale, që konsiston në bizneset e industrisë së lehtë dhe ushqimore (Uji Tepelena), por edhe përpunimin fillestar të bimëve medicinale.
Rënia e interesit ndaj zhvillimi të aktiviteteve tradicionale të bujqësisë është e dukshme, diçka më mirë paraqitet prodhimi blegtoral nga baxhot e zonës. Aktivitetet ekszituese bujqësore synojnë më tepër përmbushjen vetëm të nevojave familjare dhe janë të kufizuara në përdorimin e ngastrave jo më të madhe se 1-2 ha për këtë qëllim. Klima e përshtatshme lejon rritjen e rreth 41 mijë rrënjë ullinj dhe 38 mijë rrënjë hardhi. Në fermat blegtorale rriten rreth 70 mijë krerë të imta (50 mijë dele dhe 20 mijë dhi) dhe 4 mijë gjedhë, produktet e të cilave tregtohen edhe jashtë territorit të bashkisë.
Një investim, që ia vlen të përmendet, është ai i biznesit të kultivimit të peshkut, i ndërtuar në brigjet e lumit Vjosë, në afërsi të urës së Hormovës. Kjo tentativë mund të pasohet nga të

[5] **Burimi:**Plani Operacional i Zhvillimit Vendor

tjera, që synojnë të shfrytëzojnë pasuritë ujore të bashkisë.
Kryetar i Bashkisë Tepelenë është z. T. P. dhe Këshilli Bashkiak i Tepelenës përbëhet nga 15 anëtarë, të cilët janë mandatuar në datën 30 korrik 2019.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditimi mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike;

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm;

2.1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

Titulli i gjetjes: Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Situata: Raporti për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të dy vitet e audituara nuk është dërguar në përputhje me kriteret e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar.

U auditua funksionimi i pesë elementëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informimi dhe komunikimi, monitorimi dhe në përfundim të auditimit arrihet në konkluzionin se edhe pse është bërë një punë e mirë në drejtim të plotësimit dhe administrimit të dokumentacionit përkatës sipas kuadrit ligjor, përveç Rregullores së Funksionimit të Brendshëm të Njësisë, nuk është hartuar një paketë e plotë rregullash të tjera të shkruara për të siguruar një funksionim më të mirë të kontrollit të brendshëm.

Mjedisi i Kontrollit: Nga auditimi rezultoi se janë plotësuar pesëparimet e tij.

Menaxhimi i Riskut: Nga auditimi rezultoi se referuar pyetësorit në lidhje me krijimin e mekanizmave për vlerësimin e riskut, raportohet se të gjithë sektorët dhe drejtoritë përkatëse të Bashkisë Tepelenë evidentojnë në përgjithësi risqet. Pavarësisht punës së kryer prej NjAB-së, nuk është kryer një auditim i posaçëm mbi menaxhimin e riskut. Lidhur me komponentët nr. 9 - 13 të cilët i referohen performancës së njësisë publike, raportimit të dobësive dhe të metave të konstatuara nga kontrolli i brendshëm, si dhe masave të marra për mangësitë e vërejtura, rezulton se mbikqyrja e performancës kryhet bazuar në procesverbalet e mbajtura dhe raportet vjetore. Për sa i përket mangësive të konstatuara ato analizohen pjesërisht, pasi **Bashkia Tepelenë nuk disponon një regjistër risku**. veprime të cilat bien ndesh me kërkesat dhe parimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar si dhe Udhezimit nr. 16, datë 20.07.2016 ñ*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".* Të gjitha takimet mbahen me protokoll dhe firmosen nga të gjithë të pranishmit.

Tre parimet e tjera janë plotësuar.

Aktivitetet e Kontrollit:Për sa i përket komponentëve 7 dhe 8 lidhur me regjistrin e aktiveve të njësisë si dhe përditësimin dhe vlerësimin e tyre, rezulton se Bashkia Tepelenë nuk ju është përgjigjur në mënyrë të detajuar këtyre 2 pyetjeve, nëse është ndjekur ose jo aplikimi pranë ASHK-së për të gjitha pasuritë e Bashkisë Tepelenë, si dhe nëse është kryer përditësimi periodik në bazë të Udhëzimit të Ministrise se Financave me nr. 30/2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*ò, i ndryshuar.

Lidhur me parimin nr. 11, rezultoi se Bashkia Tepelenë nuk ka një sistem back-up dhe plan emergjencash i cili të sigurojë vazhdimësinë e veprimeve kundrejt risqeve të ndryshme si ndërhyrja e paautorizuar në të dhënat e Bashkisë, nuk disponohet një rregullore e veçantë që të sigurojë sistemin IT.

Gjithashtu, lidhur me parimin nr. 12, rezultoi se ky komponent ka të bëjë kryesisht me

përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit, si për personelin por edhe për rangun drejtues nga ku rezulton se është i pa plotësuar.
Informimi dhe komunikimi:Lidhur me parimin nr. 14, rezultoi se ky komponent është ndarë në 2 pyetje, çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me mënyrën sesi informohen menaxherët dhe personeli i njësisë publike lidhur me vendimet/projektet. Sa më sipër rezulton se këta komponent janë të pa plotësuar.
Monitorimi:Nga auditimi rezultoi se janë plotësuar dy parimet e tij.
Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò.
Ndikimi/Efekti: Trajnimi i pa mjaftueshëm për rritjen profesionale të stafit si dhe mos perfeksionimi i sistemeve të IT për ofrimin e informacionit, ndikojnë në arritjen e objektivave të institucionit. Risku i brendshëm është i nivelit të lartë.
Shkaku: Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò si dhe mos konsolidim të tërësisë së rregullave. Mosnjohje sa duhet nga niveli i lartë drejtues i kritereve të MFK, me nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, si KryetariGMS, si dhe nga Nëpunësi Autorizues dhe Koordinatori i Riskut, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK-në dhe komponentët e tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, si dhe miratimin e gjurmëve të auditimit, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurohen programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Të hartohen dhe të zhvillohen programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit. Të vendoset një sistem komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.
Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
Z. T. P., Kryetar i Bashkisë Tepelenë
Z. S. K., Drejtor i Zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar
Znj. J. K., Drejtore ligjore dhe e shërbimeve orgaqnizative
Z. L. B., Drejtor i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit

Titulli i gjetjes: Mbulimi me auditim i aktivitetit të Bashkisë, referuar kërkesave ligjore. Rezultatet dhe eficenca e strukturave të ngritura për realizmin e auditmit të brendshëm. Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditimit të brendshëm, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, Planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit dhe analiza sipas llojeve dhe gjetjeve si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit. Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi;
Situata:Në Bashkinë Tepelenë, njësia e auditimit të brendshëm është krijuar bazë të VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016 ñ*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik*ò, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100, i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Sektori i Auditimit të Brendshëm për periudhën objekt auditimi është miratuar me VKB nr.4,datë 11.03.2019 ñ*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Tepelenë 2019*ò, VKB nr.05/3,datë 30.03.2020, VKB nr.05/8,datë 14.04.2020 ñ*Për një ndryshim në vendimin nr.5/3,datë 30.03.2020 të strukturës organizative të Bashkisë Tepelenë 2020*ò. Sa më sipër për vitin 2019 dhe 2020, struktura e Auditit të Brendshëm përbëhet nga dy punojës.
Sa më sipër prej dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se kjo njësi për periudhën objekt auditimi ka pasur në mardhënie pune vetëm një punojës në cilësinë e Specialistit të Auditit në Bashkinë Tepelenë, konkretisht znj.A. S..

- Dokumentacioni baze mbi të cilën ushtron aktivitetin Drejtoria e Auditimit te Brendshëm.

1) Karta e Auditimit, është përgatitur dhe miratuar tek titullari i Bashkisë Tepelenë, nëpërmjet urdhrave përkatëse, konkretisht urdhri nr. 6, datë 01.02.2017, urdhri nr. 37, datë 09.03.2020 si dhe urdhrin nr. 46, datë 25.03.2021.

2) Është miratuar Kodi i Etikës nga Kryetari i Bashkisë me shkresën nr. 68, datë 05.05.2017.

3) Plani Strategjik për vitin 2019-2021 është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për periudhën objekt auditimi, konkretisht me shkresat nr. 3334 prot, datë 17.10.2018.

4) Planifikimi vjetor i auditimeve për periudhën objekt auditimi është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 1548 prot, datë 18.10.2019 dhe nr. 1618 prot, datë 6.10.2020 në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Aditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2.

5) Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2019, është dërguar në DHAB me shkresën nr. 205 prot, datë 30.01.2020, ndërsa për vitin 2020 është dërguar me shkresën nr. 320 prot, datë 12.02.2021. Dokumentacioni është dërguar në afat, shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit, i përgatitur në përgjithësi sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.6.

6) Struktura e projekt raporteve dhe e raporteve përfundimtare të auditimit për periudhën objekt auditimi është hartuar dhe plotësuar sipas standardit të vendosur nga MAB në Kapitullin IV, pika 4.1.12.

7) Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike janë mbajtur, plotësuar dhe administruar në përputhje me kërkesat e Kapitullit VI të MAB, në to është përfshirë gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme.

Për çdo mision auditimi, nga audituesi janë hartuar programet e auditimit, të cilat janë miratuar, nga Përgjegjësi i NJAB, në bazë të Planit Vjetor. Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me urdhrin e ministrit të financave nr. 100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me rrisqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës. Vend të veçantë në programin dhe në procesin e auditimit ka zënë edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme. Përgjithësisht referencat ligjore të vëna në programet e auditimit kanë reflektuar dispozitat dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për vitin 2019 janë planifikuar 4 auditime të kombinuar, konkretisht në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimi Financiar, Drejtoria e IMTV-së, Drejtoria e Arsim Kulturës,Sport/Arte, Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit. Referuar raportit përkatës dërguar pranë DHAB-së rezulton se janë audituar Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimi Financiar dhe Drejtoria e Arsim Kulturës,Sport/Arte, për vetë faktin se kjo njësi është angazhuar edhe në veprimtarinë e raportimit e punës së kësaj njësie për periudhën e vitit 2018, si detyrim ligjor mbështetur në ligjin nr.114/2015, raport i cili dërgohet pranë DAHB-së. Sa më sipër rezulton se nuk janë zhvilluar auditimet në sektorët me risk siç janë prokurimet apo dhe drejtoritë e IMTV-së dhe DPKZH-së. Për sa i përket auditimit i cili duhej të kryej në drejtorinë e DPKZHT-së rezultonse nuk është gjetur mirëkuptimi midis Drejtuesit të DPKZHT-së dhe kësaj njësie, *çka ka ndikuar në punën audituese në lidhje me evidentimin e problemeve si llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë, plotësueshmëria e dokumentacionit prej subjekteve të cilat aplikojnë për leje zhvillimi apo leje ndërtimi, si dhe rregullshëmëria ligjore në dhënien e lejeve.*

Për sa i përket vitit 2020, rezulton se janë planifikuar 4 auditime konkretisht Drejtoria e

Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimi Financiar, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Arsim Kulturës Publike, Drejtoria Ligjore dhe Shërbimeve Organizative. Sa më sipër është ushtruar auditim në Drejtorinë e Arsimit Kulturës dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike, ndërsa në proces rezulton Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar lidhur me detyrimet e prapambetura. Rezulton se nuk janë planifikuar auditime për sa i përket çështjeve me risk, siç janë prokurimet apo dhe drejtoritë e IMTV-së dhe DPKZH-së.

- Zbatimi i planeve të auditimit të brendshëm. Hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditimit:

Për veprimtarinë e Sektorit të AB për periudhën nga data 01.01.2019 deri në 30.06.2020është raportuar në mënyrë sistematike Kryetarit të Bashkisë Tepelenë.

Pasqyra e planifikimit dhe realizimit të auditimeve të brendshme për vitin 2019 dhe rekomandimet e dhëna.

2019					
Plan	Fakt	Rekom	Zbat.	Pa zbat.	Në proc.
4	2	6	6	0	0

Nga auditimi i raportimit vjetor 2019, konstatojmë se janë dhënë gjithsej 6 rekomandime me karakter organizativ, nga të cilat jane pranuar 6

Pasqyra e planifikimit dhe realizimit të auditimeve të brendshme për vitin 2020

6-mujori I 2020					
Plan	Fakt	Rekom	Zbat.	Pa zbat.	Në proc.
4	3	6	6	0	0

- Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015 ñ*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*ò,Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB)

Subjektet e audituara edhe pse i kanë pranuar rekomandimet e dhëna nga AB dhe në përgjithësi i kanë zbatuar ato, kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimit, në përputhje me ligjin 114/2015 ñ*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*ò, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB.

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se NjAB, administron dokumente që vërtetonin se në çdo auditim ka zbatuarprogramin e sigurimit të cilësisë së AB, në përputhje me Kap. VII, pika 7.1, dhe 7.1.1, të MAB.

Nga auditimi i projekt raportit dhe raportit përfundimtar, rezulton se në procesin audites në përgjithësi, nga audituesit e brendshëm janë zbatuar standardet e përcaktuara në MAB, në përmbajtje dhe në formë.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve tëbëra nëManualin e Auditimit tëBrendshëm, (Kapitulli VI, ñ*Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese*ò), në përgjithësi programet kanëpërmbledhur orientimet kryesore tëveprimit nëpërputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnënëmënyrëtëqartëemërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet qëdo tëndiqen dhe grupin e auditimit.Gjithsesi, duke marrë në konsideratë edhe problematikën aktuale, nga NjAB duhet tôi kushtohet më shumë rëndësi auditimeve me risk të lartë, siç janë prokurimet publike, lejet e ndërtimit etj. Vend tëveçantënëprogram zëedhe ndjekja e zbatimit tërekomandimeve tëdhëna nga auditimet e mëparshme. Nëpërgjithësi referencat ligjore tëvëna nëprogramet e auditimit reflektojnëkuadrin ligjorënëfuqi.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015 datë 06.11.2015, ñ*Për Auditimin e Brendshëm ne Sektorin Publik*ò, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñ*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brëndshëm në Sektorin Publik*ò, Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10 2016, ñ*Për miratimin e Manualit te Auditimit te Brendshëm në sektorin publik*ò, Rregullorja e Bashkisë Tepelenë, neni 24.

Ndikimi/Efekti: Mos evidentimi i problematikave dhe risqeve të mundshme në sektorët më me risk dhe prioritar të Bashkisë Tepelenë.
Shkaku: Moszbatim i kërkesave të akteve ligjore të sipërcituara, Neglizhenca dhe mos përmbushja e angazhimeve për auditim sipas planifikimit të bërë.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga kryetari i Bashkisë Tepelenë, të merren masa për të plotësuar strukturën e sektorit të auditimit të brendshëm, si dhe të ngrihet një komision i cili të adresojë problemin e refuzimit të auditimit nga drejtori i DPKZHT-së.
Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, të merren masa që në të ardhmen të zbatohen kriteret ligjore dhe nënligjore për auditimin e sektorëve më me risk në Bashkinë Tepelenë, si dhe planifikimi i auditimeve të bëhet duke filluar nga sektorët me risk më të lartë. Gjithashtu, në përfundim të procesit të auditimit në njësitë e audituara, të kryhet monitorimi i zbatimit të rekomandimeve. Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm të vendosë dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit, sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi:
Z. T. P., Kryetar i bashkisë,
Znj. A. S., specialiste e auditimit të brendshëm

2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", ligjet vjetore "*Për buxhetin e shtetit*" të vitit 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit

2.2.1. Programimi i PBA për periudhëen 2019-2020 dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2019 dhe 2020

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizmit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës Covid 2019, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.
Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministritë e linjës etj.).

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR etj, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe nxjenja e detyrimeve tatimore e ndarë sipas viteve.

Titulli i gjetjes: Në buxhetin e miratuar për vitin 2019, nuk është programuar si zë më vete likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës si më poshtë:
- 31,109,492 lekë, llogaritë 401-408 - *Furnitorë e llogari të lidhura me to* dhe
- 23,818,452 lekë, llogaria 467- *Kreditorë të ndryshëm*.
- Në buxhetin e miratuar për vitin 2020, nuk është programuar si zë më vete likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës si më poshtë:

- 26,833 mijë lekë detyrime *furnitorë e llogari të lidhura me to*, llog. 401-408,
- 4,088 mijë lekë *detyrime ndaj shtetit për tatim taksat*, llog. 431,
- 11,409 mijë lekë *detyrime për Sig. shoqërore dhe shëndetësore*, llog. 435 dhe 436
- 39,974 mijë lekë - *Kreditorë të ndryshëm*, llogaria 467.

Situata: Nga Bashkia Tepelenë, janë miratuar treguesit e buxhetit afatmesëm (PBA) për periudhën e viteve 2018-2020.

PBA, është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 43, datë 21.12.2017 dhe me shkresën nr. 52, datë 15/01/2018 i është përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ñ*Drejtoria e Financave të pushtetit vendor*ò.

Treguesit e miratuar të PBA sipas llojeve të projekteve, janë si në Pasqyrën nr. 2.1 bashkëlidhur.

- Në programimin e buxheteve afatmesëm(PBA) për periudhat 2018-2020, konstatohet se përgjithësisht janë zbatuar procedurat ligjore, treguesit e buxhetit afatmesëm. Konkretisht, janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë:

a) Kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor është miratuar brenda datës 31 Dhjetor të vitit paraardhës, në zbatim të kërkesave të nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 44, datë 21.12.2017 ñ*Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor*ò, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Gjirokastër me nr. 2784/1, datë 05.01.2018.

b) Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm janë miratuar brenda datës 20 Korrik (të vitit paraardhës), në zbatim të kërkesave të nenit 37 të ligjit nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 285, datë 28/07/2017 ñ*Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm 2018-2020*ò, konfirmuar nga Prefekti Qarkut me shkresën nr. 1431/1, datë 11.08.2017.

c) Janë miratuar Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve, kërkesë në zbatim të kërkesave të nenit 34 të ligjit nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò.

Për vitin 2019

Buxheti i Bashkisë Tepelenë, është miratuar me Vendimin nr. 76 datë 28.12.2018 të Këshillit Bashkiak ñ*Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Tepelenë për vitin 2019*ò, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 3/1 datë 11.01.2019.

Gjatë vitit, buxhetit i është bërë një ndryshime i miratuara me Vendim të Këshillit të Bashkisë i cili konsiston në:

1- Shtesë transfertë e pakushtëzuar

Ky ndryshim është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 75, datë 31.10.2019 ñ*Për disa ndryshime në VKB nr. 76, datë 28.12.2018*ò, konfirmuar nga Prefekti me shkresën nr. 1587/1, datë 14.11.2019.

Për periudhën objekt auditimi 1 Tetor deri më 31 Dhjetor 2019, buxhetit i janë bërë ndryshime miratuar me Vendime të Këshillit të Bashkisë, nr. 75, datë 31.10.2019 ñ*Për disa ndryshime në VKB nr. 76, datë 28.12.2018*ò, konfirmuar nga Prefekti me shkresën nr. 1587/1, datë 14.11.2019.

Programimi i buxhetit për v. 2019 dhe pasqyra mbi krahasimin e buxhetit vjetor me PBA për 2019, janë si në pasqyrën nr. 2.2 bashkëlidhur.

Bashkëlidhur është pasqyra nr. 2.3 mbi realizimin faktik të tregueseve të buxhetit v. 2019 sipas akt rakordimit me degën e thesarit.

Për vitin 2019, buxheti është realizuar në total në masën 96.2% ose nga 335,977 mijë lekëtë programuara, realizuar 323,300 mijë lekë. Në zërin investime llogaria ekonomike 231, është realizuar në masën 86.7% ose nga 37,613 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 32,616 mijë lekë nga të cilat nga të ardhurat e veta në vlerën 3,443 mijë lekë ose 10.5% të totalit të

investimeve.
- Transferta e kushtëzuar programuar në shumën 129,875 mijë lekë, është programuar për tu përdorur sipas analizës që vijon:
Shpenzime korente për Gj. Civile në shumën 1.829 mijë lekë
Shpenzime korente për QKB në shumën 1.548 mijë lekë
Shpenzime për Nd. ekonomike dhe paaftësinë në shumën 92,627 mijë lekë
Shpenzime për bonus qiraje në shumën 1,674 mijë lekë
Shpenzime për investime në shumën 34,434 mijë lekë të specifikuar për sipas objekteve dhe sipas burimit të të ardhurave.
Më hollësisht analizuar sipas të dhënave në pasqyrën nr. 2.4 bashkëlidhur.
Por janë programuar si zë me vete në buxhetin e këtij viti, shlyerja e një pjesë të detyrimeve të trashëguara nga viti paraardhës në shumën 10,000 mijë lekë, nga të cilat për detyrimet:
- Mallra e shërbime 8,500 mijë leke
- Vendime gjyqësore 1,500 mijë lekë.
Në fund të vitit 2019, kanë rezultuar të papërdoruara fonde në shumën 907 mijë lekë të cilat janë transferuar për llogari të vitit 2020, ndërkohë që kanë rezultuar detyrime të papaguara në shumën 82,304 mijë lekë:
- 26,833 mijë lekë detyrime *furnitorë e llogari të lidhura me to*, llog. 401-408,
- 4,088 mijë lekë *detyrime ndaj shtetit për tatim taksat*, llog. 431,
- 11,409 mijë lekë *detyrime për Sig. shoqërore dhe shëndetësore*, llog. 435 dhe 436
- 39,974 mijë lekë *Kreditorë të ndryshëm*, llogaria 467.
Në shumën e detyrimeve kreditore, janë përfshirë edhe detyrimet sipas vendimeve gjyqësore për 5 subjekte në shumën totale 4,018,595 lekë.
Analizuar më hollësisht pasqyra nr. 2.5 bashkëlidhur.
Realizimi i tregueseve të buxhetit 2019.
-Shpenzimet për investime; të programuara për vitin 2019, miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë janë në shumën 17,900 mijë lekë.
Në fakt janë financuar gjatë vitit 3 objektet e investuara për vlerën totale 24,071 mijë lekë.
Më hollësisht si në pasqyrën nr. 2.6 bashkëlidhur.
Për vitin 2019, nuk janë programuar shpenzime për përballimin e COVID-19.
Nga auditimi mbi zbatimin e buxheteve vjetore për Bashkinë Tepelenë për vitin 2019 u konstatua se realizimi i tregueseve të buxhetit për vitin 2019, janë miratuar me VKB nr. 18, datë 19.03.2020 ñ*Për miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2019*ò dhe konfirmuar nga Prefekti me shkresën nr. 326/1, datë 25.03.2020, në këtë rast më zbatim të kërkesave të nenit 46, të ligjit nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò.
<u>Për vitin 2020</u>
Buxheti i Bashkisë Tepelenë, është miratuar me Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 90, datë 20.12.2019 ñ*Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Tepelenë për vitin 2020*ò, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me nr. 1794/1 datë 06.01.2020.
Gjatë vitit, buxhetit i janë bërë disa ndryshime të miratuara me Vendime të Këshillit të Bashkisë të cilat konsistojnë në:
1. Shpenzime të paparashikuara për situatën Covid-19
2. Për shtesë transferte.
Këto ndryshime janë miratuar me Vendimet e Këshillit Bashkiak nr. 17, datë 19/03/.2020 ñ*Për disa ndryshime në VKB nr. 90, datë 20.12.2019.*ò dhe nr. 59 datë 01.10.2020 ñ*Për disa ndryshime në VKB nr. 90, datë 20.12.2019.*ò
Programimi i buxhetit për v. 2020 dhe pasqyra mbi krahasimin e buxhetit vjetor me PBA për 2020, janë *si në pasqyrën nr. 2.7 bashkëlidhur.*
Realizimi i tregueseve të buxhetit sipas natyrës së shpenzimeve, janë *si në pasqyrën nr. 2.8 bashkëlidhur.*

- Transferta e kushtëzuar në shumën 193,880 mijë lekë, është programuar për tu përdorur për:
- Shpenzime korente për Gj. Civile në shumën 2,306 mijë lekë, nga këto 395 mijë lekë shpenzime për shpërblim lindje
- Shpenzime korente për QKB në shumën 1,556 mijë lekë.
- Shpenzime për ndihmë ekonomike dhe paaftësi në shumën 110,470 mijë lekë
- Shpenzime për bonus qiraje në shumën 2,412 mijë lekë përdoruar në fakt 2,411 mijë lekë.
- Investime në shumën 10.000 mijë lekë.
- Në programimin e buxhetit për vitin 2020, janë parashikuar si zë më vete, shlyerja e një pjesë të detyrimeve nga viti i kaluar për vlerën 23,606 mijë lekë, nga të cilat:
Për shlyerje detyrime të prapambetura sigurime shoqërore 13,606 mijë lekë
Për mallra e shërbime 8,500 mijë lekë
Vendime gjyqësore 1,500 mijë lekë.
Mos programimi i detyrimeve të vitit paraardhës si zë më vete në buxhet, është ***në kundërshtim*** me kërkesat e nenit 101 të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 ñ*Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit*ò.
- Shuma e detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti 2019 paraardhës që sipas pasqyrave financiarë kanë rezultuar detyrime të pa paguara në shumën 82,304 mijë lekë:
- 26,833 mijë lekë *detyrime furnitorë e llogari të lidhura me to*, llog. 401-408,
- 4,088 mijë lekë *detyrime ndaj shtetit për tatim taksat*, llog. 431,
- 11,409 mijë lekë *detyrime për Sig. shoqërore dhe shëndetësore*, llog. 435 dhe 436
- 39,974 mijë lekë *Kreditorë të ndryshëm*, llogaria 467.
Në fund të viti 2020, kanë rezultuar të pa përdoruara fonde në shumën 2,353 mijë lekë të cilat janë transferuar për llogari të vitit 2021, ndërkohë që kanë rezultuar detyrime të pa paguara në shumën 62,008 mijë lekë:
- 26,767 mijë lekë *detyrime furnitorë e llogari të lidhura me to*, llog. 401-408,
- 359 mijë lekë *detyrime ndaj shtetit për tatim taksat*, llog. 431,
- 3,593 mijë lekë *detyrime për Sig. shoqërore dhe shëndetësore*, llog. 435 dhe 436
- 31,289 mijë lekë *Kreditorë të ndryshëm*, llogaria 467.
Në shumën e detyrimeve kreditore, janë përfshirë edhe detyrimet sipas vendimeve gjyqësore të cilat janë për 7 subjekte në shumën totale 5,664,236 lekë, më hollësisht *si në pasqyrën nr. 2.9 bashkëlidhur.*

Realizimi i tregueseve të buxhetit 2020.

- Janë miratuar në Këshillin e Bashkisë, objektet e investimeve me procedurën e prokurimit me tender, në 4 raste në vlerën totale 136,391,381 lekë, në zbatim të kërkesave të nenit 40 të ligjit nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò dhe e pikës 9, Kap. I të UMF Plotësues nr. 8, datë 29.03.2012 ñ*Për procedurat standard të përgatitjes së buxhetit afatmesëm*ò, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 90, datë 20.12.2019, Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 47, datë 30.07.2020.
Shpenzimet e programuara për investime në mënyrë të detajuar sipas vlerës dhe burimit të financimit, jepen *si në pasqyrën nr. 2.10 bashkëlidhur.*
Nga auditimi mbi zbatimin e buxheteve vjetore për Bashkinë Tepelenë për vitin 2020 u konstatua se:
Realizimi i tregueseve faktikë të buxhetit për vitin 2020, është miratuar me VKB nr. 14 datë 26.02.2021 ñ*Për miratimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit për vitin 2020*ò konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 226/1, datë 10.03.2021, në zbatim të kërkesave të nenit 46, të ligjit nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò.

Shpenzime për COVID-19.

Për vitin 2020, janë programuar shpenzime për përballimin e COVID-19, në shumën totale 3,000,000 lekë, të analizuara sipas zërave ñ*Shpenzime operative*ò llog. 602. Miratimi i fondeve është me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 17, datë 19.03.2020. Janë përdorur sipas

pagesave si vijon për shumën totale 1,258 mijë lekë:
- Me U. shpenzimin nr. 185 dhe nr. 186 datë 15.04.2020, është paguar subjekti S. A. në shumën totale 535,664 lekë përkatësisht fatura nr. 32 datë 14.04.2020 për blerje paketë ushqimore për familjet në nevojë 333,360 lekë dhe fatura nr. 33 datë 14.04.2020 për blerje maska e doreza 120,000 lekë.
- Me U. shpenzimet nr. 190 dhe nr. 191 datë 16.04.2020, është paguar subjekti P. C. në shumën totale 604,980 lekë përkatësisht fatura nr. 26 datë 15.04.2020 për blerje paketë higjeno sanitare për 451,980 lekë dhe fatura nr. 28 datë 16.04.2020 për blerje pakete ushqimore Covid - 19 për 153,000 lekë.
- Me U. shpenzimin nr. 536 datë 24.11.2020, është paguar subjekti A. O. në shumën 117,600 lekë për blerje materiale anti COVID-19.

Kriteri: Mos programimi si zë më vete në buxhet të detyrimeve të vitit paraardhës, është ***në kundërshtim*** me kërkesat e nenit 101 të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò.

Ndikimi/Efekti: Mos programimi si zë më vete në buxhetin e vitit ushtrimor për të paguar detyrimet e prapambetura, ka vështirësuar gjendjen financiare të Bashkisë Tepelenë.

Shuma e detyrimeve kreditore në vitin 2018, sipas pasqyrave financiare, ishte 54,928 mijë lekë, kurse në fund të viti 2019 ishte në shumën 82,304 mijë lekë ose rritur me 50%.

Shkaku: Mungesa e një analize financiare në programimin e buxheteve si dhe mos respektimin e kërkesave ligjore për programimin e buxheteve.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Bashkia Tepelenë, të marrë masat, të rishikojë buxhetin vjetor me synim përmirësimin e situatës financiare duke programuar pagesën e detyrimeve të trashëguara si dhe për të patur një buxhet të balancuar, në zbatim të kërkesave ligjore.

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe nxjerrja e detyrimeve tatimore e ndarë sipas viteve.

Titulli i gjetjes: Lënie vakante e pozicionit të përgjegjësit të zyrës së Sektorit të zhvillimit ekonomik, i cili është përgjegjës për të ardhurat Vendore. Pamjaftueshmëri e burimeve njerëzore të angazhuara me vjeljen e taksave dhe tarifave vendore.

Situata:Në Bashkinë Tepelenë, për vitin 2020, numri i përgjithshëm i punonjësve dhe niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 91, datë 20.12.2019, e konfirmuar nga Prefekti Gjirokastër me shkresën nr. 1794/1 Prot., datë 06.01.2020, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë sëzhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, në përbërje të së cilës është Sektori i zhvillimit ekonomik, përgjegjës për të ardhurat Vendore. Ky Sektor ka në përbërje 3 punonjës, nga të cilët 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Vendi i Përgjegjësit të sektorit ka qenë vakant për të gjithë periudhën e audituar, duke ndikuar shumë në problematikat e krijuara në lidhje me mënyrën e menaxhimit dhe vjeljes së detyrimeve vendore, përfshirë edhe njoftimet e debitorëve, zbatimin e masave shtrënguese, gjë që ka shkaktuar nivele të larta detyrimesh të paarkëtuara, si nga biznesi, ashtu edhe nga popullata. Në njësitë administrative nuk ka persona të ngarkuar posaçërisht me vjeljen dhe ndjekjen e taksave e tarifave vendore.

Kriteri: Ligji nr. 139/2015, ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, neni 9 ñ*Të drejtat dhe përgjegjësitë*ò, pika 1.1, germa c); neni 54 ñ*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*ò, germa ç); neni 64, ñ*Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë*ò, germa j); Ligji nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, nenet 1, 2, 7, 42, 54, Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, nenet 2, 4, 5, 13, 15, VKB për miratimin e strukturës dhe pagave në Bashkinë Tepelenë, etj.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në mbarëvajtjen e funksionimit dhe menaxhimit të proceseve në lidhje me të ardhurat nga taksat/tarifat, krijimin e subjekteve debitore dhe pamundësi në ndjekjen e procedurave dhe njoftimeve për detyrimet tatimore, etj.
Shkaku: Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjeve të mësipërme, si dhe moskonsolidim i tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të njësisë, duke reflektuar kështu nivel të lartë të riskut.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim:Këshilli Bashkiak, të marrë masat e duhura për të rishikuar organikën, duke krijuar një strukturë të posaçme tatimore, të veçuar nga struktura e menaxhimit dhe mbledhjes së të ardhurave të tjera, (siç është aktualisht në varësi të drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar), në mënyrë që të mos krijohen mangësi në mbledhje e të ardhurave tatimore dhe të minimizohet numri dhe vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat. Kryetari i Bashkisë Tepelenë, deri në rishikimin dhe miratimin e strukturës së posaçme tatimore nga Këshilli Bashkiak, të marrë masa për të plotësuar vendet vakante në strukturën aktuale, deri në miratimin e strukturës së re nga Këshilli Bashkiak.

Këshilli Bashkiak Tepelenë, ka vendosur me VKB-në ñ*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Tepelenë dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative*ò afatin e fundit të pagesës së detyrimit datën 30 qershor të çdo viti.
Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve
Për vitin 2019, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Tepelenë, është miratuar me VKB-në nr. 74, datë 28/12/2018, e konfirmuar nga Prefekti Gjirokastër me shkresën nr. 3/1, datë 11/01/2019, ñ*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Tepelenë*ò.
Për vitin 2020, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Tepelenë është miratuar me VKB-në nr. 88, datë 23/12/2019, e konfirmuar nga Prefekti Gjirokastër me shkresën nr. 1794/1, datë 06/01/2020, ñ*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Tepelenë*ò.
Referuar planit vjetor të miratuar dhe aktrakordimit me Degën e Thesarit Tepelenë parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitet 2019 dhe 2020 paraqitet i detajuar në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.1.**

Titulli i gjetjes: Performancë e dobët në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave për periudhën objekt auditimi.
Situata: Nga auditimi (të dhënat e pasqyrës 2.2.6.1.), u konstatua se *për vitin 2019*, të ardhurat nga 42,099,000 lekë të planifikuara janë realizuar 35,707,696 lekë, pra me një mosrealizim në shumën 6,391,304 lekë ose 15.2% dhe *për vitin 2020*, të ardhurat nga 42,500,000 lekë të planifikuara janë realizuar 37,591,480 lekë, pra me një mosrealizim në shumën 4,908,520 lekë ose 11.6%. Po të analizojnë disa nga taksat dhe tarifat, në masën më të madhe rezultojnë me mosrealizime ose për disa të tjera në realizime mbi planin. Kështu, referuar Pasqyrës 2.2.6.1., konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim, i cili ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.
Sektori i zhvillimit ekonomik, kryen procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për taksat dhe tarifat e miratuara nga Këshilli bashkiak në paketat fiskale përkatëse për biznesin. Për këto të ardhura, akt-rakordimet janë kryer nga R. H. që evidenton dhe kryen aktrakordimet me degën e Thesarit Tepelenë për të ardhurat në Drejtorinë e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar në Bashkinë Tepelenë. Sipas aktrakordimeve të DTTV

planifikimi dhe realizimi i të ardhurave që menaxhon kjo Drejtori për periudhën 2019 dhe viti 2020 paraqitet në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.2.**

Realizimi i të ardhurave sipas viteve të rakorduara me thesarin, në vlerë dhe në përqindje për vitet 2019 dhe 2020 janë paraqitur në Tabelën më sipër dhe janë analizuar më poshtë:

Për vitin 2019, ka pasur mosrealizim të planit të përgjithshëm të të ardhurave në masën 15.2% ose 6,391,304 lekë. Ky mosrealizim përgjithësisht bazohet në mosrealizimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, taksa e pasurisë dhe nga tarifat e ndriçimit dhe gjelbërimit të cilat janë argumentuar si më poshtë:

Taksa e tokës është realizuar në masën 18.2%. Nga zyra e taksave, ky mosrealizim argumentohet pasi nisur nga arkëtimet e vitit 2018, taksa mbi tokën bujqësore është parashikuar duke marrë si bazë jo vetëm totalin e arkëtueshëm gjatë vitit kalendarik por duke futur edhe një pjesë të taksave të papaguara nga familjet që kanë përfituar tokë me ligjin 7501.

Taksa e ndërtesës është llogaritur si detyrim i biznesit të madh dhe të vogël për vitin 2019 si dhe taksat e banesave. Kjo taksë është realizuar në masën 25.6%.

Tarifa e pastrimit dhe higjienës është parashikuar nisur nga numri i bizneseve dhe familjarëve të cilët duhet të shlyejnë detyrimet e tyre për vitin 2019 në të gjithë territorin e Bashkisë Tepelenë. Në taksën e pastrimit është parashikuar edhe vlera që familjarët duhet të shlyejnë për vitin 2019. Kjo taksë është realizuar në masën 86%.

Taksa e tabelës është realizuar në masën 178%.

Tarifat për leje transporti, etj., janë parashikuar për subjektet e transportit që pritet të bëjnë rinovime të lejeve në Bashkinë Tepelenë për vitin 2019. Kjo taksë është realizuar në masën 137%.

Taksa mbi ndikimin në infrastrukturë është parashikuar duke pasur një pritshmëri të lartë për legalizimin e objekteve nga individët që janë banorë të Bashkisë Tepelenë si dhe për dhënien e lejeve të ndërtimit apo autorizimeve për punime, të cilat lëshohen nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit. Kjo taksë është realizuar në masën 217%.

Taksa e zënies së hapësirës publike është realizuar në masën 159%.

Për sa i përket përdorimit të ardhurave, janë përdorur sipas planifikimit buxhetor, ndërsa pjesa e papërdorur është mbartur në buxhetin e vitit pasardhës.

Për vitin 2020, ka pasur mosrealizim të planit të përgjithshëm të të ardhurave në masën 12% ose 4,908,520 lekë. Ky mosrealizim përgjithësisht bazohet në 1,346,075 lekë e të ardhurave nga tarifa e ndriçimit, nga të ardhura të tjera administrative + gjobat, në shumën 1,860,907 lekë, taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë në shumën 1,701,538 lekë, etj. Tejkalimet dhe mosrealizimet janë argumentuar si më poshtë:

Taksa e tokës është realizuar në masën 99%.

Taksa e ndërtesëseshtë llogaritur si detyrim i biznesit të madh dhe të vogël për vitin 2020 si dhe taksat e banesave. Kjo taksë është realizuar në masën 33%.

Tarifa e pastrimit dhe higjienës është parashikuar nisur nga numri i bizneseve dhe familjarëve të cilët duhet të shlyejnë detyrimet e tyre për vitin 2020 në të gjithë territorin e Bashkisë Tepelenë. Në taksën e pastrimit është parashikuar edhe vlera që familjarët duhet të shlyejnë për vitin 2020. Kjo taksë është realizuar në masën 97%.

Taksa e tabelës është realizuar në masën 217%.

Tarifat për leje transporti, etj., janë parashikuar për subjektet e transportit që pritet të bëjnë rinovime të lejeve në Bashkinë Tepelenë për vitin 2020. Kjo taksë është realizuar në masën 170%.

Taksa mbi ndikimin në infrastrukturë është parashikuar duke pasur një pritshmëri të lartë për legalizimin e objekteve nga individët që janë banorë të Bashkisë Tepelenë si dhe për dhënien e lejeve të ndërtimit apo autorizimeve për punime, të cilat lëshohen nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit. Kjo taksë është realizuar në masën 79%.

Tarifat e tjera administrative, ku futen renta minerare, taksa vendore për fjetjen, tarifat e parkimit, të ardhurat nga qira toke + trualli etj., e cila është realizuar në masën 70%, ka krijuar një pjesë të madhe të mosrealizimit.
Taksa e zënies së hapësirës publike është realizuar në masën 130%.
Për sa i përket përdorimit të ardhurave, janë përdorur sipas planifikimit buxhetor, ndërsa pjesa e papërdorur është mbartur në buxhetin e vitit pasardhës.
Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 ñ*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*ò i ndryshuar, neni 5, ñ*Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore*ò, neni 54, ñ*Raportimi financiar*ò nënpika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV ñ*Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave*ò pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për Sistemin e Taksave Lokale*ò, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti: Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave si dhe mbajtja e një pjesë të taksave dhe tarifave që menaxhohen nga DTTV jashtë kontabilitetit.
Shkaku: Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia: E mesme
Rekomandim: Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, Sektori i zhvillimit ekonomik (tatim-taksa) në Bashkinë Tepelenë gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:
Z. G. G., me detyrë Specialist në Sektorin e zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa);
Z. R. H., me detyrë Specialist në Sektorin e zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa).

Titulli i gjetjes: Të ardhura të munguara nga dhënia me qira e aseteve të Bashkisë, si troje, toka bujqësore, pyje e kullota.
Situata: Nga verifikimi i kontratave të qirasë për terrenet shtetërore (troje, lulishte, trotuare, etj.), u konstatua se për vitin 2019 janë lidhur gjithsej 21 kontrata, me të ardhura të pritshme në vlerën 3,013,157 lekë, ndërsa për vitin 2020, janë lidhur 20 kontrata, shuica e të cilave ekzistuese nga viti 2019, me të ardhura të pritshme në vlerën 2,831,157 lekë. Gjatë vitit 2019 janë arkëtuar 2,786,697 lekë ndërsa gjatë vitit 2020 janë arkëtuar 1,487,611 lekë. Diferenca prej **1,570,006 lekë**, (226,460 lekë nga viti 2019 dhe 1,343,546 lekë nga viti 2020), përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë.
Terrenet shtetërore të dhëna me qiranë Bashkinë Tepelenë, janë përmbledhur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.5.**
Gjatë viteve 2019 dhe 2020, në Njësinë Administrative Lopës, pjesë e Bashkisë Tepelenë janë lidhur gjithsej 30 kontrata qiraje për tokë bujqësore, me afat nga 6 muaj, deri në 1 vit. Nga auditimi i kontratave, u konstatua se nuk kanë paguar detyrimet 2 qiramarrës për vitin 2019, në vlerën totale 20,000 lekë dhe 11 qiramarrës për vitin 2020, në vlerën totale 269,600 lekë. Vlera prej **289,600 lekë** (20,000 lekë nga viti 2019 dhe 269,600 lekë nga viti 2020), përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, nga mosvjelja e qirasë së tokave bujqësore në Njësinë Administrative Lopës.

Për vlerat debitore nga Bashkia Tepelenë nuk janë llogaritur kamatëvonesat, sipas kërkesave të kontratës tip dhe VKM-së nr. 373, datë 20.06.2018, ñ*Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*ò, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò,
Tokat bujqësore të dhëna me qiranë Bashkinë Tepelenë, Njësia Administrative Lopës, janë përmbledhur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.6.**
Kriteri: Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 ñ*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*ò i ndryshuar; Ligji nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò; Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 ñ*Për tokën*ò, i ndryshuar; Ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, ñ*Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*ò, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për tôu lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò, etj.
Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në nivelin e të ardhurave nga qiradhënia e aseteve të bashkisë, në vlerën **1,859,606 lekë** (pa kamatëvonesat), si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Tepelenë.
Shkaku: Mosndjekja e procedurave nga strukturat përgjegjëse. Mangësi në përcaktimin specifik të detyrave dhe mungesë e personelit përgjegjës.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Sektori i zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa) në Bashkinë Tepelenë, në bashkëpunim me Njësitë Administrative dhe Drejtorinë ligjore dhe të shërbimeve organizative, të marrin masa për të nxjerrë njoftim-vlerësimet për detyrimet e papaguara nga qiramarrësit e listuar në pastyrat 2.2.6.5. dhe 2.2.6.6., në vlerën neto **1,859,606 lekë** duke llogaritur kamatëvonesat dhe sanksionet e tjera përkatëse (nëse ka), për secilin rast, si dhe të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara, për të gjitha detyrimet kontraktuale të pa mbledhura.
Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:
Z. G. G., me detyrë Specialist në Sektorin e zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa);
Z. R. H., me detyrë Specialist në Sektorin e zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa).

Titulli i gjetjes: Të ardhura të munguara nga pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara.
Situata: Nga auditimi i pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara, u konstatua se gjatë vitit 2019 nuk e kanë paguar këtë taksë 3 persona, në vlerën totale 21,772 lekë dhe gjatë vitit 2020 nuk e kanë paguar 5 persona në vlerën totale 99,143 lekë.
Vlera prej **120,915 lekë** (21,772 lekë për vitin 2019 dhe 99,143 lekë për vitin 2020) përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, nga mosvjelja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara.
Debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara për vitin 2019 janë përmbledhur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.9.**
Debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara për vitin 2020 janë përmbledhur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.10.**

Kriteri: Ligji nr. 9482 datë 03.04.20106, ñ*Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*ò i ndryshuar, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar; VKB Tepelenë ñ*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Tepelenë*ò, etj.
Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në vlerën **120,915 lekë,** nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit nga përfituesite lejes së legalizimit.
Shkaku: Mos bashkëpunimi i fortë me ASHK-në dhe mosmarrja e masave të duhura për parandalimin e dhënies së lejeve të legalizimit pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë pranë Bashkisë Tepelenë nga subjektet private dhe individët për objektet në proces legalizimi.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkia Tepelenë nëpërmjet bashkëpunimit institucional tëi kërkojë ASHK-së, Drejtoria Tepelenë, që të mos lëshojë dhe të pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Tepelenë. Drejtoria e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e listuar si debitorë në **Pasqyrat 2.2.6.9.** dhe **2.2.6.10,** bazuar në legjislacionin tatimor.
Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:
Z. G. G., me detyrë Specialist në Sektorin e zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa);
Z. R. H., me detyrë Specialist në Sektorin e zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa).

Titulli i gjetjes: Mangësi në evidentimin dhe vlerësimin e nivelit të detyrimeve debitore, kontabilizimet dhe procedurat e ndjekjes së borxhit tatimor për subjektet që ushtrojnë aktiviteët në Bashkinë Tepelenë.
Situata:Për vitin 2019 janë bërë 410 njoftim-kërkesa të pagesës së debisë dhe 0 njoftime për vendosje të masave siguruese, si dhe 0 masa shtrënguese (në Bankë, në ZRPP, në KSHA, në QKB) e 0 masa ekzekutuese (kalim gjëndje llog. bankare në llog. Bashkisë) me efekt të mbledhjes së borxhit.
Për vitin 2020 janë bërë 434 njoftim-kërkesa të pagesës së debisë dhe 0 njoftime për vendosje të masave siguruese, si dhe 0 masa shtrënguese (në Bankë, në ZRPP, në KSHA, në QKB) e 0 masa ekzekutuese (kalim gjëndje llog. bankare në llog. Bashkisë) me efekt të mbledhjes së borxhit.
Për institucionet shtetërore të identifikuara si debitorë është ndjekur vetëm proçedura e nxjerrjes së Njoftimit për Pagesë të DetyrimeveTatimore dhe nuk është vazhduar me asnjë proçedurë tjetër e parashikuar në aktet ligjore përkatëse.
Sa më sipër, nuk gjen zbatim ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, neni 89 ñ*Njoftimi dhe kërkesa për të paguar"*.
Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitore, strukturat tatimore të Bashkisë Tepelenë, nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë, duke vepruar në mospërputhje ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore*ò, me ndryshime, Kreut XI, ñ*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*ò, neni 93 dhe 94.
Nga strukturat tatimore të Bashkisë Tepelenë, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim penal** bazuar në

nenin 181, ñ*Mos pagimi i taksave dhe tatimeve*ò, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.
Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, i ndryshuar neni 9 ñ*Të drejtat dhe përgjegjësitë*ò pika 1.3., neni 35, ñ*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*ò, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.
Niveli i lartë e debitorëve. Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i zhvillimit ekonomik në Bashkinë Tepelenë, rezultoi se ka 247 subjekte debitore nga biznesi (subjekte juridike, fizike dhe institucione). Numri i debitorëve nga biznesi si në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesat përkatëse), nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu fund të vitit 2019 numri i debitorëve ishte 197 subjekte në vlerën **10,341,288 lekë**, ndërsa në fund të vitit 2020 numri i debitorëve ishte 247 subjekte në **vlerën 13,364,487 lekë**. Kamatëvonesa për këtë shumë detyrimesh është në **vlerën 2,926,822 lekë.** Vlera debitore për vitin 2020 ka qenë **3,023,199 lekë**, e cila përfaqëson taksat dhe tarifat vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Tepelenë.
Vlera e debitorëve e ndarë sipas viteve, numrit dhe sipas biznesit, në mënyrë të përmbledhur paraqitet në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.13.**
Vlera e debitorëve e paraqitur e ndarë në vlerë principali plus kamatvonesë e përllogaritur (0,06 % për çdo ditë vonesë) dhe numrit të subjekteve paraqitet në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.14.**
Numri i subjekteve dhe vlera e debitorëve gjendje në fund të vitit ushtrimor e ndarë sipas NJA paraqitet në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.15.**
Debitorët të rezultuar brenda vitit ushtrimor të ndarë sipas llojeve të taksave të mësipërme për vitet, 2019 dhe 2020 paraqiten në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.16.**
Referuar pasqyrave dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga DTTV, konstatohet se nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta të debitorëve që në krijimin e tyre sipas llojit të taksave, pasi debitorët e krijuar para vitit 2019, duke filluar nga viti 2011 janë mbajtur në programin Excel i cili është mbajtur në listim subjektesh debitore me shumë progresive të debisë deri në fund të 2018, pa analizë detyrimesh sipas llojit të taksave të ngarkuara për çdo subjekt.
Subjetet juridike debitore, me vlerat e debisë dhe kamatëvonesat përkatëse janë paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.17.**
Nga auditimi i pagesave të kryera nga institucionet që operojnë në Bashkinë Tepelenë, u konstatuan detyrime të pavjela nga 4 institucione, në vlerën **499,741 lekë**, konkretisht 343,600 lekë detyrime dhe 75,248 lekë kamatëvonesa për periudhën 2012-2019 dhe 66,360 lekë detyrime dhe 14,533 lekë kamatëvonesa për vitin 2020).
Institucionet debitore, me vlerat e debisë dhe kamatëvonesat përkatëse janë paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.18.**
Subjetet juridike debitore për Bashkinë Tepelenë, përveç NjA Qendër, me vlerat e debisë dhe kamatëvonesat përkatëse janë paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.19.**
Subjetet juridike debitore për NjA Qendër, me vlerat e debisë dhe kamatëvonesat përkatëse janë paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.20.**
Totali i subjeteve debitore për Bashkinë Tepelenë, me vlerat e debisë dhe kamatëvonesat përkatëse janë paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.21.**
Vlera prej **16,791,051 lekë** (13,364,487 lekë detyrime dhe 2,926,822 lekë kamatëvonesa nga biznesi dhe 409,960 lekë detyrime dhe 89,781 lekë kamatëvonesa nga institucionet), përbën të ardhura të munguara (borxh tatimor) për buxhetin e Bashkisë Tepelenë.

Kriteri:Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore*ò, me ndryshime, Kreut XI, ñ*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*ò, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 ñ*Kodi Penal i RSh*ò me ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, i ndryshuar neni 9 ñ*Të drejtat dhe përgjegjësitë*ò pika 1.3., neni 35, ñ*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*ò, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.
Ndikimi/Efekti: Krijimi i një numri të madh debitorësh në vlera të konsiderueshme
Shkaku: Mos marrja e masave të plota për ndjekjen e debitorëve nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandim: Bashkia Tepelenë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pavjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj **247 subjekteve** në vlerën prej **16,291,310 lekë** *(sipas **Pasqyrave** në Anekset e Projektraportit të Auditimit)*, bazuar në nenin 70 pika 3 ñ*E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor"*, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñ*Për Procedurat tatimore*ò me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme),

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Tepelenë, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, ñ*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*ò.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

Z. G. G., me detyrë Specialist në Sektorin e zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa);
Z. R. H., me detyrë Specialist në Sektorin e zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa).

Titulli i gjetjes: Probleme me vjeljen e taksës së tokës bujqësore. Mbi procedurat e ndjekura të arkëtimit të taksës së ndërtesës dhe tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit nga abonentët familjarë. Krijimi i debitorëve dhe mosndjekja nga agjenti tatimor Ujësjellës Kanalizime sha Tepelenë. Lënia jashtë skemës së taksimit të abonentëve familjarë pa kontrata me ujësjellësin, për Njësitë Administrative Qendër, Kurvelesh dhe Lopës.
Situata: Nga auditimi i pagesave për taksën e tokës bujqësore, u konstatua se Bashkia Tepelenë nuk disponon të dhëna për familjet e trajtuara me tokë bujqësore në Njësinë Administrative Lopës. NjA Tepelenë nuk është trajtuar me tokë bujqësore, ndërsa në NJA Qendër, NjA Kuvelesh dhe NjA Lopës janë trajtuar përkatësisht 1491, 657 dhe 424 familje, të cilat kanë përfituar në total 2,572 hektarë. Aktualisht, rezulton një numër mjaft i madh i familjeve debitore për taksën e tokës, gjithsej 2,292 familje, për një vlerë totale **10,468,765 lekë**, konkretisht 5,008,132 lekë për NjA Qendër, 2,176,081 lekë për NjA Kurvelesh dhe

3,284,552 për NjA Lopës, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë.
Parashikimi për vjeljen e taksës së tokës për vitet 2019 dhe 2020 është bërë me rezervë, afërsisht 12% e detyrimit vjetor, aq sa është pritshmëria reale për të vjelë këtë lloj takse. Detyrimet e prapambetura për taksën e tokës rezultojnë në masën 88% të vlerës së përgjithshme.
Theksojmë se të dhënat e disponueshme në Bashkinë Tepelenë nuk janë të plota, pasi taksat e tokës vilen nga Njësitë Administrative dhe regjistrat mbahen prej tyre në mënyrë manuale. Sipas detyrave të administratës së NjA, të publikuar në faqen e internetit të Bashkisë Tepelenë, në njësitë administrative nuk ka persona të cilët të jenë të ngarkuar me detyrën e vjeljes së taksës së tokës dhe detyrimeve të tjera vendore. Në Bashkinë Tepelenë, menaxhimi dhe ndjekja e taksës së tokës nuk është përcaktuar saktë dhe qartë. Nuk ka asnjë akt të Këshillit Bashkiak apo të Kryetarit të Bashkisë, ku të përcaktohet se kush duhet ta menaxhojë dhe ta ndjekë këtë taksë në NjA, nga Sektori i Zhvillimit Ekonomik (tatim-taksa) apo nga Drejtoria e Zhvillimit Rural. Sipas të dhënave të disponueshme, taksa e tokës nuk është menaxhuar si në aspektin e mbajtjes së regjistrave dhe kontabilizimit të saj nga sektori i taksave dhe tarifave. Regjistrat manualë i disponojnë NjA të cilat kryejnë edhe faturimet. Debitorët nuk gjenerohen nga kontabiliteti, por vetëm nga kryqëzimi i regjistrit të familjarëve të mbajtur nga punonjësit e NjA.
Nga auditimi i procedurave të faturimit dhe arkëtimit të taksës së tokës, rezulton se faturime janë bërë dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet kur fermerët janë paraqitur pranë Njësive Administrative. Nga Bashkia Tepelenë nuk janë bërë njoftim detyrime për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistrat e NjA-ve apo të Drejtorisë së Zhvillimit Rural, gjithmonë nëse ka evidentim të plotë të tyre, pasi ka pasaktësi dhe mospërditësim të tyre, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, neni 69 ñ*Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor*ò.
Regjistrat e familjeve fermere, duhet të ishin përditësuar sipas të dhënave që duhet të disponojë ZAMT në Bashki, nga ZAMT në Qark apo nga AKSH Tepelenë për numrin e familjeve që kanë përfituar tokë në bazë të ligjit për ndarjen e tokës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, nenet 23 dhe 24.
Sipërfaqja e tokës dhe numri i familjeve të trajtuara me tokë nga ligji 7501, etj., sipas njësive administrative, në hektarë, janë paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.22.** (NjA Kurvelesh dhe NjA Lopës).
Realizimi i vjeljes së taksës së tokës për Bashkinë Tepelenë dhe numri i familjeve debitore për vitet 2011-2019, 2020 është paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.23.** (NjA Kurvelesh dhe NjA Lopës).
Gjendja e debisë për taksën e tokës bujqësore në Bashkinë Tepelenë është paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.24.** (NjA Kurvelesh dhe NjA Lopës).
Për qytetin dhe çdo njësi administrative janë krijuar në mënyrë elektronike regjistrat për taksat dhe tarifat vendore për subjektet private dhe familjarët, si më poshtë:
1. Regjistri Elektronik për Bizneset në formatin Excel.
2. Regjistri Elektronik për taksën e Tokës në formatin Excel.
3. Regjistri Elektronik për Popullatën në formatin Excel.

Gjithashtu, regjistrat janë hartuar dhe funksionojnë edhe në formë manuale, konform me formatit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.
Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Tepelenë janë përmbledhur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.4.**

Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.
Të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; ASHK-ja, në lidhje me taksën e ndikimit tnë infrastrukturë; DRSHTRR Gjirokastër, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Tepelenë dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Tepelenë.
Në lidhje me tarifat që duhet të mbledhë agjenti tatimor Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë Sh.A., konstatohet se akt-rakordimet nuk janë mbajtur në rregull çdo muaj, por mbahen një herë në vit. Për vlerat e paarkëtuara nga subjektet dhe popullata debitore nuk janë zbatuar përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, neni 117 ñ*Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave*ò, pika b).Në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, u konstatua se Bashkia Tepelenë nuk ka krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku të përcaktohet numri i familjeve dhe sasia e sipërfaqes së banimit që ka secila familje, kujt viteve i përket banesa para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuara nga pagesa e këtyre taksave, nuk plotësohet njoftim detyrimi për familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit. Faturimi dhe realizimi i taksës së ndërtesës dhe tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit për familjarët për periudhën 2019-2020 sipas akt-rakordimeve mes Bashkisë Tepelenë dhe Agjentit Tatimor UKsha Tepelenë paraqitet në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.3.**
Referuar akt-rakordimeve të bashkisë Tepelenë me UK sha Tepelenë, rezulton se për periudhen objekt auditimi për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit,**vlera debitore është 3,979,274 lekë**, e ndarë në 1,138,711 taksë ndërtese dhe 2,840,563 lekë tarifë pastrimi, ku debia për taksën e ndërtesës është 540,711 lekë për vitin 2019 dhe 598,000 lekë për vitin 2020, ndërsa debia për tarifën e pastrimit është 1,388,563 lekë për vitin 2019 dhe 1,452,000 lekë për vitin 2020.
Nga auditimi i pagesave për taksat dhe tarifat vendore nga familjarët, u konstatua se këto detyrime llogariten vetëm për Njësinë Adminstrative Tepelenë, pasi për NjA Qendër, Kurvelesh dhe Lopës, për periudhën objekt auditimi 2019-2020 nuk është planifikuar dhe realizuar e ardhura nga **taksa e ndërtesës** dhe **tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit** për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sha Tepelenë, pasi kanë munguar të dhënat nga Administratorët e Njësive Administrative se bashku me Kryetarët e Fshatrave, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë detyrimet vendore.
Detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifat vendore janë paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.25.**
Kriteri:Këto procedura të ndjekura janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, me ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, me ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; me ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, etj.
Ndikimi/Efekti: Kanë ndikuar në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në **vlerën debitore prej 6,531,156 lekë,** nga mospagesa e taksës së tokës bujqësore, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Kanë ndikuar në nivelin e të

ardhurave për taksa e tarifa vendore në **vlerën debitore prej 3,979,274 lekë**, nga mospagesa e taksave dhe tarifave vendore, si ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Tepelenë.

Shkaku: Kanë munguar të dhënat nga Administratorët e Njësive Administrative se bashku me Kryetarët e Fshatrave, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që janë trajtuar me tokë dhe familjet që nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë taksat. Nga UK sha nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës debitore si dhe nga bashkia Tepelenë nuk është marrë masë për gjobitjen prej 50% të vlerës së paarkëtuar të agjentit tatimor UK sha.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim 1: Bashkia Tepelenë, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për të hartuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marrë nga institucionet përgjegjëse (AKSH Tepelenë dhe Qarku Gjirokastër). Për familjet fermere debitore të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën e papaguar për vlerën **10,468,765 lekë** dhe për mospagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.

Rekomandim 2: Bashkia Tepelenë, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerave debitore. Gjithashtu Bashkia Tepelenë të bashkëpunojë me UK sha për arkëtimin e vlerës debitore prej **3,979,274 lekë** dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative këtij agjenti tatimor.

Rekomandim 3: Bashkia Tepelenë, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Tepelenë, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRRT-në, ASHK-në, etj,) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

Z. G. G., Specialist në Sektorin e zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa);
Z. R. H., Specialist në Sektorin e zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa);

Titulli i gjetjes: Mbi procedurat e kryera për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në bazë të lejeve të ndërtimit dhe për subjektet të cilët kanë zbatuar kontratat e investimeve me fonde publike në territorin e Bashkisë Tepelenë.

Situata: Nga Sektori i zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa) Bashkia Tepelenë, nuk është vepruar për të ngarkuar me detyrime, faturuar apo për të nxjerrë njoftim detyrimit për taksat dhe tarifat vendore për subjektet e pajisur me leje ndërtimi dhe për OE të cilët zbatojnë kontratat e investimeve në Bashkinë Tepelenë, si më poshtë:

Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Sektori i zhvillimit ekonomik, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit, të pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Tepelenë 6 subjekte, nga të cilët 3 prej tyre nuk kanë paguar detyrimet vendore në vlerën totale **75,360 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Tepelenë.

Subjektet të cilat kanë marrë leje ndërtimi dhe pagesat përkatëse apo vlerat debitore për taksat dhe tarifat vendore janë paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.26.**
Gjithashtu, në bashkinë Tepelenë, kanë kryer veprimtari biznesi për llogari të investitorëve të ndryshëm nga Bashkia Tepelenë (kryesisht FShZh) 8 operatorë ekonomikë, si kontraktues të drejtpërdrejtë, nënkontraktorë ose bashkim operatorësh ekonomikë. Krahas sa më sipër, në bashkinë Tepelënë, kanë kryer veprimtari biznesi për llogari të investimeve të Bashkisë 4 operatorë ekonomikë. Nga auditimi, u konstatua se pjesa më e madhe e OE nuk kanë hapur adresa sekondare për zhvillimin e biznesit, në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore*ò neni 40, ñ*Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare*ò, pika 1, nenin 43 ñ*Përditësimi i të dhënave të regjistrimit*ò pika 1/1 dhe ligjin nr. 9723 dt.03.05.2007 ñ*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*ò, i ndryshuar, neni 22, ñ*Detyrimi për regjistrim*ò, pika 4.
Nga detyrimet vendore të papaguara prej OE të cilët zbatojnë investimet e ndryshme në territorin e Bashkisë Tepelenë rezulton një vlerë debitore prej **1,981,440 lekë,** e cila përbën të ardhura të munguara (borxh tatimor) për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit pa e regjistruar adresën sekondare dhe mospagimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë.
Operatorët ekonomikë të cilët kryejnë veprimtari biznesi në bashkinë Tepelenë për llogari të investitorëve të ndryshëm nga Bashkia Tepelenë dhe pagesat e kryera prej tyre është paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.28.**
Operatorët ekonomikë të cilët kryejnë veprimtari biznesi në bashkinë Tepelenë, të cilët nuk kanë hapur NUISe sekondare dhe shuma e debisë së tyre (për llogari të investitorëve të ndryshëm nga Bashkia Tepelenë) është paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.29.**
Operatorët ekonomikë të cilët kryejnë veprimtari biznesi në bashkinë Tepelenë, të cilët nuk kanë hapur NUISe sekondare dhe shuma e debisë së tyre (për investime të Bashkisë Tepelenë) është paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.30.**
Kriteri:Këto procedura të ndjekura janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore*ò neni 40, ñ*Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare*ò, pika 1, neni 43 ñ*Përditësimi i të dhënave të regjistrimit*ò pika 1/1 dhe ligji nr. 9723 dt.03.05.2007 ñ*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*ò, i ndryshuar, neni 22, ñ*Detyrimi për regjistrim*ò, pika 4; ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar; me ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, VKB, etj.
Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në vlerën totale **2,056,800 lekë** nga mos faturimi dhe arkëtimi i taksave dhe tatimeve vendore.
Shkaku: Mos marrja e masave të plota për ndjekjen e arkëtimin e të ardhurave nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkia Tepelenë të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit që kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokuruara për vitet 2019-2020, pavarësisht nëse kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Tepelenë dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, si dhe të nxjerrin njoftim detyrimet për taksat dhe tarifat vendore. Sipas listimit në **Anekse, Pasqyrat 2.2.6.26., 2.2.6.28. dhe 2.2.6.29.,** të ndjekin të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës totale **2,056,800 lekë** nga këto detyrime vendore**.**
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. G. G. me detyrë Specialist në sektorin e zhvillimit ekonomik;
2. Z. R. H. me detyrë Specialist në sektorin e zhvillimit ekonomik;

Titulli i gjetjes: Mbi procedurat e kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit

të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Bashkia Tepelenë.

Situata: Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Tepelenë ushtrojnë aktivitetin 5 subjekte të cilat tregtojnë hidrokarbure, karburante. Subjekte të licencuar për tregtimin e lëndëve djegëse nuk ka. Subjektet A.Sh.P.K. dhe S.Sh.P.K. nuk e ushtrojnë më aktivitetin, pasi janë prishur për shkak të ndërtimeve të infrastrukturës. Subjektet K. Sha, B.Sh.P.K. dhe A.Sh.P.K. vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet të papajisur me autorizimet përkatëse, ndërsa subjektet O. Sh.P.K., dhe K.Sh.P.K. vazhdojnë aktivitetin ndërsa pagesat e autorizimit janë bërë të pjesshme dhe do të vazhdojnë të shlyhen me këste për një periudhë 5 vjeçare.

Pagesat e pakryera deri në momentin e auditimit dhe vlerat debitore, të cilat pavarësisht se në disa raste është rënë dakord që të paguhen me këste, gjithsesi përbëjnë detyrime të paarkëtuara dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Tepelenë janë paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.30.**

Vlera prej **4,400,000 lekë** përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Sa më sipër, është në kundërshtim me VKM-në nr. 344, datë 19.04.2017.

Kriteri: Kjo procedurë është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa ñbò, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në **vlerën 4,400,000 lekë** nga mospagesa e tarifës së plotë apo të një pjese të tarifës së licencës/autorizimit nga subjektet që ushtrojnë aktivitetin e shitjes me pakicë të hidrokarbureve pa rinovuar licencën e tregtimit.

Shkaku: Mos ndjekja e procedurave në bashkëpunim me institucionet përkatëse për mbylljen e aktivitetit të subjekteve që nuk rinovojnë licencën.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për paisje me autorizime, për shumën debitore prej **4,400,000 lekë,**sipas Anekseve,**Pasqyra 2.2.6.30**. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtiminn e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. G. G. me detyrë Specialist në sektorin e zhvillimit ekonomik;
2. Z. R. H. me detyrë Specialist në sektorin e zhvillimit ekonomik;

2.3. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", si dhe udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*"

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

Titulli i gjetjes:Në pasqyrat financiare për vitin 2019, disa llogari të aktiveve, nuk pasqyrojnë saktë vlerën e tyre historike në Formatin 1 ñ*Pasqyra e pozicionit financiar*ò si dhe në llogaritë e investimeve, nuk janë pasqyruar investimet në proces.

Situata:*Për vitin 2019*, në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8 datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Tepelenë me shkresën nr. 407 prot., datë 26.02.2020, të përbëra si vijon:

Formati nr. 1 ï *Pasqyra e pozicionit financiar*.
Formati nr. 2 ï *Pasqyra e performancës financiare* (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
Formati nr. 3 ï *Pasqyra e flukseve monetare* (Cash-Floŭ).
Formati nr. 4 ï *Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto*.
Formati nr. 5 ï *Pyetësor dhe shënimet shpjeguese*.
Formati nr. 6 ï *Investimet dhe burimet e financimit*.
Formati nr. 7/a ï *Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata* (kosto historike).
Formati nr. 7/b ï *Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata* (vlera neto).
Formati nr. 8 ï *Numri i punonjësve dhe fondi i pagave*.

(Bashkëlidhur Pasqyra nr. 3.1. e Pozicionit Financiar, bilanci i vitit 2019).

Baza ligjore që vitin 2019.

VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ñ*Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre*ò i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001, UMF nr. 8 datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò etj. legjislacion rregullues.

Mbajtja e kontabilitetit 2019.

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinës, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave, 2019

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; llogaria 520 ñ*Disponilitete në Thesar*ò, në pasqyrat financiare është për vlerën për vlerën debitore ***3,602,491 lekë.***

Analiza e kësaj llogarie, sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, është e analizuar si vijon:

- 16,956,840 lekë të trashëguara nga viti 2018, nga të cilat 12,694,284 lekë janë ngurtësime për garanci të punimeve me sipërmarrje,
- 319,440,462 lekë hyrje gjatë vitit ushtrimor nga të cilat 196,825,119 lekë janë grande specifike,
- 332,794,811 lekë janë shpenzimet buxhetore nga të cilat shpenzime për investime 145,279,064 lekë.

(Më hollësisht analiza e llogarisë 520 sipas pasqyrës nr. 3.2. bashkëlidhur.)

Llogaria 466 ñ*Kreditorë për mjetet në ruajtje*ò në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël ***2,695,736 lekë.*** Sipas analizës të rakorduar me degën e thesarit, kjo llogari është për ***vlerën 2,695,736 lekë*** dhe është e analizuar për 8 objekte. Nga këto për 7 raste u përkasin ngurtësimeve për objekte të investuara gjatë vitit 2019 dhe vetëm për një objekt, ngurtësimi është i vitit 2018 për vlerën e ngurtësuar 685,517 lekë me objekte: ñ*Rikonstruksion kanal vaditës Kodër-Lekël*ò.

(Më hollësisht analiza e llogarisë 466 sipas objekteve, është si në Pasqyrën nr. 3.3. bashkëlidhur.)

Të ardhurat, nga tatim taksat dhe tarifat lokale për vitin 2019, është sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, janë në shumën 35,707,696 lekë.
Kjo shumë, është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2019, në Formatin nr. 2 ñ*Pasqyra e performancës financiare*ò, për shumën 30,949,444 lekë nga të cilat:
- 15,921,111 lekë tatim mbi të ardhurat dhe
- 15,028,332 lekë të ardhura jo tatimore.

Në këtë rast, në Formatin nr. 2, janë pasqyruar më pak se sa akti i rakordimit të ardhurat për diferencën (35,707,696 - 30,949,444) = 4,758,252 lekë që përfaqëson pjesën e të ardhurave që i kalojnë subjekteve të tjera sipas legjislacionit tatimor.
Analiza e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive, llogaritë; 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, Viti 2019.
U konstatua se për vitin 2019, Aktivet Afatgjata materiale, llogaritë 212, 213, 214, 215 dhe 218, janë pasqyruar në Pasqyrën e pozicionit financiar Formati nr. 1 për vlerën historike të tyre dhe jo me vlerën e mbetur neto. Pra janë sipas të dhënave gjendje në ñ*Pasqyrën aneks*ò Formati nr. 7/a ñ*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata*ò (kosto historike) dhe jo sipas të dhënave gjendje si në ñ*Pasqyrën aneks*ò Formati nr. 7/b ñ*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata*ò (vlera neto).
Praktikë **në kundërshtim** me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, Kap. III, pika 60 ku citohet:

ñ*Pasqyra individuale e pozicionit financiar (bilanci kontabël) pasqyron në mënyrë të klasifikuar e strukturuar* ***aktivet, detyrimet dhe fondet neto*** *të njësisë së qeverisjes së përgjithshme në datën e përcaktuar për mbylljen e vitit ushtrimor raportues. Si rregull, periudha ushtrimore është nga data 1 janar deri më 31 dhjetor të vitit raportues.",*

Si dhe Kap. IV, pika 100 ku citohet:

"Në nivelet përkatëse të përgatitjes, pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të japin një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për këto elemente: - Aktivet, detyrimet, aktivet neto/fondet neto;...."

U audituan gjendja analitike kontabël e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese për koston historike për llogaritë si vijon:
Llogaria 210 ñ*Toka, troje, terrene*ò për vlerën kontabël historike 46,586,929 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për diferencën (45,568,929 - 7,778,488) = 38,790,441 lekë.
Gjendja e kësaj llogarie është e analizuar në mënyrë kontabël në 5 objekte inventariale si dhe për investime rehabilituese të kryera në këto objekte.
(Më hollësisht analiza e llogarisë 210 sipas objekteve, është si në Pasqyrën nr. 3.4. bashkëlidhur.)
Shtesat përfaqësojnë toka, troje dhe terrene në shumën 38,790,4441 lekë efekt i cili ka ardhur nga regjistrimi i pasurive të bashkisë pranë ASHK-së dhe të vlerësuara me çmimet përkatëse.
Në këtë rast, është kryer veprimi Debitohet Llogaria 210 ñ*Toka, troje, terrene*ò në shumën 38,790,441 lekë dhe kreditohet llog. 1011 ñ*Shtesë fonde bazë nga vlerësimi*ò po në këtë shumë.
Llogaria 211 ñ*Pyje kullota plantacione*ò për vlerën kontabël historike ***54,386,677 lekë***, shtuar gjatë vitit ushtrimor për diferencën (54,386,677 - 196,200) = 54,190,477 lekë.
Kjo llogari është e analizuar në kontabilitete për pyje, kullota dhe pemë dekorative.
(Më hollësisht analiza e llogarisë 211 sipas objekteve, është si në Pasqyrën nr. 3.5. bashkëlidhur.)
Shtesat në vitin ushtrimor 2019 për 54,190,477 lekë, përfaqësojnë pyje, kullota, plantacione për të cilat janë kryer veprimet për regjistrimin e pasurive të Bashkisë pranë ASHK-së sipas çmimeve të miratuara.

Është kryer debituar llogaria 211 ñ*Pyje kullota, plantacione*ò në shumën 54,190,477 lekë dhe kreditohet llogaria 1011 ñ*Shtesë fonde bazë*ò nga vlerësimi po me këtë shumë.
Llogaria 212 ñ*Ndërtime e konstruksione*ò për vitin 2019 është në vlerën historike për ***408,669,979 lekë***, shtuar gjatë vitit për diferencën (409,669,979 - 395,692,562) = 13,977,417 lekë. Kjo llogari, nuk është verifikuar me inventarizim fizik për gjendjen e saj në fund të vitit ushtrimor. Është e analizuar në kontabilitet për 81 objekte ndërtimore.
(Më hollësisht analiza e llogarisë 212 sipas objekteve, është si në Pasqyrën nr. 3.6. bashkëlidhur.)
Shtesat gjatë viti 2019 për shumën 12,977,417 lekë, përfaqësojnë shtesë investimi për objektin: ñ*Hartim projekti për banesa të pa favorizuara*ò në shumën 900,000 lekë; Banesa për familjet e pa favorizuara në shumën 8,516,042 lekë dhe ñ*Përshtatja e ambientit të Maternitetit për Banesa Sociale*ò në shumën 3,561,375 lekë.
Llogaria 213 ñ*Rrugë rrjete vepra ujore*ò për vlerën historike 991,320,044 lekë. Shtuar gjatë viti për (991,320,044 - 960,154,390) = 31,165,654 lekë.
Është e analizuar për 84 objekte të investuara.
(Më hollësisht analiza e llogarisë 213 sipas objekteve, është si në Pasqyrën nr. 3.7. bashkëlidhur.)
Shtesat gjatë vitit 2019 për shumën 31,165,654 lekë, përfaqësojnë shtesë investimi për objektet: ñ*Mbikëqyrje punimesh rikonstruksion bllok banimi*ò në shumën 90,000 lekë; ñ*Kolaudim punimesh rikonstruksion bllok banimi*ò në shumën 13,000 lekë; ñ*Kolaudim punimesh rruga Dragot-Pasarelë*ò në shumën 49,000 lekë; ñ*Mbikëqyrje punimesh sistemim rruga Batalioni Baba Abaz*ò në shumën 624,000 lekë; ñ*Kolaudim punimesh rruga Ago Celi*ò në shumën 215,000 lekë; Rikonstruksioni hyrjes rruga ñ*Batalioni Baba Abaz*ò në shumën 45,000 lekë; ñ*Rivitalizimi i qendrave të fshatrave*ò në shumën 1,511,825 lekë; ñ*Mbikëqyrje punimesh rruga Ago Celi dhe palestra*ò në shumën 1,000,000 lekë; ñ*Mbikëqyrje punimesh Kanali Vaditës Gusmar*ò në shumën 360,000 lekë; ñ*Kolaudim punimesh Kanali vaditës Luzat*ò në shumën 45,000 lekë; ñ*Ndërtim lera dhe përmirësim i kullote*ò në shumën 500,000 lekë; ñ*Rikonstruksion kanali vaditës Gusmar*ò në shumën 3,500,000 lekë; ñ*Hartim projekti Kanali vaditës Dukaj*ò në shumën 742,610 lekë; ñ*Rikonstruksion kanali vaditës Dukaj*ò në shumën 11,953,379 lekë. Gjithashtu shuma 10,516,840 lekë përfaqëson shtesë në llogarinë 213 ñ*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*ò nga sistemimi i llogarisë 102 ñ*Studime e kërkime*ò, sipas rekomandimeve të KLSH-së që shpenzime për studime dhe projektime të kontabilizohen në debi të llogarive të aktiveve afatgjatë që u shërbejnë.
Llogaria 214 ñ*Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune*ò për vlerën kontabël historike 11,738,947 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (11,738,947 - 11,320,947) = 418,000 lekë. Kjo llogari është e analizuar për 20 objekte.
(Më hollësisht analiza e llogarisë 214 sipas objekteve, është si në Pasqyrën nr. 3.8. bashkëlidhur.)
Shtesat gjatë viti 2019 për diferencën 418,000 lekë, përfaqësojnë blerje ñ*pajisje e makineri për shërbimet publike*ò.
- Llogaria 215 ñ*Mjete transporti*ò për vlerën historike 16,768,309 lekë, e cila nuk ka ndryshim gjatë vitit ushtrimor. Kjo llogari është e analizuar për 9 mjete transporti.
(Më hollësisht analiza e llogarisë 215 sipas objekteve, është si në Pasqyrën nr. 3.9. bashkëlidhur.)
- Llogaria 218 ñ*Inventar ekonomik*ò për vlerën historike 33,061,240 lekë, është sipas rezultatit të inventarizimit fizik.
Gjatë viti ushtrimor, kjo llogari është shtuar për (33,061,240 - 32,671,240) = 390,000 lekë.
- Llogaria 231 ñ*Investime në proces*ò.

Në pasqyrat e Pozicionit financiar, Formati nr. 1, nuk janë pasqyruar llogaritë e Investimeve në proces, llogaritë 230 ñ*Aktivet Afatgjata jo materiale*ò të cilat sipas situacionit të shpenzimeve të rakorduara me degën e thesarit janë në shumën 1,817,917 lekë.
Po kështu llogaria e investimeve 231 ñ*Aktivet Afatgjata materiale*ò, shpenzime të cilat janë realizuar në shumën 32,616,314 lekë në 6 objekte, totali 34,434 mijë lekë, të cilat janë pasqyruar në Formatinnr. 6 të pasqyrave financiare.
(Më hollësisht analiza e llogarive 230 dhe 231 të investuara gjatë vitit 2019, është si në Pasqyrën nr. 3.10. bashkëlidhur.)
Në këtë rast, mos pasqyrimi i llogarive të investimeve në proces në pasqyrat financiare, ***është shkelje e kërkesave*** të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, Kap. II, pikat 16, 18, 26.
- Llogaria 31 ñ*Materiale*ò për vlerën kontabël 1,073,159 lekë, pakësuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (1,227,154 - 1,073,159)= 153,995 lekë.
- Llogaria 32 ñ*Inventar i imët*ò për vlerën kontabël 15,525,127 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (15,525,127 - 15,071,527) = 453,600 lekë.
Kriteri: Praktikë ***në kundërshtim*** me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, Kap. II, pikat 16, 18, 26, Kap. III, pika 60, Kap. IV, pika 100.
Ndikimi/Efekti: Ndikim në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Tepelenë.
Shkaku: Mos zbatimi i plotë i procedurave kontabël të regjistrimit të shpenzimeve për investime dhe të gjendjeve të llogarive të aktiveve.
Rëndësia: E mesme
Rekomandim: Bashkia Tepelenë të marrë masat për organizimin e evidencës kontabël sipas kërkesave ligjore.

Titulli i gjetjes: Nga analiza e llogarive debitore dhe kreditore për vitin 2019, konstatohet:
- Gjendja e llogarive debitorë është në shumën 134,024 mijë lekë nga të cilat 10,449 mijë lekë janë detyrimet për tatim taksat, ku janë evidentuar debitorë nga viti 2008.
- Gjendja e llogarive kreditore në fund të vitit është në shumën 73,288 mijë lekë, nga të cilat për shumën 6,663 mijë lekë nuk janë pasqyruar si detyrim. Nga shuma e detyrimeve; për llogarinë 467, në 12 raste për shumën 31,337 mijë, dhe për llogaritë 401-408, në 20 raste për vlerën 13,711 mijë lekë, janë detyrime të krijuara nga viti 2016.
- Nga Bashkia Tepelenë, nuk është procedura në rrugë gjyqësore për vjeljen e të drejtave ndaj debitorëve si dhe nuk janë marrë masat e nevojshme për pagesat e detyrimeve kreditore.
Situata:*Analiza e llogarive debitore, 2019*
Në llogaritë financiare të vitit 2019, gjendja e llogarive debitore:
Llogaria 468 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò, paraqitet me vlerë kontabël 134,024,238 lekë. Kjo llogari krahasuar me vitin paraardhës është shtuar për vlerën (134,024,238 - 112,768,592) = 21,255,646 lekë.
Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në debi të saj janë kontabilizuar debitorët me analizë si vijon:
- 10,449 mijë lekë janë detyrimet për tatim taksat lokale,
- 91,602 mijë lekë detyrime të pa arkëtuara sipas rekomandimeve të KLSH-së,
- 25,117 mijë lekë detyrime në vite të vlerësuara pa mundësi arkëtimi,
- 2,290 mijë lekë gjoba të vendosura nga IMTV por të pa arkëtuara,
- 1,453 mijë lekë detyrime të pa paguara taksë e infrastrukturës për objektet ndërtim pa leje të legalizuara dhe
- 3,113 mijë lekë detyrime të pa vjelë për taksën e ndërtesës e të tjera nga agjenti tatimor

Ujësjellës Kanalizimet Tepelenë.
(Më hollësisht analiza strukturore e llogarisë 468, është si në Pasqyrën nr. 3.11. bashkëlidhur.)
Nga këto kërkesa debitore, në proces Gjyqësor, nuk ka asnjë debitor.
Detyrimet pa mundësi arkëtimi, janë përcaktuar për ato subjekte të cilët detyrimin e kanë të krijuar para vitit 2011, me argumentimin për shkak të lëvizjeve demografike, humbje jete, mbyllje biznesi dhe shkaqe të tjera objektive të cilat janë vlerësuar si pamundësi arkëtimi, megjithëse këto detyrime janë të pasqyruara si detyrim në llogarinë 468 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò në shumën 134,024,238 lekë.
Kjo llogari, është e analizuar në mënyrë analitike sipas subjekteve debitore. Është e analizuar për 1052 subjekte dhe persona fizikë debitorë. Nga të dhënat analitike, rezultojnë debitorë nga viti 2008. Ndërkohë ka debitorë për tatim taksat nga viti 2011.
Ndërkohë ***nuk janë ndjekur procedurat ligjore duke procedura në gjykatë për vjeljen e kërkesave mbi debitorët.***
(Më hollësisht analiza e debitorëve sipas subjekteve, llojit të debisë dhe periudhës të krijimit të saj për llogarinë 468, janë si në Pasqyrën nr. 3.12. bashkëlidhur.)
Nga shuma debitorë e llogarisë 468, në pasqyrat financiare janë kontabilizuar si pa mundësi arkëtimi shuma 41,489,026 lekë në debi të llogarisë 49 ñ*Shuma të parashikuara për zhvlerësim*ò. Me analizë:
- 25,117,132 lekë përsa janë debitorë të vlerësuar pa mundësi arkëtimi,
- 15,117,120 lekë debitorë subjektet ñB.ò dhe ñSh.ò Sh.P.K. sipas rekomandimeve nga auditimi i KLSH-së dhe
- 1,254,774 lekë debitorë të tjerë në vite.
- Llogaria 486 ñ*Shpenzime të periudhave të ardhshme*ò për vlerën kontabël 66,808,258 lekë.
Kjo llogari është krijuar gjatë vitit 2019 dhe përfaqëson vlerën kundër parti të disa llogarive të detyrimeve kreditore të pasivit të bilancit, e analizuar si vijon:
- 39,974,322 lekë, me kundër parti në kredi të llogarisë 467 ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò,
- 26,833,936 lekë detyrime ndaj furnitorëve me kundër parti llogaritë 401-408 ñ*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*ò.
Analiza e llogarive kreditore v. 2019
Gjendja e llogarive kreditore, referuar pasqyrave financiare, është si më poshtë vijon:
- Llogaritë *401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to*ò është për vlerën kontabël 26,833,936 lekë.
Nga analiza kontabël e kësaj llogarie, konstatohet se është e analizuar për 58 subjekte kreditore***. Konstatohet se ka detyrime kreditorë që nga viti 2016 për 20 subjekte në shumën totale 13,711,205 lekë ose 51% e totalit të detyrimeve.***
(Më hollësisht analiza e kreditorëve llog. 401-408 sipas subjekteve vitit të krijimit dhe vlerës kreditore, janë si në Pasqyrën nr. 3.13. bashkëlidhur.)
<u>Nga auditimi u konstatua se nuk janë pasqyruar si detyrim në llogaritë 401-408, faturat në 2 raste për shumën totale 6,663,349 lekë si vijon:</u>
1- Fatura tatimore nr. 38 datë 10.07.2019 për vlerën 6,479,749 lekë me T.V.Sh., subjekti ñN.ò Sh.P.K.
Kjo faturë është paguar pjesërisht me U. shpenzimi nr. 501 datë 28.10.2020, është paguar N.Sh.P.K. për vlerën 2,137,500 lekë, ndalur edhe 5% garanci punimesh për vlerën 112,500 lekë.
Kontrata lidhur midis palëve me nr. 786/6 datë 20.06.2019.
Objekti: ñ*Rikonstruksion fasade dhe ndriçim i rrugës "Elmaz Teme Bilbili" (Unaza veriore e qytetit të Tepelenës*ò. Vlera e kontratës 5,399,791 lekë me T.V.Sh.
Afati 18 ditë nga nënshkrimi i kontratës.
Çertifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim datë 9.09.2019.

Procesverbali i kolaudimit datë 09.09.2019.
2- Fatura ***nr. 49, datë 04.09.2018, subjekti N., vlera 183,600 lekë*** paguar me u. shpenzimin nr. 88, datë 10.02.2020.
Janë kryer testimet si më poshtë vijon:
- Paguar me U. shpenzimin nr. 29, datë 13.01.2020, fatura nr. 7, datë 5.09.2019 për vlerën 437,200 lekë. Është e regjistruar ne kontabilitet në llogaritë kreditore 401-408.
- Paguar me U. shpenzimin nr. 37, datë 21.01.2020, fatura nr. 46, datë 26.12.2019 për vlerën 300,000 lekë. Është e regjistruar në kontabilitet në llogaritë kreditore 401-408.
- Paguar me U. shpenzimin nr. 51, datë 22.01.2020, fatura nr. 16, datë 11.09.2019 për vlerën 1,634,741 lekë. Është e regjistruar në kontabilitet në llogaritë kreditore 401-408.
- Paguar me U. shpenzimin nr. 23, datë 13.01.2020, fatura nr. 29, datë 31.12.2019 për vlerën 109,126 lekë. Është e regjistruar në kontabilitet në llogaritë kreditore 401-408.
- Paguar me U. shpenzimin nr. 86, datë 10.02.2020, fatura nr. 476 datë 28.10.2019 për vlerën 566,650 lekë. Është e regjistruar në kontabilitet në llogaritë kreditore 401-408.
- Paguar me U. shpenzimin nr. 88, datë 10.02.2020, fatura nr. 49 datë 04.09.2018 ***për vlerën 183,600 lekë***, subjekti N.. Kjo faturë nuk është e regjistruar në kontabilitet në llogaritë kreditore 401-408.
- Paguar me U. shpenzimin nr. 89, datë 10.02.2020, fatura nr. 98 datë 15.10.2019 për vlerën 276,000 lekë. Është e regjistruar në kontabilitet në llogaritë kreditore 401-408.
- Paguar me U. shpenzimin nr. 92, datë 1.02.2020, fatura nr. 52301 datë 03.12.2019 për vlerën 239,070 lekë. Është e regjistruar në kontabilitet në llogaritë kreditore 401-408.
- Paguar me U. shpenzimin nr. 108, datë 10.02.2020, fatura nr. 48 datë 13.08.2019 për vlerën 376,488 lekë. Është e regjistruar në kontabilitet në llogaritë kreditore 401-408.
- **Llogaria 467** ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò për vlerën kontabël sipas pasqyrave financiare për 39,974,322 lekë. Nga të dhënat analitike që na u paraqitën, kjo llogari është e analizuar për 19 subjekte. Nga kjo shumë konstatohet se:
- 27,831 mijë lekë përfaqësojnë detyrime ndaj CEZ + OSHE për energjinë elektrike, detyrime në vite ose 70% e totalit,
- 3,036 mijë lekë janë detyrime për tarifat e ujit të pijshëm ose 8% e totalit,
- 4,019 mijë lekë janë detyrime ndaj 5 subjekteve sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë ose 10 % dhe diferenca për
-5,088 mijë lekë ose 12 % janë detyrime të tjera.
Detyrime të krijuara para vitit ushtrimor 2019, janë 12 raste për vlerën 31,337 mijë lekë, diferenca për 7 raste në shumën 8,637 mijë lekë janë detyrime të krijuara gjatë vitit 2019.
(Më hollësisht analiza e llogarisë kreditore 467, sipas subjekteve vitit të krijimit dhe vlerës kreditore, janë si në Pasqyrën nr. 3.14. bashkëlidhur.)
Llogaria 42 ñ*Detyrime ndaj personelit*ò për vlerën 7,708,450 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë detyrime për periudhën e muajit dhjetor 2019.
Llogaria 431 ñ*Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat*ò për vlerën 4,088,147 lekë përfaqëson detyrimet e pa paguara për tatimin mbi të ardhurat personale.
Kjo shumë përfaqëson detyrime të prapambetura për Tatim mbi të ardhurat personale për periudhën vitin 2011 deri në muajin dhjetor 2019.
Llogaria ñ435 ñ*Sigurime Shoqërore*ò për vlerën 10,789,388 lekë përfaqëson detyrimet e pa paguara për sigurimet shoqërore.
Kjo shumë përfaqëson detyrime të prapambetura për Sigurime Shoqërore për periudhën viti 2011 deri në muajin dhjetor 2019.
Llogaria ñ436 ñ*Sigurimet shëndetësore*ò për vlerën e detyrimeve 619,630 lekë.
Kjo shumë përfaqëson detyrime të prapambetura për Sigurime Shëndetësore për periudhën viti 2011 deri në muajin dhjetor 2019.
Kriteri:Kërkesat e ligjit nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, Kreu III, nenet 34/6 dhe

40/3, ligji nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, neni 40, pika 3, gërma ñdhò.
Ndikimi/Efekti:Në përkeqësimin e treguesve financiarë të Bashkisë.
Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkia Tepelenë, të programojë buxhete vjetorë me të ardhura dhe shpenzime të balancuara. Në programimin e buxheteve, të parashikohen si zë më vete i shpenzimeve, pagesat për detyrimet kreditore të trashëguara nga viti paraardhës, në zbatim të kërkesave të UMF nr. 1, datë 17.01.2019 ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019*ò.
Të procedohet në rrugë ligjore me padi në gjykatë, për vjeljen e kërkesave mbi debitorët.

Titulli i gjetjes: - Nga analiza e llogarisë 466 ñ*Kreditorë për mjetet në ruajtje*ò për vitin 2020, konstatohet se për 3 objekte në shumën 1,310,514 lekë, janë ngurtësuar fonde 5% e vlerës së financimit si garanci të objekteve të investuara që nga viti 2018 të cilave u ka kaluar afati i garancisë.
- Nuk janë evidentuar në pasqyrat financiatre të viti 2020, ñ*Investime në proces*ò përkatësisht llogaria 231 për 2 rastet në shumën 30,200,529 lekë për të cilat objekti nuk është marë në dorëzim.
Situata: Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2020.
Për vitin 2020, Në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8 datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Tepelenë me shkresën nr. 380 prot., datë 24.02.2021, të përbëra si vijon:
Formati nr. 1 ï Pasqyra e pozicionit financiar.
Formati nr. 2 ï Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
Formati nr. 3 ï Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).
Formati nr. 4 ï Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
Formati nr. 5 ï Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
Formati nr. 6 ï Investimet dhe burimet e financimit.
Formati nr. 7/a ï Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
Formati nr. 7/b ï Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
Formati nr. 8 ï Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.
(Bashkëlidhur Pasqyra nr. 3.15. e Pozicionit Financiar bilanci i v. 2020)
- Baza ligjore për vitin 2020.
VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ñ*Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre*ò i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001, UMF nr. 8 datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò etj. legjislacion rregullues.
Mbajtja e kontabilitetit viti 2020.
Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.
Për vitin 2020.
Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave. V, 2020
Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; ***llogaria 520*** ñ*Disponilitete në Thesar"*, në pasqyrat financiare është për vlerën për vlerën debitore ***5,647,735lekë***.
Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Tepelenë, kjo llogari ***është për vlerën 5,647,735lekë***.
Analiza e kësaj llogarie, sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, është si vijon:
- 3,602,491 lekë të trashëguara nga viti 2019, nga të cilat 2,695,736 lekë janë ngurtësime për

garanci të punimeve me sipërmarje,
- 328,380,654 lekë hyrje gjatë vitit ushtrimor nga të cilat 201,892,464 lekë janë grande specifike,
- 326,335,410 lekë janë shpenzimet buxhetore nga të cilat shpenzime për investime 15,420,908 lekë.
(Më hollësisht analiza e llogarisë 520 sipas pasqyrës nr. 3.16. bashkëlidhur.)
- Po kështu ***llogaria 466*** ñ*Kreditorë për mjetet në ruajtje*ò në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël ***3,294,275lekë.*** Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduara me degën e thesari, kjo llogari është për ***vlerën 3,294,275 lekë*** dhe është e analizuar sipas objekteve për 11 raste.
(Më hollësisht analiza e llogarisë 466 sipas pasqyrës nr. 3.17. bashkëlidhur.)
Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet ***për tre objekte në vlerën 1,310,514 lekë,*** përfaqësojnë ngurtësim fondesh për garanci të punimeve ***nga viti 2018 për të cilat ka kaluar afati i garncië*** dhe për të cilat Bashkia Tepelenë ***duhet të procedojë*** sipas ligjit për ti rimarë ato për ti përdorur për interesin publik. Përkatësisht për objektet:
- *Gjimnazi Abaz Shehu, Rikostruksion kanal vaditës Kodër- Lekël* dhe *Kanali vaditës Gusmar.*
Nga auditimi mbi procedurat e zbatuara për ngurtësimin e fondeve si garanci për cilësinë e punimeve të kryera nga subjektet sipërmarëse, ***u konstatua se janë zbatuar kërkesat ligjore.***
Konkretisht, llog. 466 për vitin 2020, është shtuar për vlerën 698,539 lekë për investime të kryera në 3 objekte:
1- Nga ditari i bankës, konstatohet se janë kontabilizuar në kredi të llogarisë 466 vlera totale 468,539 lekë për 3 transaksione të cilat u audituan:
- Me urdhër shpenzimin nr. 51, datë 22.01.2020, paguar B.Sh.P.K. për vlerën 1,720,780 lekë ñndërtim leraò plus ***ndalur edhe 5%*** garanci punimesh për 86,039 lekë.
Referuar fatura tatimore nr. 16, datë 11.09.2019 për vlerën totale me T.V.Sh. 1,720,780 lekë (Situacioni nr. 2) .
Kontrata nr. 896/5, datë 10.07.2019 lidhur midis palëve.
Objekti: Ndërtim lera dhe përmirësim kullote.
Vlera e kontratës është për 1,850,383 lekë dhe kolaudimi dhe marja në dorëzim të objektit gjithësej për 2,220,460 lekë me T.V.Sh. për realizimin e punimeve.
Afati 45 ditë nga nga lidhja e kontartës, datë 23.08.2019.
Procesverbali i kolaudimit datë 9.09.2019. Marja në dorëzim datë 9.09.2019. Fatura tatimore nr. 16, datë 11.09.2019 për vlerën totale me T.V.Sh. 1,720,780 lekë, është pasqyruar si detyrim në llogarinë 401 për vitin 2019.
2- Me urdhër shpenzimi nr. 501 datë 28.10.2020, është paguar N.Sh.P.K. për vlerën 2,137,500 lekë plus ***ndalur edhe 5%*** garanci punimesh për vlerën 112,500 lekë.
Kontrata lidhur midis palëve me nr. 786/6 datë 20.06.2019.
Objeki: ñ*Rikonstruksion fasade dhe ndriçim i rrugës "Elmaz Teme Bilbili" (Unaza veriore e qytetit të Tepelenës".*
Vlera 5,399,791 lekë me T.V.Sh.
Afati 18 ditë nga nënëshkrimi i kontratës.
Bashkëngjitiur, Fatura tatimore nr. 38 datë 10.07.2019 për vlerën 6,479,749 lekë me T.V.Sh.
Çertifikatë e përkohshme e marjes në dorëzim datë 9.09.2019.
Procesverbali i kolaudimit datë 09.09.2019.
3- Me u. shpenzimi nr. 537 datë 24.11.2020 është paguar Sh.Sh.P.K. për vlerën 9,500,000 lekë plus ***ndalur edhe 5%*** garanci punimesh për 500,000 lekë.
Kontrata lidhur midis palëve me nr. 1185/5 datë 06.11.2020.
Objeki: ñ*Reabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (Pastrim i rezervuarit) Bashkia Tepelenë*ò.
Vlera 20,899,027 lekë me T.V.Sh.

Afati 90 ditë nga nënëshkrimi i kontratës.
Fatura tatimore nr. 4 datë 24.11.2020 për vlerën 11,000,000 lekë me T.V.Sh.
Mungon bashkëlidhur Çertifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të objektit dhe procesverbali i kolaudimit të objektit.
- Mbi mospasqyrimi i llogarive 230 dhe 231 ñ*Investime në proces*ò, ku nga auditimi u konstatuan në 2 raste për vlerën 30,200,529 lekë si më poshtë:
1- Nga auditimi i dokumentacionit për vitin 2020 për 3 raste të ngurtësimit të fondeve në masën 5% të vlerës së situacionit sipas të dhënave të tabelës për llogarinë 466 ñ*Kreditorë për mjetet në ruajtje*ò, vlera e faturave është në total për ***19,200,529 lekë. Kjo vlerë nuk është pasqyruar në llogaritë e investimeve në proces, llog 231*** për vlerën 19,200,529 lekë, e ndarë sipas objekteve:
Ndërtim Lera për 1,720,780 lekë, Rikonstruks. Fasad Unaza veriore për 6,479,749 lekë dhe Pastrim kanal ujitës Dukaj për 11,000,000 lekë.
2- Me u. shpenzimi nr. 537 datë 24.11.2020 është paguar OE Sh.Sh.P.K. për vlerën 9,500,000 lekë. Kontrata lidhur midis palëve me nr. 1185/5 datë 06.11.2020.
Objeki: ñ*Reabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (Pastrim i rezervuarit) Bashkia Tepelenë*ò. Vlera 20,899,027 lekë me T.V.Sh. Fatura tatimore nr. 4 datë 24.11.2020 për vlerën 11,000,000 lekë me T.V.Sh. Mungon bashkëlidhur Çertifika e përkohshme e marjes në dorëzim të objektit dhe procesverbali i kolaudimit të objektit.
Nuk pasqyrohet në llogarinë 231 investime në proces për vlerën e faturës 11,000,000 lekë.
Të ardhurat, nga tatim taksat dhe tarifat lokale për vitin 2020, sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, janë në shumën 37,591,480 lekë.
Kjo shumë, është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2020, në Formatin nr. 2 ñ*Pasqyra e performancës financiare*ò, në shumën 31,125,434 lekë nga të cilat:
- 15,632,902 lekë tatim mbi të ardhurat dhe
- 15,492,532 lekë të ardhura jo tatimore.
- Rakordimi i llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe llogarive të Aktiveve Qarkulluese me rezultatet e inventarizimit fizik v. 2020:
Kjo pikë e programit, është trajtuar me akt konstatimi më vete.
Kriteri:UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithsshme*ò.
Ndikimi/Efekti:- Për rastin e ngurtësimit të fondeve, llogaria 466, ka efekt në mos përdorimin e fondeve të ngurtësuara për interes publik.
- Për rastin e llogarisë së investimeve, 231 në besueshmërinë e pasqyrave financiare lidhur me investimet në proces dhe ndjekja e financimit të tyre.
Shkaku: Ndjekja e procedurave ligjore për ngurtësimin e fondeve si garanci punimesh dhe cbllokimin e tyre.
Mos organizimi i evidencës kontabël sipas kërkesave ligjore.
Rëndësia: E mesme
Rekomandim: Bashkia Tepelenë, të analizojë rastet e ngurtësimit të fondeve të cilave u ka kaluar afati i garancisë dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore, meqëllim përdorimin e tyre për interes publik.

Titulli i gjetjes: - Nga analiza e llogarive debitore dhe kreditore për vitin 2020, konstatohet:
- Gjendja e llogarive debitorë është në shumën 135,712 mijë lekë nga të cilat 10,449 mijë lekë janë detyrimet për tatim taksat, ku janë evidentuar debitorë nga viti 2008.
- Gjendja e llogarive kreditore në fund të vitit është në shumën 58,057 mijë lekë.
Nga këto detyrime, llog. 401-408, në 17 raste për vlerën 14,364 mijë lekë, janë detyrime të krijuara në vitet 2016-2019.
- Nga Bashkia Tepelenë, nuk është procedura në rrugë gjyqësore për vjeljen e të drejtave ndaj

debitorëve si dhe nuk janë marrë masat e nevojshme për pagesat e detyrimeve kreditore.
Situata:- Analiza e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive, llogaritë; 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, Viti 2020.
U audituan gjendja analitike kontabël e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese për koston historike për llogaritë si vijon:
- Llogaria 202 ñ*Studime dhe kërkime*ò, kjo llogari nuk pasqyron gjendje debitorë për vitin 2020.
- Llogaria 210 ñ*Toka, troje, terene*ò për vlerën kontabële historike ***145,030,295lekë***, shtuar gjatë vitit ushtrimor për diferencën (145,030,295 - 46,568,929) = 98,461,366 lekë. Kjo llogari është e analizuar për 10 objekte.
(Më hollësisht analiza e llogarisë 210 sipas pasqyrës nr. 3.18. bashkëlidhur.)
Shtesat në vitin ushtrimor 2020 për 98,461,366 lekë, përfaqësojnë toka, troje terrene të cilat janë regjistruar në pronësi të Bashkisë pranë ASHK bazuar në tarifat përkatëse vlerësuese.
Është kryer veprimi kontabël debitohet llogaria 211 ñ*Toka, troje, terrene*ò në shumën 31,666,076 lekë dhe kreditohet llogaria 1011 ñ*Shtesë fonde bazë nga vlerësimi*ò po me këtë shumë, si dhe shtesa nga sistemim i llogarisë në shumën 66,795,290 duke pakësuar llogarinë 212 ñ*Ndërtime konstruksione*ò në shumën 2,576,600 lekë dhe llogarinë 213 ñ*Rrugë, rrjete, vepra ujore*ò në shumën 64,218,690, veprime këto të shprehura në fletë kontabilizimin nr. 3, muaji Dhjetor 2020.
- Llogaria 211 ñ*Pyje kullota plantacione"* për vlerën kontabël historike 237,999,902, shtuar gjatë vitit për diferencën (237,999,902 - 54,386,677) = 183,613,225 ***lekë***. Kjo llogari është e analizuar për dy objekte.
(Më hollësisht analiza e llogarisë 211 sipas pasqyrës nr. 3.19.1. bashkëlidhur.)
Shtesat në vitin ushtrimor 2020 për 183,613,225 lekë, përfaqësojnë pyje, kullota, plantacione të cilat janë rregjistruar në pronësi të Bashkisë pranë ASHK pazuar në tarifat vlerësuese.
Është kryer veprimi kontabël debitohet llogaria 212 ñ*Pyje, kullota, plantacione*ò në shumën 183,613,225 lekë dhe kredituar llogaria 1011 ñ*Shtesë fonde bazë nga vlerësimi*ò po me këtë shumë.
- Llogaria 212 ñ*Ndërtime konstruksione*ò për vitin 2020 është në vlerën historike për ***408,669,979lekë***, shtuar gjatë vitit për diferencën (409,669,979 - 395,692,562) = 13,977,417 lekë. Kjo llogari është e analizuar per 81 objekte.
(Më hollësisht analiza e llogarisë 212 sipas pasqyrës nr. 3.19.2. bashkëlidhur.)
Pakësimi për diferencën 2,576,600 lekë, përfaqësojnë pakësim nga sistemim llogarie në shumën 2,576,600 lekë duke pakësuar llogarinë 212 ñ*Ndërtime konstruksione*ò, veprime këto të shprehura në fletë kontabilizimin nr. 5, muaji Dhjetor 2020.
- Llogaria 213 ñ*Rrugë rrjete vepra ujore*ò për vlerën historike ***991,320,044 lekë***. Pakësuar gjatë vitit për (991,320,044 - 960,154,390) = 31,165,654 lekë. Kjo llogari është e analizuar për 84 objekte.
(Më hollësisht analiza e llogarisë 213 sipas pasqyrës nr. 3.20. bashkëlidhur.)
Pakësimi për diferencën 50,247,910 lekë, përfaqësojnë: Shtesë në Llogari nga investimet e kryera për objektet ñ*Ndërtim lera dhe përmirësim kullote*ò në shumën 1,720,780 lekë: ñ*Rikonstruksion Kanali vaditës Dukaj*ò në shumën 10,000,000 lekë; ñ*Rikonstruksion fasada unaza veriore*ò në shumën 2,250,000 lekë, veprim ky i shprehur në fletë kontabilizim nr. 4, muaji dhjetor 2020. Si dhe pakësim nga sistemim llogarie në shumën 64,218,690 lekë duke pakësuar llogarinë 213 ñ*Rrugë, rrjete, vepra ujore*ò, veprime këto të shprehura në fletë kontabilizimin nr. 5, muaji Dhjetor 2020, konkretisht për objektet ñ*Sheshi kryesor + Hyrja e kalasë*ò në vlerën 48,997,956 lekë dhe ñ*Sheshi i spitalit*ò në vlerën 15,220,734 lekë.
- Llogaria 214 *"Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune*ò për vlerën kontabële historike 11,738,947 lekë, gjatë viti kjo llogari nuk ka pasur ndryshime në ritje ose zvogëlm të vlerës dhe është e analizuar për 20 objekte.

(Më hollësisht analiza e llogarisë 213 sipas pasqyrës nr. 3.21. bashkëlidhur.)
- Llogaria 215 ñ*Mjete transporti*ò për vlerën historike 16,768,309 lekë, e cila gjatë vitit ushtrimor është shtuar për diferencën (16.768 - 17,728,189) = 959,880 lekë. Kjo llogari është e analizuar për objekte.
(Më hollësisht analiza e llogarisë 215 sipas pasqyrës nr. 3.22. bashkëlidhur.)
- Llogaria 218 *"Inventar ekonomik*ò për vlerën historike 33,061,240 lekë, është sipas rezultatet e inventarizimit fizik.
- Llogaria 31 ñ*Materiale*ò për vlerën kontabël 1,073,159 lekë, pakësuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (1,227,154 - 1,073,159)= 153,995 lekë.
- Llogaria 32 ñ*Inventar i imët*ò për vlerën kontabël 15,525,127 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (15,525,127 ï 15,071,527) = 453,600 lekë.
Evidenca e aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Tepelenë, viti 2020
Kjo pikë e programit është trajtuar me akt verifikimi më vete.
Analiza e llogarive debitorë viti 2020
Në llogaritë financiare të vitit 2020, gjendja e llogarive debitore:
- Llogaria 468 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò, paraqitet me vlerë kontabël 135,712,539 lekë. Kjo llogari krahasuar me vitin paraardhës është shtuar për vlerën (135,712,539 - 134,024,238) = 1,688,301 lekë.
Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në debi të saj janë kontabilizuar debitorët me analizë si vijon:
- 13,412 mijë lekë janë detyrimet për tatim taksat lokale,
- 85,372 mijë lekë detyrime të pa arkëtuara sipas rekomandimeve të KLSH-së,
- 25,117 mijë lekë detyrime në vite të vlerësuara pa mundësi arkëtimi,
- 2,290 mijë lekë gjoba të vendosura nga IMTV por të pa arkëtuara,
- 1,575 mijë lekë detyrime të pa paguara taksë e infrastrukturës për objektet ndërtim pa leje të legalizuara dhe
- 6,402 mijë lekë detyrime të pa vjelë për taksën e ndërtesës e të tjera nga agjenti tatimot Ujësjellës Kanalizimet Tepelenë.
(Më hollësisht analiza strukturore e llogarisë 468, është si në Pasqyrën nr. 3.23. bashkëlidhur.)
Në Gjykatë nuk ka asnjë debitor në proces gjyqësor.
Detyrimet pa mundësi arkëtimi, janë përcaktuar për ato subjekte të cilët detyrimin e kanë të krijuar para vitit 2011, për shkak të lëvizjeve demografike , humbje jetë, mbyllje bznesi dhe shkaqe të tjera objektive të cilat janë vlerësuar si pamundësi arkëtimi. Këto janë të pasqyruar si detyrim në llogarinë 468 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò ne shumën 135,712,539 lekë.
Nga të dhënat analitike të kësaj llogarie, konstatohet se janë kontabilizuar debitorë gjithësej për 1129 subjekte dhe persona fizikë. Ka debitorë nga viti 2008 kurse debitorët për tatim taksat janë nga viti 2011.
Nuk janë kryer procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e të drejtave nga debitorët.
(Më hollësisht analiza e debitorëve sipas subjekteve, vlerës së debisë dhe periudhës së krijimit e llogarisë 468, është si në Pasqyrën nr. 3.24. bashkëlidhur.)
Analiza e llogarisë 429 viti 2020.
- Kjo llogari debitorë për vlerën 1,254,774 lekë është e analizuar për 43 subjekte. Nga të dhënat kontabël debitorët janë të periudhave 2000-2008.
(Më hollësisht analiza strukturore e llogarisë 429, është si në Pasqyrën nr. 3.25. bashkëlidhur.)
Analiza e llogarisë 49 ñ*Shuma të parashikuara për zhvlerësim*ò viti 2020.
Kjo llogari në pasqyrat financiare të vitit 2020, është në rubrikën ñ*Llogaritë e arkëtueshme"*, pasqyruar në zbritje (me shënjën -) për vlerën 41,489,026 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë regjistruar vlera pa mundësi arkëtimi:
- 25,117,132 lekë debitorë (pjesë e llogarisë 468),
- 15,117,120 lekë debitorë për dy subjekte sipas sipas rekomandimeve të lëna nga auditimet e KLSH-së dhe
- 1,254,774 lekë debitorë të tjerë llogaria 429.
Kontabilizimi në llogarinë 49, nuk është argumentuar nëse janë proceduar në rrugë gjyqësore për arkëtimin e vlerave debitorë.
Detyrimet pa mundësi arkëtimi, janë përcaktuar për ato subjekte të cilët detyrimin e kanë të krijuar para vitit 2011, për shkak të lëvizjeve demografike, humbje jete, mbyllje biznesi dhe shkaqe të tjera objektive të cilat janë vlerësuar si pamundësi arkëtimi. Këto kërkesa debitore, janë të pasqyruar në llogarinë 468 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò në shumën 135,712,539 lekë. ***Ky vlerësim është bërë nga Drejtoria e Financës.***
- Llogaria 486 ñ*Shpenzime të periudhave të ardhshme*ò për vlerën kontabël 58,056,725 lekë.
Kjo llogari është krijuar gjatë vitit 2020 dhe përfaqëson vlerën kundërparti të disa llogarive të detyrimeve kreditore të pasivit të bilancit, e analizuar si vijon:
-31,289,652 lekë, detyrime me kundërparti në kredi të llogarisë 467 ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò,
-26,767,073 lekë detyrime ndaj fornitorëve me kundërparti llogaritë 401-408 ñ*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*ò.
Referuar veprimit kontabël sipas fletë kontabilizimit nr. 1 të muajit Dhjetor 2020, debiti i llogarisë 486, është analizuar si vijon:
- 5,664,236 lekë - shpenzime për periudhat e ardhshme për ñ*vendime gjyqësore*ò,
- 15,263,422 lekë - shpenzime për periudhat e ardhshme ñ*mallra*ò,
- 20,535,358 lekë - shpenzime për periudhat e ardhshme ñ*shërbime*ò,
- 5,090,058 lekë - shpenzime për periudhat e ardhshme ñ*mirëmbajtje*ò,
- 11,503,651 lekë - shpenzime për periudhat e ardhshme ñ*investime*ò.
<u>Analiza e llogarive kreditore viti 2020</u>
- Llogaritë ***401-408*** ñ*Furnitorë e llogari të lidhura me to*ò është për vlerën kontabële 26,767,073 lekë. Është e analizuar për 151 subjekte kreditore.
(Më hollësisht analiza strukturore e llogaritë 401-408, është si në Pasqyrën nr. 3.26. bashkëlidhur.)
Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se Bashkia Tepelenë, në fund të vitit 2020, rezulton me detyrime të pa paguara, llogaria 401-408 për shumën 26,767,073 lekë. Këto detyrime, një pjesë janë krijuar gjatë vitit ushtrimor 2020, por janë edhe detyrime nga vitete paraardhëse, përfshi nga viti 2016.
Shuma e detyrimeve që i përkasin viteve paraardhëse 2016-2019, është për 17 raste në shumën 14.363,534 lekë.
- Llogaria 467.
Nga analiza e llog. 467, konstatohet se në këtë llogari janë kontabilizuar detyrimet për vlerën totale 31,289,652 lekë.
Kjo llogari është e analizuar për 151 subjekte kreditore dhe përfshin detyrime nga viti 2018.
(Më hollësisht analiza strukturore e llogarisë 467, është si në Pasqyrën nr. 3.27. bashkëlidhur.)
Në detyrimet e llogarisë 467, janë përfshirë edhe 4 rastë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë përfshi nga viti 2010.
Gjendja në fund të vitit 2020 për detyrime për vendime gjyqësore është në shumën 5,664,236 lekë.
- Llogaria 42 ñ*Detyrime ndaj personelit*ò për vlerën 7,895,699 lekë.
Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se këto detyrime i përkasin pagave tëmuajit dhjetor të vitit 2020.
- Llogaria 431 ñ*Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat*ò për vlerën 359,296 (Nga 4,088,147

leke ne vitin paraardhës) lekë përfaqëson detyrimet e pa paguara për tatmin mbi të ardhurat personale.
Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se këto detyrime i përkasin periudhave Tatimi i të ardhurave nga punësimi muaji dhjetor 2020.
- Llogaria ñ435 ñ*Sigurime Shoqërore*ò për vlerën 2,281,133 (Nga 10,789,388 lekë në vitin paraardhës) përfaqëson detyrimet e pa paguara për sigurimet shoqërore.
Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se këto detyrime i përkasin periudhave Sigurime shoqërore muaji dhjetor 2020.
- Llogaria ñ436 ñ*Sigurimet shëndetësore*ò për vlerën e detyrimeve 311,864 (Nga 619,630 lekë në vitin paraardhës).
Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se këto detyrime i përkasin periudhave Sigurime shëndetësore muaji dhjetor 2020.
Kriteri:Kërkesat e ligjit nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, Kreu III, nenet 34/6 dhe 40/3, ligji nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, neni 40, pika 3, gërma ñdhò.
Ndikimi/Efekti:Në përkeqësimin e treguesëve financiarë të Bashkisë.
Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkia Tepelenë, të programojë buxhete vjetorë me të ardhura dhe shpenzime të balancuara. Në programimin e buxheteve, të parashikohen si zë më vete i shpenzimeve, pagesat për detyrimet kreditore të trashëguara nga viti paraardhës, në zbatim të kërkesave të UMF nr. 2, datë 20.01.2020 ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020*ò.
Të procedohet në rugë ligjore me padi në gjykatë, për vjeljen e kërkesave mbi debitorët.

Titulli i gjetjes:- Nga auditimi i programimit të shpenzimeve për vitin 2020, u konstatua se në dy raste programimi i shpenzimeve është bërë pa u bazuar në analiza dhe preventiva të detajuara sipas kërkesave ligjore, konkretisht:
- Janë alokuar fonde për ñ*Futboll Klub Tepelena*ò me NIPT L32608791F, për 13 raste në shumën totale 4,542 mijë lekë, sipas miratimit me VKB nr. 90, datë 20.12.2019, pa pasur një preventiv analitika bazuar në kërkesat ligjore.
- Me VKB nr. 22 datë 02.04.2020 ñ*Për trajtimin me bonus qiraje për famijet në nevojë të cilat nuk mund ta përballojnë qiranë e tregut të lirë*ò, janë miratuar fonde për për bonus qira banese për 44 familje.
Gjatë vitit 2020, janë paguar për bonus qira banese në 27 raste në shumën totale 2,412 mijë lekë.
Pagesat janë bërë vetëm nga fondet buxhetore pa kontribute nga të ardhurat e Bashkisë, në kundërshtim me kërkesat ligjore.
Situata:*Testim për llogarinë 604.*
- Janë kontabilizuar shpenzime Transferta për ñFutboll Klub Tepelenaò me NIPT L32608791F, në vitin 2020 për 13 raste në shumën totale 4,542,000 lekë, sipas miratimit me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 90, datë 20.12.2019 si më poshtë:
- Urdhër shpenzimi nr. 4 datë 7.01.2020, nr. 64, datë 27.01.202, nr. 121, datë 14.02.2020, nr. 152, datë 02.04.2020, nr. 228, datë 11.05.2020, nr. 249, datë 8.06.2020, nr. 249, datë 8.06.2020, nr. 286, datë 02.07.2020, nr. 380, datë 2.09.2020, nr. 423, datë 01.10.2020, nr. 488, datë 26.10.2020, nr. 424, datë 11.11.2020, nr. 529, datë 16.11.2020, nr. 555, datë 14.12.2020.
Nga auditimi i procedurave mbi llogaritjen e fondeve limiti për financimin e aktivitetit të ***"Futboll Klub Tepelena,*** të paraqituar për miratim në Këshillin e Bashkisë, konstatohet se ***nuk ka analiza dhe preventiv për mënyrën e llogaritjes së këtij fondi.***
Në këtë rast, ***nuk janë zbatuar kërkesat*** e ligjit nr. 79/2017 ñ*Për sportin*ò i ndryshuar nent 8, 19, 39 dhe VKM nr. 1720, datë 29.10.2008 ñ*Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë*

*sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sporteve që i arijnë këto nivele si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sporteve*ò.

Shpenzime për bonus qira banese.

- Me Vendim të Këshilit Bashkise nr. 22 datë 02.04.2020 ñ*Për trajtimin me bonus qiraje për familjet në nevojë të cilat nuk mund ta përballojnë qiranë e tregut të lirë"*, janë miratuar për të përfituar 44 familje. Vendimi miratues, është referuar:

Në mbështetje të ligjit 139/2015 ñ*Për vetqeverisjen vendore*ò, ligjit 22/2018 ñ*Për strehimin social*ò, VKM nr. 459 datë 03.07.2019 ñ*Për rregullat për Administrimin e kërkesave të Vetëqeverisjes Vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvensionimin e qirasë ose uzurfrutit, mënyrën e financimit të subvensionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehimin*ò, VKM nr. 362 date 29.05.2019 ñ*Për kriteret e subvensionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvensionimin që qëzojnë përparësi në subvensionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij*ò, Bashkia Tepelenë i është drejtuar Ministrisë së Finanacave, Drejtoria e Strehimit me shkresë nr. 222/1 prot datë 07.02.2020 ñ*Kërkesë për çelje fondi nga buxheti i shtetit për programin e subvensionimit të qirasë për Bashkinë Tepelenë për vitin 2020*ò, në vijim të shkresës nr. 2069 prot datë 30.01.2020 ñ*Mbi fondet për strehimin për vitin 2020*ò sipas Shtojces B Formati aplikimi për fonde nga buxheti i shtetit për subvensionimin e qirasë, shkresë nr 5462 prot datë 12.03.2020 ñ*Për transferim të fondeve në Njësite e Qeverisjes Vendore*ò në zbatim të ligjit nr 88/2019 ñ*Për buxhetin e vitit 2020*ò në zbatim të udhëzimit plotësues të ministrit të Finanacave dhe Ekonomisë nr. 2 datë 20.01.2020 ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020*ò, është miratuar çelja e fondeve për këtë program strehimi për Bashkinë Tepelenë për vitin 2020.

Aktualisht trajtohen me bonus qira për banesë 44 familje.

Nga auditimi për vitin 2020, u konstatua se janë paguar:

<u>Në 27 raste në shumën totale 2,411,800 lekë, paguar referuar Urdhër shpenzime si vijon:</u>

U. shpenzimi nr. 187, 188, 189 datë 15.04.2020 përkatësisht për 258,000, 339,000 dhe 57,000 lekë, nr. 224, 225, 226, datë 7.05.2020 përkatësisht për 100,000, 12,000 dhe 113,000, nr. 253, 254, 255 datë 8.06.2020 përkatësist për 100,000, 142,000 dhe 47,000 lekë, nr. 304, 305, 306 datë 8.07.2020 përkatësisht për 100,000, 126,000 dhe 19,000 lekë, nr. 333, 334, 345 datë 5.08.2020 përkatësisht për 93,000, 120,000 dhe 26,000 lekë, nr. 407, 408, 409 datë 15.09.2020 përkatësihst për 114,000, 26,000 dhe 86,800 lekë, nr. 433, 434, 435, datë 5.10.2020 përkatësisht për 93,000, 114,000 dhe 19,000 lekë, nr. 526, 527, 528, datë 11.11.2020 përkatësisht për 93,000, 19,000 dhe 114,000 lekë, nr. 566, datë 21.12.2020, për 24,000 lekë dhe nr. 571, 572, datë 21.12.2020 përkatësisht për 52,000 dhe 5,000 lekë.

Pagesa është përballuar tërësisht nga fondet buxhetore pa kontributin e Bashkisë Tepelenë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 459, datë 3.07.2019 ñ*Për rregullat për Administrimin e kërkesave të Vetëqeverisjes Vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvensionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvensionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehimin*ò, pikat 2, 5.

<u>Kriteri:</u>Në këtë rast, ***nuk janë zbatuar kërkesat*** e ligjit nr. 79/2017 ñ*Për sportin*ò i ndryshuar nent 8, 19, 39 dhe VKM nr. 1720, datë 29.10.2008 ñ*Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sporteve që i arijnë këto nivele si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sporteve*ò.

<u>Ndikimi/Efekti:</u>Ndikim në shpenzimet e fondeve sipas kërkesave ligjore në rastin e financimit të Klubit të Sportit si dhe për financimin bonus qira banese.

<u>Shkaku:</u>Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

<u>Rëndësia:</u> E lartë

<u>Rekomandim:</u>Bashkia Tepelenë të marrë masat që në programimin e shpenzimeve për

financimin e ñ*Futboll Klub Tepelena*ò dhe për bonus qira banese, tëbazohet në preventiva analitikë sipas kërkesave ligjore.

Titulli i gjetjes:- Nga auditimi i procedurave mbi regjistrimin e pronave të Bashkisë Tepelenë të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të saj si dhe procedurave për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata, u konstatua:
- Bashkia Tepelenë, ka vazhduar procedurat për regjistrimin e pronave të saj në Kadastrën Urbane. Ky regjistrim është shoqërur duke i vlerësuar sipas tarifave të miratuara me VKM nr. 89, datë 03.02.2016 ñ*Për miratimin e hartës të vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë*ò.
Ky vlerësim, ka sjellë për efekt ritjen e vlerës së llogarive të Aktiveve Afatgjatë e cila është pasqyruar në llogaritë kontabël.
- U konstatua se procedurat e inventarizimit të aktiveve për vitin 2019 dhe 2020, nuk janë të sakta dhe të plota pasi, nuk janë inventarizuar të gjitha aktivet afatgjata, pra disa nga llogaritë financiare nuk janë verifikuar për gjendjen fizike të tyre.
Situata:- Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.
- Testimi i llogarive inventariale
A- Nga auditim i procedurave mbi regjistrimin i pronave të Bashkisë Tepelenë të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të saj si dhe procedurave për inventarizimin e Aktiveve afatgjata, u konstatua:
- Nga të dhënat e paraqituar, konstatohet se nga Bashkia Tepelene. ka vijuar procesi i regjistrimit të pronave që me VKM kanë kaluar në pronësi të kësaj bashkie.
Janë regjistruar (Për vitet 2019-2020) gjithësej 96 prona si në pasqyrat më poshtë vijon:
Regjistrimi i pronave të tokë arë, truall dhe pyje e kullota, është shoqëruar duke i vlerësuar ato referuar VKM nr. 89, datë 03.02.2016 ñ*Për miratimin e hartës të vlerës së tokës në Repubilkën e Shqipërisë*ò.
Për vlerësimin në vlerë të pronave të regjistruara: toka arë, truall, kullota etj. është krijuar komisioni përkatës vlerësues i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 28, datë 18.02.2020 ñ*Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve*ò i përbërë nga 5 anëtarë me kryetar z. S. K. me detyrë Drejtor i Financës.
Bazuar në këto regjistrime dhe vlerësimi, janë bërë ndryshimet përkatëse në llogaritë kontabël të aktiveve përkatëse afatgjatë, konkretisht sipas të dhënave të pasqyrës që vijon:
Për vitin 2019.
Me veprimi kontabël nr. 3, Dhjetor 2019 si vijon:
Debi: Llog. 210 *"Toka, troje, terrene"* për 38,790,441 lekë
Llog. 211 ñ*Pyje, kullota, plantacione*ò për 54,190,477 lekë.
Kredi: Llog. 1011 ñ*Shtesë fonde bazë"* nga vlerësimi për 92,980,918 lekë.
Nga të dhënat e pasqyrave financiare për vitin 2019, shtesat e llogarive 2010 dhe 211, janë të barabartë janë të barabartë sipas këtij veprimi kontabël.
(Më hollësisht pasqyra analitike mbi vlerësimin e aseteve të regjistruara në Kadastër për vitin 2019, është si në Pasqyrën nr. 3.28. bashkëlidhur.)
Për vitin 2020.
Me veprimi kontabël nr. 3, Dhjetor 2020 si vijon:
Debi: Llog. 210 *"Toka, troje, terrene"* për 31,666,076 lekë
Llog. 211 ñ*Pyje, kullota, plantacione*ò për 183,613,225 lekë.
Kredi: Llog. 1011 ñ*Shtesë fonde bazë"* nga vlerësimi për 215,279,301 lekë**.**
Nga të dhënat e pasqyrave financiare për vitin 2020, shtesat e llogarisë 211, është e barabartë sipas këtij veprimi kontabël.
Llogaria 210, gjatë vitit 2020, është shtuar për vlerën 98,461,366 lekë nga të cilat 31,666,076 lekë nga vlerësimi i aseteve nga regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Tepelenë dhe diferenca për 66,795,290 lekë përfaqësojnë investime gjatë vitit të cilat janë të analizuara në

kontabilitet për 5 objekte.
(Më hollësisht pasqyra analitike mbi vlerësimin e aseteve të regjistruara në Kadastër për vitin 2020, është si në Pasqyrën nr. 3.29. bashkëlidhur.)
B- Inventarizimi i llogarive të Aktiveve Afatgjata.
- Për vitin 2019.
Me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 81, datë 23.12.2019 *"Për kryerjen e inventarizimit te aktiveve të qëndrueshme, inventarit të imët dhe materialeve*ò, është ngritur Komisioni përkatës për kryerjen e inventarizimit përfshi në Njësitë Administrative të Bashkisë, me kryetare zj. M. N.- specialiste e financës. Komisionet janë të përbërë nga 3 anëtarë.
Nga dokumentacioni që na u paraqit konstatohet:
- Në fund të inventarëve, është përgatitur Informacion (Relacioni) për titullarin mbi përfundimin e inventarizimeve, ku nuk janë konstatuar diferenca si dhe nuk janë propozuar për të nxjerë nga përdorimi vlera inventariale.
Procesi i inventarizimit, nuk është kryer i plotë pasi nuk janë inventarizuar të gjitha Aktivet Afat gjata, konkretisht:
- Nuk është kryer inventarizimi fizik për gjendjen fizike të llogarisë 210 ñ*Toka, troje, terrene*ò e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 46,568,929 lekë.
- Nuk është kryer inventarizimi fizik për gjendjen fizike të llogarisë 211 ñ*Pyje, kullota, plantacione*ò cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 54,386,677 lekë.
- Nuk është kryer inventarizimi fizik për gjendjen fizike të llogarisë 212 ñ*Ndërtesa e konstruksione*ò e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 408.671,179 lekë.
- Nuk është kryer inventarizimi fizik për gjendjen fizike të llogarisë 213 ñ*Rrugë, rrjete, vepra ujore*ò e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 991,318,844 lekë.
- Nuk është kryer inventarizimi fizik për gjendjen fizike të llogarisë 214 ñ*Instalime teknike, makineri pajisje*ò e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 11,738,947 lekë.
- Nuk është kryer inventarizimi fizik për gjendjen fizike të llogarisë 215 ñ*Mjete transporti*ò e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 11,734,947 lekë.
- Nga Inventarizimi mbi gjendjen fizike të materialeve të magazinës, përkatësisht llogaria kontabël 31 ñ*Materiale*ò ka rezultuar pa diferenca për gjendjen fizike në shumën totale për 1,726,298 lekë.
Procedurat për inventarizimin e gjendjes së materialeve në magazinë, nuk janë të plota pasi nuk janë pasqyruar me procesverbal gjendja e kartelave të materialeve të rakorduara me sektorin e financës, nuk është pasqyruar në relazion e kryerjes së inventarizimit, veprimet e fundit me magazinën, hyrjet dhe daljet e fundit referues për gjendjen në magazinë për kryerjen e inventarizit fizik.
- Për vitin 2020.
Me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 121, datë 01.12.2020 *"Për kryerjen e inventarizimit te aktiveve të qëndrueshme, inventarit të imët dhe materialeve*ò, është ngritur Komisioni përkatës për kryerjen e inventarizimit përfshi në Njësitë Administrative të Bashkisë, me kryetare të komisionit; zj. ***M. N.,****specialiste e financës*. Komisionet janë të përbërë nga 3 anëtarë. Nga dokumentacioni që na u paraqit konstatohet:
- Në fund të inventarëve, është përgatitur Informacion (Relacioni) për titullarin mbi përfundimin e inventarizimeve, ku nuk janë konstatuar diferenca si dhe nuk janë propozuar për të nxjerë nga përdorimi vlera inventariale.
Procesi i inventarizimit, nuk është kryer i plotë pasi nuk janë inventarizuar të gjitha Aktivet Afat gjata, konkretisht:
- Nuk është kryer inventarizimi fizik për gjendjen fizike të llogarisë 210 ñ*Toka, troje, terrene*ò e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 145,030,295 lekë.
- Nuk është kryer inventarizimi fizik për gjendjen fizike të llogarisë 211 ñ*Pyje, kullota,*

*plantacione*ò cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 237,999,902 lekë.
- Nuk është kryer inventarizimi fizik për gjendjen fizike të llogarisë 212 ñ*Ndërtesa e konstruksione*ò e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 406,093,379 lekë.
- Nuk është kryer inventarizimi fizik për gjendjen fizike të llogarisë 213 ñ*Rrugë, rrjete, vepra ujore*ò e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 941,072,134 lekë.
- Nuk është kryer inventarizimi fizik për gjendjen fizike të llogarisë 214 ñ*Instalime teknike, makineri pajisje*ò e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 11,738,947 lekë.
- Nuk është kryer inventarizimi fizik për gjendjen fizike të llogarisë 215 ñ*Mjete transporti*ò e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 11,738,947 lekë.
- Nga Inventarizimi mbi gjendjen fizike të materialeve të magazinës, përkatësisht llogaria kontabël 31 ñ*Materiale*ò ka rezultuar pa diferenca për gjendjen fizike në shumën totale për 1,726,298 lekë.
Procedurat për inventarizimin e gjendjes së materialeve në magazinë, nuk janë të plota pasi nuk janë pasqyruar me procesverbal gjendja e kartelave të materialeve të rakorduara me sektorin e financës, nuk është pasqyruar në relacionin e kryerjes së inventarizimit, veprimet e fundit me magazinën, hyrjet dhe daljet e fundit referues për gjendjen në magazinë për kryerjen e inventarizit fizik.
- Përgatitja e pasqyrave financiare, pa kryer më parë inventarizimin e të gjitha Aktiveve Afatgjatë, janë veprime dhe mos veprime ***në kundërshtim*** me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò, neni 15, pika 1 dhe 2, ku citohet:

"1. Njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumenteve kontabël përkatëse në përputhje me rregulloren e inventarizimit të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.
2. Organi i drejtimit të njësisë ekonomike mban përgjegjësi për procedurat e ndjekura për inventarizimin e aktiveve dhe detyrimeve, me qëllim paraqitjen me vërtetësi dhe besueshmëri të elementeve të aktivit dhe detyrimeve në pasqyrat financiare.",

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik*ò i ndryshuar, pika 74 ku citohet*:*

"Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës"

Dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në në Njësite e Qeverisjes së Përgjithsshme*ò , Kap. III, pika 30 ku citohet:

"30. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet."

Dhe Kap. IV, pika 104 ku citohet:

"104. Para realizimit të procesit të konsolidimit të pasqyrës financiare të pozicionit financiar, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme duhet të ketë saktësuar zërat e mëposhtëm si:
- Pronat, tokat, makineritë, pajisjet, aktivet e patrupëzuara, aktivet financiare afatshkurtra, aktivet financiare afatgjata, inventarët, mjetet monetare; - Detyrimet afatshkurtra, detyrimet afatgjata, provigjionet, rezultatet; si dhe - Aktivet neto/fondet neto."

Mos kryerja e procedurave të regullta në kryerjen e inventarizimit për gjendjen e materialeve

në magazinë, janë veprime dhe mos veprime ***në kundërshtim*** me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik*ò i ndryshuar, pika 83 ku citohet:

ñ*Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisjonit dhe përgjegjësit material."*

dhe pika 85/b, c ku citohet*:*

"Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë: b. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë proçesverbalet. c. Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues."

Përgjegjësi e komisionit të inventarizimit, zj. M. N.- *specialiste e financës në cilësinë e kryetares së komisionit të inventarizimit.*

<u>- Testimi i llogarisë 602</u>

C. Procedurat për administrimin e shpenzimeve për karburant, testimi i llogarisë së shpenzimeve 602.

Nga auditimi i procedurave mbi shpenzimet për karburant për vitin 2020, llogaria ekonomike 602, u konstatua:

Ndjekja e konsumit të karburantit, është bërë ***z. G. G.-*** me detyrë Specialist në Drejtorinë e Tatim Taksave B. Tepelenë.

Sipas të dhënave që na u paraqitën dhe evidencës mbi konsumin e karburantit, konstatohet së gjatë vitit, janë bërë dalje gjithësej 73,000 litra karburant me cmim mesatar 131 lekë/litra, vlerësuar për shumën 9,563 nijë lekë.

Shpenzimi për 9 mjete transporti, 2 kaldaja të shkollave si dhe mjete për mirëmbajtjen e gjelbërimit të lulishteve.

Janë përcaktuar normativat e konsumit të karburantit. Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 82, datë 23.12.2019 ñ*Për përcaktimin e normativës së harxhimit të karburantit të automjeteve të Bashkisë*ò, është ngritur komisioni përkatës për llogaritjen e harxhimit të karburantit për automjetet e bashkisë i përbërë nga 6 persona. Janë miratuar normativat e konsumit të karburantit për çdo mjet transporti përfshi edhe kaldajat e shkollave.

Të dhënat mbi llojin e mjetit, mormativat e konsumit, personi tërheqës i karburantit dhe sasia e konsumit, janë si në pasqyrën nr. 5/30 bashkëlidhur.

U përzgjodh muaji Shtator për auditimi mbi dokumentat justifikues për shpenzimin e korburantit të mjeteve si më sipër nga u konstatua:

- Për evdentimin e shpenzimeve për kaldajën e shkollës, (referuar muajit Dhjetor), është përgatitur pasqyra përkatëse e firmosur nga 3 persona: Specialisti i kaldajës, Drejtori i Shërbimeve të Bashkisë si dhe një speciali specialist tjetër.
- Për evidentimi e shpenzimeve për mjetin tip ñSkrepò me targa AA 753 NC, është mbajtur proces verbal në të cilën është shënuar objekti i punës, orët e punës së mjetit sipas datave. Ky proces verbal është firmosur nga 3 persona; nga drejtuesi i mjetit, tekniku i ndjekjes së punimeve dhe Administratori i Njësisë ku kryehen punime. Fletë dalja e karburanti është firmosur nga drejtuesi i mjetit.
- Shpenzimet për automjetin e Policisë Bashkia tip Man 0726. Tërheqës i karburanti është

drejtuesi i mjetit. Fleta e udhëtimi është e firmosur nga drejtuesi i mjetit dhe e miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Lëvizjet e mjetit, kanë të përcaktuar datën, vendmbritjen dhe km të pershkruara. Nuk janë të firmosura nga personi udhëtues dhe as nuk është përcaktuar qëllimi i shërbimit.
- Shpenzime me automjetin tip kamion targa AA 265 SG. Tërheqës i karburanti është drejtuesi i mjetit. Fleta e udhëtimi është e firmosur nga drejtuesi i mjetit dhe e miratuar nga Drejtori i Shërbimeve. Lëvizjet e mjetit, kanë të përcaktuar datën, vendmbritjen dhe km të përshkruara. Qëlli i lëvizjes përshkruhet ñ*Transport dherash*ò. Nuk janë të firmosura nga ndonjë person tjetër dhe as nuk është përcaktuar objekti i shërbimit.
- Shpenzime me automjetin tip benz AA 619 DM (Njësia Administrative Qëndër). Tërheqës i karburanti është Administratori i Njëisë Qëndër. Fleta e udhëtimi është e firmosur nga drejtuesi i mjetit dhe e miratuar nga Administarori i Njësisë. Lëvizjet e mjetit, kanë të përcaktuar datën, vendmbërritjen dhe km e përshkuara. Nuk janë të firmosura nga ndonjë person tjetër dhe as nuk është përcaktuar objekti i shërbimit.
Në përfundim:
Evidentimi i shpenzimeve për karburant, në disa raste nuk është i plotë, pasi në rastete e shpënzimeve për automjetin e Policisë Bashkiake, të kamionit për trasport të dherave dhe mbetjeve urbane si dhe të shpenzimeve të kryera me mjetet e Njësive Administrative, në fletët e udhëtimit, nuk është përcaktuar qëllimi i shërbimit ose objeti i punës si dhe nuk janë të firmosuara nga personi udhëtues ose përsoni që mdjek kryerjen e shërbimit sipas projektit, praktikë në kundërshtimme kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*ò i ndryshuar pikat 35/b dhe 36.
Përgjegjësi e z. G. G., me detyrë Specialit në Drejtorinë e Tatim Taksave B. Tepelenë në cilësinë e personit të ngarkuar me evidentimin e shpenzimeve për karburant.
Kriteri:Kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò, neni 15, pikat 1 dhe 2, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik*ò i ndryshuar, pika 74 dheUMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, Kap. III, pika 30 dhe Kap. IV, pika 104. Konkretisht; për vitin 2019 dhe 2020, me urdhër të Titullarit të Intitucionit, janë ngritur komisionet *"Për kryerjen e inventarizimit te aktiveve të qëndrueshme, inventarit të imët dhe materialeve*ò.
Ndikimi/Efekti:Në besueshmërinë e pasqyrave financiare pasi llogaritë e aktiveve afatgjata, nuk janë verifukuar me inventar për ekzistencën fizike të tyre.
Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore në procedurat për përgatitjen e pasqyrave financiare.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkia Tepelenë, të marë masat e nevojshme, të kryejë invenarin fizik për gjithë asetet në pronësi të saj.Përkëtë, është e nevojshme të ngrejë komisione me specialistë të fushës.

2.4. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, Manualeve përkatëse të punimeve, udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik etj.

Drejtimi nr. 4 i Programit të auditimit, nënpikat 4.1, 4.2 dhe 4.3, konsiderohen të paezauruara dhe do të auditohen në auditimin e ardhshëm.

2.4.4. Auditim mbi hartimin e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet

publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues.

2.6.5. Auditim mbi zbatimin e kushteve në realizimin e punimeve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera në kontratat e lidhura me operatorët ekonomike fitues.

Në zbatim të pikave më sipër, është punuar në periudhën 17.05.2021 ï 21.05.2021, ku u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit, pasqyra e të cilave është bashkëlidhur në anekset e PRA.

Nga kjo analizë, janë përzgjedhur për auditim dy objekte në bazë të vlerës së kontratës, si më poshtë:

Nr.	Objekti	Kontraktori	Vlera e kontratës (me T.V.Sh.)	Shënime
1	Pastrimi i Rezervuarit dhe Rehabilitimi kanalit Ujitës Dukaj	ñSh.ò Sh.P.K.	11,966,064	Audituar
2	Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj	ñSh.ò Sh.P.K.	20,899,027	Audituar

I. "*Pastrimi i rezervuarit dhe rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj*"

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 895/3 prot., datë 25.06.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë, të përfaqësuar nga Titullari z. T. P.dhe Operatorit Ekonomik ñSh.ò Sh.P.K., me përfaqësues Y. B., me licencë profesionale NZ 3580/17. Vlera e kontratës është 11,966,064 lekë me T.V.Sh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Referuar kërkesës së Mbikëqyrësit të punimeve me nr. 02 prot, datë 12.08.2019 ñ*Kërkesë për shtyrje të afatit të punimeve*ò, AK me shkresën nr. 895/7, datë 23.09.2019 (ose rreth një muaj pas afatit kontraktual të përfundimit të punimeve) ka miratuar amendamentin e kontratës ñ*Për zgjatje të afatit të përfundimit të punimeve*ò, i cili parashikon zgjatje të afatit të punimeve me 45 ditë, duke filluar nga data 23.09.2019, me argumentin e mospengimit të ujitjes së tokave bujqësore për shkak të thatësirës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 895/5, datë 01.07.2019, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me ñR.ò Sh.P.K., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK 1506/8 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 306,930 lekë me T.V.Sh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 895/7, datë 28.10.2019, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE ñI.ò, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3331/1 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 56,002 lekë me T.V.Sh.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje leje ndërtimi/leje infrastrukturore/deklarata paraprake e kryerjes së punimeve.

Përsa sipër ngarkohet me përgjegjësi, Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. T. P..

- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria ñR.ò Sh.P.K. në Prill 2019.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 01.07.2019, duhet të përfundonin në 07.11.2019 dhe kanë përfunduar me datë 11.12.2019, ose 34 ditë jashtë afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, duke përfshirë edhe amendamentin e kontratës.

Për pasojë, mungojnë penalitetet që parashikojnë vonesat për dorëzimin jashtë afatit kontraktual të punimeve, të parashikuara në nenin 27 të kontratës së lidhur (si është

parashikuar penaliteti në nenin 34 të DST), sipas të cilit ñ*34.1 Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:*
a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.ò
Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se nuk janë mbajtur penalitete për vonesa në përfundimin e punimeve në masën 481,562 lekë (0.004 x 34 ditë x 3,540,900 lekë (pjesa e mbetur e kontratës, pasi deri në përfundim të afatit kontraktual të punimeve është janë situacionuar 8,412,479 lekë)). *Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve.*
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit; 2. Preventivi bazë; 2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar; 3. Libreza e masave; 4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "*Pastrimi i rezervuarit dhe rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj, Bashkia Tepelenë*"				
14. Lidhja e kontratës nr. 895/3 prot., datë 25.06.2019	**15. Vlera e kontratës (me T.V.Sh.)** 11,966,064 lekë **BOE fitues "Sh." Sh.P.K.**		**16. Likuiduar deri dt 12.12.2019** **11,953,379 lekë**	
17. Situacioni Përfundimtar dt 16.02.2019 **-Vlera me T.V.Sh. 11,966,064 lekë** **-Vlera pa T.V.Sh. 9,971,720 lekë**	**18. Afati i kontratës në dite** Parashikuar 60 ditë, Zbatuar 171 ditë. Fillimi punimeve: 01.07.2019 Perfundimi punimeve : 11.12.2019		**19. Zgjatja e kontratës** Amendament nr 895/7 prot., datë 23.09.2019, 45 ditë	
20. Mbikëqyrësi i punimeve ñR.ò Sh.P.K.	Licenca Nr: MK 1506/8	Kontrata nr. 895/5, datë 01.07.2019	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve OE ñI.ò Sh.P.K.	Licenca Nr: MK 3331/1	Kontrata nr. 895/7, datë 28.10.2019	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22. Akt Kolaudimi Datë ___.12.2019	**23. Akt i marrjes në dorëzim** dt __.12.2019		**24**. Fletë Hyrja nr. ... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **393,306 lekë pa T.V.Sh.**
<u>Titulli i gjetjes:</u> Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin ñPastrimi i rezervuarit dhe rehabilitimi i kanalit ujitës Dukajò, Bashkia Tepelenë, nga zbatuesi i punimeve OE ñSh.ò Sh.P.K., për zërat e punimeve A.12, B.10.
<u>Situata:</u>Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
- Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës, ñ*FV + çmontim montim tub çeliku Dj=609.6 mmm x 6.3 mm (2 nivele shkarkimi të rezervuarit)*ò, ñ*FV tub çeliku DJ 355.6 x 6.3 mm kg/ml 54.5 L=204 (zëvendësimi i lugut nga puseta në kanal)*ò, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
<u>Kriteri:</u>Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñ*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*ò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñ*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*ò, konkretisht Kreu II, Pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 895/3 prot., datë 25.06.2019; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 895/5, datë 01.07.2019; Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 895/7, datë 28.10.2019.
<u>Ndikimi/Efekti:</u>Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Tepelenë.
<u>Shkaku:</u>Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e

zbatimit të projektpreventivit, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 393,306 lekë pa T.V.Sh. nga kontraktori ñSh.ò Sh.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 895/3 prot., datë 25.06.2019 me ñ*Pastrimi i rezervuarit dhe rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj", Bashkia Tepelenë,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Proejktraportit të Auditimit, me shkresën nr. 517/17 prot, datë 28.05.2021, protokolluar në KLSH me nr. 102/22 prot., datë 31.05.2021 është observuar nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria ñR.ò Sh.P.K. Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
1. *Në akt konstatim thuhet për përfundimin e punimeve për 34 ditë me vonesë. Nga dokumentacioni që kemi rezulton se janë 2 amendamente për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve. Amendamenti i parë për efekt të ujitjes dhe amendamenti i dytë për boshatisjen e rezervuarit, kemi të bëjmë me një vepër hidroteknike që duhet, e cila shirat e verës kanë sjellë mbushje të rezervuarit dhe ne, për të zëvendësuar tubacionet, jemi të detyruar ta boshatisim atë me tub të brinjëzuar Ø 400 mm. Në përllogaritjen e vonesave nuk keni marrë parasysh dhe ditët me shi, ku ka qenë e pamundur të punohej, në ditar këto janë përcaktuar, si përfundim kamatë vonesa e përllogarëur 481,562 nuk qëndron sipas dokumentacionit të parashtruar më lart.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit: 1. Kjo gjetje, siç është cituar edhe në aktkonstatim, është e bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje. Pretendimi ardhur nëpërmjet observacionit, nuk shoqërohet me dokumentacionin e cituar. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.



2. A .Zbrazja e rezervuarit dhe rehabilitimi i ujeleshuesit.
*Auditi nuk ka marrë per bazë Zërat e punimeve **9+10+11**.*
Pretendimi i subjektit:
Zëri i punimeve nr. 9. *Shtrese zhavorri për nënshtresat 56.2 m^3, të cilin e ka kostifikuar zero. Kjo nuk qëndron, sepse kur është hapur diga, uji që ka ngelur nga shkarkimi i tubacionit Ø 400 për shkarkimin e plottë të rezervuarit janë përdorur tombino Ø 800. Para se të vendoseshin tubot prej betoni është bërë nivelimi me zhavorr. Toka ka qenë ne formë llave dhe pa vendosur zhavorr ishte e pamundur që të punohej. Pra, zëri i punimeve nënshtresat 56.2 m^3 është realizuar. Diferenca **56,200 nuk qëndron.***
Pretendimi i subjektit:
Zëri i punimeve nr. 10. *Projektuesi ka parashikuar që në rastin e rënies së shirave, tubacioni Ø 800 të bënte shkarkimin e ujrave që grumbullonte rezervuari. Poshtë tombinove është vendosur zhavorr, se në rast të kundërt, nuk mund të nivelohej vendi në ato kushte. Pra zëri i punimeve tombino Ø 800 është hequr pa të drejtë, si rezultat dhe diferenca prej **825,000 nuk qëndron** .*
Pretendimi i subjektit:
Zëri i punimeve nr. 11. *Lidhja e tubove të betonit bëhej me beton, madje dhe me zgarë që të mos*

*krijohej spostime. Zëri i punimeve të betonimit është përdorur për pengimin e llumit të baltës për të penguar bllokimin e tombinove me llumin e baltës. Tombinot janë vendosur ne gjatesine **110 ml** dhe pjesa tjeter e lenë në kanal të hapur. **Këto po jua parqesim të ilustruara edhe me foto**. Pra shuma **393,400nuk qëndron***

Qëndrimi i Grupit të auditimit: 2. Grupi i auditimit, ka bërë pasqyrimin e diferencave të mësipërme, pasi në dosje nuk gjendeshin foto që tregojnë për vendosjen e tubit të betonit me Ø 800 mm. Për këtë arsye zërin e vendosjes së tubit dhe zërat që shoqërojë atë, nuk i ka konsideruar. Nisur nga fotot që shoqërojnë argumentin e ardhur nëpërmjet observacionit, realizimi i këtyre zërave merret në konsideratë dhe vlera e tyre do të reflektohet në vlerën totale të dëmit ekonomik.

Pretendimi i subjektit:

3. Zëri i punimeve nr. 12. FV+cmontim tub celiku Dj=609.6mmx6.3mm. Ky zë punimesh është zeruar nga auditi. Por në fakt ky zë punimesh është tubacioni i vjetër, i cili u hoq dhe u zëvendësua me tubacion celiku Dj=609.6mmx6.3mm, midis shkarkuesit dhe tubacionit te vaditjes i cili ishte bllokuar totalisht. Nga përllogaritja ka një gabim pesha specifike, nuk është 102.05 por 94.7, simbas celikut të përdorur dhe specifikimeve teknike dhe çertifikatën e cilësisë. Situacion 3926*130=510380. Fakti 3645*130=473850 Diferenca **36,530 e cila është përllogaritur gabim**.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

3. Grupi i auditimit, ka bërë pasqyrimin e diferencave të mësipërme, pasi në dosje nuk gjendeshin foto që tregojnë për vendosjen e tubit të betonit me Ø 609.6mmx6.3mm. Për këtë arsye zërin e vendosjes së tubit, nuk i ka konsideruar. Nisur nga fotot që shoqërojnë argumentin e ardhur nëpërmjet observacionit, realizimi i këtij zëri merret në konsideratë dhe vlera e tyre do të reflektohet në vlerën totale të dëmit ekonomik.

Pretendimi i subjektit:

4 – Zëri i punimeve nr. 21. F.V tubacioni politileni PN -6 D=400mm simbas auditimit ky zë nuk është realizuar. Në rast se nuk do të ishin vënë këto tubo për shkarkimin e rezervuarit, projekti nuk realizohej, se nuk kishte me çfarë të realizohej, dhe në fakt është përdorur 75 ml tub dhe jo 40 ml . Pra diferenca prej 480,000 lekë është hequr padrejtësisht dhe pretendimi i auditimit nuk qëndron.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

4. Grupi i auditimit, ka bërë verifikimin në terren, sipas librit të masave dhe ka rezultuar se ky tubacion nuk ekziston në vepër. Përsa pretendohet në observacion, ky tubacion mund të jetë përdorur përkohësisht në lugje dhe jo për shkarkimin e rezervuarit, por pas përfundimit të rehabilitimit të lugjeve, është hequr. Nisur nga fotot që shoqërojnë argumentin e ardhur nëpërmjet observacionit, realizimi i këtij zëri merret në konsideratë dhe vlera e tyre do të reflektohet në vlerën totale të dëmit ekonomik.

Pretendimi i subjektit:

5. Zëri i punimeve 4. Prishje strukture betoni. Nga përllogaritjet e auditimit del që janë prishur vetëm 11.4 m^3, gjë e cila nuk rezulton ashtu sepse ju keni përllogaritur strukturën që është tani, që është ndërtuar e re. Në fakt, struktura e mëparshme nuk ka patur këto dimensione. Trashësia nuk ka qenë 0.05 m, por 0.08 m. Nga përllogaritjet e prishjeve të lugjeve rezulton si me poshtë: 102*1.4*0.08=11.4, por lugjet kishin dhe strukturat mbajtëse të cilat kishin shkarë dhe u prishën dhe u zhvendosën 102*0.4*0.7=24.48. Në piketën Nr 17-21 kemi prishje strukture betoni ku ka patur shkarje te kanalit dhe ne prishëm strukturën e vjetër të kanalit 32*(0.4+0.6+0.6)*0.07=3.584 m^3. Gjithë prishja e struktures së betonit është 39.38 m^3, sipas situacionit. Pra pretendimi i auditimit për prishjen e strukturës së betonit nuk qëndron.

Opinioni i grupit të auditimit:

5. Grupi i auditimit, merr në konsideratë argumentimin e ardhur nëpërmjet observacionit.

Pretendimi i subjektit:

6. Zëri i punimeve Nr 10. F.V tub celiku Dj 355.6x6.3mm kg/ml L=204ml. Në piketën 17-21 janë 50 ml tub celiku Dj355.6x6.3mm. Në piketën 24-25, jane 46 ml tub celiku Dj355.6x6.3. Në tubacionin shkarkues për të lidhur tubacionin e shkarkimit me dhomën e grumbullimit është vendosur tub celiku Dj355.6x6.3mm 108 ml. Pra zëri i punimeve është realizuar por në librezën e masave nuk janë pasqyruar simbas piketave.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

6. Grupi i auditimit, ka dalë në konkluzion për këtë diferencë, pas verifikimit në terren, ku nuk është vënë në dijeni nga mbikëqyrësi për tubacionin

shkarkues për të lidhur tubacionin e shkarkimit me dhomën e grumbullimit. Përsa i përket 46 ml në pikëtën 24-25, ky tubacion nuk ekzistonte. Sa sipër, pretendimi merret pjesërisht në konsideratë dhe diferenca e dëmit do të reflektohet në vlerën totale të dëmit ekonomik.

7.Zëri i punimeve ,50x60 HD -4m. Ky zë punimesh është rea tokë të shpërndara, ne i riparuam. Një pjësë atë vit edhe u vadit. Zëri i punimeve nuk ësh 200-300,50x60 HD -4m, duke u konsultuar montim lugje nuk eshte furnizim vendosje

I

mit:
nalizoi dokumentacionin (fotot), e merr dhe diferenca e dëmit do ë dëmit ekonomik.

Vlera prej 393,306 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Tepelenë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. R. N. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. I. S. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;
3. Z. G. Sh., z. M. Sh. dhe znj.B. Xh., në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve.

II. "*Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit), Bashkia Tepelenë*"

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1185/4 prot., datë 06.11.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë, të përfaqësuar nga Titullari z. T. P. dhe sipërmarrësit të punimeve ñSh.ò Sh.P.K., me përfaqësues Y. B., me licencë profesionale NZ 3580/17. Vlera e kontratës është 20,899,027 lekë me T.V.Sh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 90 ditë kalendarike, nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1185/6, datë 10.11.2020, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me A. Sh.P.K., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK 2892 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 520,734 lekë me T.V.Sh.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është caktuar OE ñG.ò, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2928/8. Në dosje nuk administrohet kontratë për shërbimin e kolaudimit. Kjo kontratë nuk na u vu në dispozicion as gjatë auditimit në terren, as në periudhën e hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Titullari i Autoritetit Kontraktorz. T. P..
Projektpreventivi
- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje leje ndërtimi/leje infrastrukturore/deklaratë paraprake e kryerjes së punimeve. *Përsa sipër ngarkohet me përgjegjësi, Titullari i Autoritetit Kontraktor*.
- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria ñR.ò Sh.P.K. në Korrik 2020.
Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 11.11.2020 dhe kanë përfunduar me datë 15.12.2020, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.
- Në dosjen teknike administrohet preventivi i ndryshuar, i nënshkruar nga TAK, por i pashoqëruar me relacionin teknik përkatës nga mbikëqyrësi i punimeve, ku të shpjegohej arsyeja e ndryshimit të volumeve.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "*Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit), Bashkia Tepelenë*"				
14.Lidhja e kontratës nr. 1185/4 prot., datë 06.11.2020	**15.Vlera e kontratës (me T.V.Sh.)** 20,899,027 lekë **BOE fitues "Sh." Sh.P.K.**		**16.Likuiduar deri dt 27.04.2021** **20,899,026 lekë**	
17- Situacioni Përfundimtar dt 16.02.2019 **-Vlera me T.V.Sh. 20,899,027 lekë** **-Vlera pa T.V.Sh. 17,415,856 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 34 ditë. Fillimi punimeve: 11.11.2020 Perfundimi punimeve : 15.12.2020		**19. Zgjatja e kontratës** Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve ñA.ò Sh.P.K.	Licenca Nr: MK 2892	Kontrata nr. 1185/6, datë 10.11.2020	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve OE ñG.ò Sh.P.K.	Licenca Nr: MK 2928/8	Kontrata mungon	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 20.12.2020	**23.Akt i marrjes në dorëzim** dt 28.12.2020		**24**. Fletë Hyrja nr. ... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës

të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **141,651 lekë pa T.V.Sh.**

Titulli i gjetjes: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin ñ*Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit), Bashkia Tepelenë*ò, nga zbatuesi i punimeve ñSh.ò Sh.P.K., për kapitullin I, zërat e punimeve 5, 14. Punime të kryera pa ekonomicitet, në lidhje me heqjen e tubit të amortizuar.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës ñ*Beton C 12/15 për muret e pusetave në hyrje dhe dalje*ò, ñ*FV + tub çeliku 6 x 6.3 mm L=116 m, kg/ml 102, ujëlëshuesi*ò, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñ*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*ò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñ*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*ò e konkretisht Kreu II, Pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1185/4 prot., datë 06.11.2020, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1185/6, datë 10.11.2020; Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Tepelenë në vlerën prej 141,651 lekë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 141,651 lekë pa T.V.Sh. nga ñSh.ò Sh.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1185/4 prot., datë 06.11.2020 me ñ*Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit), Bashkia Tepelenë,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Proejktraportit të Auditmit, me shkresën nr. 517/17 prot, datë 28.05.2021, protokolluar në KLSH me nr. 102/22 prot., datë 31.05.2021 është observuar nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria ñA.ò Sh.P.K. dhe kolaudatori i punimeve ñG.ò Sh.P.K. Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. *Në zërin Nr 5. Beton C-12/15 për muret e pusetave në hyrje dhe dalje.*

*Në akt kostatim jane marrë të mirëqena vetëm betonimet në hyrje të pusetës që janë 18 m^3. Betonimet në dalje të pusetës janë quajtur betonimet që izolojnë tubacionin e celikut 609.6 që është vendosur për vaditjen, pra janë muret prej betoni që të mos lejojnë filtrimet nga tubi i celikut. Muri i betonit nr 1: (4*3*2*0.4=9.6) muri i betonit numer 1 per izolimin e tubacionin te celikut Muri i betonit nr 2 (2*2*2*0.4=3) Muri Nr 3 (2*3*2*0.4)=5 shuma e betoneve eshte 17.4 m3 të cilat po jua ilustrojme dhe me foto për çdo mur betoni. Interpretimi në librezën e masave është i gabuar. Pra ky zë është realizuar me 32 m^3.*

Opinioni i grupit të auditimit:

1. Kjo gjetje, siç është cituar edhe në aktkonstatim, është e bazuar në librin e masave. Volumet janë

për pusetën e daljes që ishte ekzistuese. Gjithashtu, këmishimi i tubacionit është zë më vete në librin e masave. Përsa sipër, ky pretendim, nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

2. A. Zbrazja e rezervuarit dhe rehabilitimi i ujëlëshuesit.

Zëri 12 FV+cmontim montim tub celiku Dj 609.6x6.3mm L=116 mm kg 102 nivel shkarkimi te rezervuari.

Duke parë akt kostatimin e auditimit dhe përllogaritjet e bëra prej tij ka një "keqkuptim", i cili ka sjell një interpretim të këtij zëri, nisur nga përshkrimi i bërë në situacion, përshkrim i cili nuk përputhet me vet projektin. Në fakt, ky zë pune ka të bëjë vetëm me çmontimin e tubit ekzistues dhe largimin e tij pasi ky tub ishte totalisht jashtë funksioni, pasi ishte i dëmtuar nga ndryshkja, i bllokuar nga mbetje të ndryshme dheu e bimore. Pra nuk mund të rivendosej dhe ne si mbikqyrës të këtij objekti, kemi arritur në këtë konkluzion, pas takimeve e diskutimeve me investitorin dhe projektuesin. Pra duke parë gjendjen e tij teknike pas perdorimit prej mbi 50 vjet të qendrimit në prani uji e te tjera mbetje që dëmtojnë celikun, ai nuk mund të perdorej, por thjesht u hoq dhe u trasportua. Pra zë pune është realizuar plotesisht e ky tub është cmontuar dhe është larguar nga trupi i digës, pasi nuk mund të qëndronte aty edhe për shkak të rrjedhjeve, që ndoshta mund të aktivizonte në të ardhmen.

Ndaj mbeshtetur në sa më sipër, llogaritjet e bëra nga ju për diferencë në volumet e këtij zëri nuk qëndrojnë.

Opinioni i grupit të auditimit:

2.Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumenteve shoqëruese, e merr në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën totale të dëmit ekonomik.

Pretendimi i subjektit:

3. Në zerin 14 FV + celiku Ø 609 x 6.3mm L = 116 m 102 kg/ml. *Ketu projektuesi ka projektuar dhe preventivuar furnizimin dhe vendosjen e tubacionit të ri prej celiku me gjatësi L = 116 m dhe diameter Ø = 609.6 mm e spesor δ = 6.3 mm. Nga ana jonë këto llogaritje në librez janë bërë 116 ml x 97 kg/ml = 11,252 kg (duke e vlerësuar me peshën e tubit sipas faturës së shitësit (peshë të tubit e mesatarizuar). Teknikisht në mënyrë ideale kjo peshë mund të llogaritej m = l * 2 * π * r * γ = 116 x 2 x 0.3111 x 3.14 x 7850 kg/m^3 = 11,208 kg dhe ka nje diferencë me situacionin prej 44 kg * 153 = 6,732 lekë, pra ka një gabim prej 6,732 lekë të marra më tepër.*

Opinioni i grupit të auditimit:

3. Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të observacionit, e merr në konsideratë , por , nga rillogaritja, sasia e marrë më tepër është 267 kg dhe vlera dëmit të mbetur është 40,851 lekë dhe do të reflektohet në vlerën totale të dëmit ekonomik.

Pretendimi i subjektit:

4. Zëri 20 Shtresë zhavorri nën kalldrëmi. *Simbas akte inspektimit të auditimit, diferenca është 325 m^2. Auditi është nisur nga diferenca midis shtresës së kalldrëmit dhe shtresës së zhavorit. Por shtresa e kalldrëmit nuk shkon deri tek kulla e betonit që është në ujë, shtresa e kalldrëmit fillon me fillimin e pjerrësisë. Në rast se nuk do hidhej shtresa e zhavorrit, nuk mund të punohej në pastrimin e kulleës sepse te mbyste lluca. Në fakt është bërë shumë herë më shumë nga ajo që është pasqyruar në librezë. Po jua paraqesim të ilustruar me foto.*

Opinioni i grupit të auditimit:

4. Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumenteve shoqëruese, këtë pretendim e merr në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

5. Zëri 22 FV Fv.gjeogrid TX 160 Tensar ose I ngjashem*simbas auditimit është 2124 ose 476 m^2 me pak*

shtresë.
Libreza e masave është bërë simbas matjeve faktike ndërsa kontrolli nga ana e auditimit është bërë simbas prerjes tërthore të projektuesit, gjë që tregon se është bërë duke mos ditur formën reale të kësaj siperfaqeje, e cila nuk mund të jetë e dukshme në një prerje terthore të projektuesit. Për më tepër që objekti nuk është ndërtim i ri. Duhet të theksohet se këtu në këtë objekt ka patur ndryshime të volumeve dhe si rezultat edhe në këtë zë, ka ndryshim volume. Duhet të merret matja faktike e bërë nga sipërmarrës+mbikqyrës, e jo llogaritjet teorike. Pra diferenca 395085 nuk qëndron.

Opinioni i Grupit të auditimit:
5. Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumenteve shoqëruese, e merr në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën totale të dëmit ekonomik.
Pretendimi i subjektit:
6. Zëri 3, Beton C12/15 për veshjen e shkarkuesit*simbas auditimit puna e realizuar është 14.4 m^3. Ky zë punimesh është realizuar në veshjen e tubacionit si dhe në betonimin perreth pusetës së marrjes se ujit. Vëllimi i betonimit përreth pusetës së marrjes së ujit është 17*0.05*28 = 23m^3 veshjen e tubacionit 20*1.881*0.5 = 18.81 m^3, 96*1.881*0.35=63.2 m^3 të pusit të shuarjes shtresa poshtë 6*4*0.2=4.8m^3 shuma totale për këtë zë është realizuar 110.61 m^3. Këtë po jua realizojmë dhe me fotot të cilat po ua bashkëngjisim këtij observacioni.*

17	28	0.05	23.80
20	1.881	0.5	18.81
96	1.881	0.35	63.20
6	4	0.2	4.80
			110.61

Për sa më sipër kundërshtojme argumentimet dhe rekomandimin për dëm ekonomik të Akt konstatimit për këtë objekt.
Opinioni i grupit të auditimit:
6. Grupi i auditimit e ka nxjerrë këtë diferencë volumi në bazë të librit të masave të administruar në dosjen teknike. Pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumenteve shoqëruese, e merr në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën totale të dëmit ekonomik**.**

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 141,651 lekë pa T.V.Sh.**sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. E. M. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. G. S. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

3. Z. G. Sh., z. M. Sh. dhe znj.B. Xh., në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve.

2.5. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

2.5.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve

KLSH ka dërguar në Bashkinë Tepelenë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 610/55 Prot., datë. 04.12.2020, ndërsa nga Bashkia Tepelenë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 1944/2 prot, datë 21.12.2020, për njohjen dhe pranimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve. Bashkëlidhur kësaj shkrese gjendet Urdhëri nr. 125, me nr. 1944/1 Prot., datë 10.12.2020, i Kryetarit të Bashkisë Tepelenë ñ*Për zbatim të detyrave të rekomanduara*ò, ku janë përcaktuar personat të cilët do të merren me trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së dhe masat që duhet të merren për zbatimin e tyre, deri në ndjekjen në rrugë gjyqësore.
Rekomandimet janë raportuar në Këshillin Bashkiak dhe në VKB-në nr. 14, datë 26.02.2021, me nr. 408/3 Prot., datë 01.03.2021, ñ*Për miratimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit për vitin 2020*ò, në pikën I, germa c) është përfshirë edhe raporti mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. Vendimi është miratuar nga Prefektura Gjirokastër me shkresën nr. 226/1, datë 10.03.2021.
Me shkresën nr. 1944, datë 30.12.2020, iu janë ridërguar shkresat përkatëse të gjithë personave të cilët janë atakuar nga rekomandimet e KLSH-së, për zbatimin e masave të lëna, konkretisht 54 subjekteve, ku është lënë afati i arkëtimit të detyrimeve deri në datën 31.03.2021, në të kundërt do të fillojë rruga ligjore.
Sa më sipër, rezulton se nga Bashkia Tepelenë ka zbatuar kërkesat e germës ñjò të nenit 15 ñ*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*ò, të ligjit nr. 154/2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të shtetit*ò, për caktimin e personave përgjegjës dhe ka respektuar afatin 20 ditor për noftimin e KLSH-së në lidhje me vendosjen e afateve kohore për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

2.5.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

Duke qenë se nuk është mbushur periudha 6 mujore për të verifikuar ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor, meqenëse kanë filluar të gjitha procedurat për zbatimin e rekomandimeve të rikërkuara (përfshirë planet e zbatimit dhe shkresat e ridërguara subjekteve/personave debitorë), kjo pikë e kërkesave të programit konsiderohet e realizuar.

2.5.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Titulli i Gjetjes: Zbatimi i Rekomandimeve, sipas cilësimeve në plan veprimin e hartuar nga drejtuesit e subjektit të audituar.
Situata:Në mbështetje të germave a) dhe b) të nenit 15 ñ*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*ò, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit*ò, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Vendimin nr. 128, datë 24.11.2020, ka vendosur rikërkimin e zbatimit të rekomandimeve, për masat e mëposhtme, të cilat kanë qenë të pazbatuara në momentin e auditimit, të paraqitura më poshtë sipas natyrës.
Aktualisht, me Urdhërin nr. 125 dhe nr. 1944/1 Prot., datë 10.12.2020, nga kryetari i Bashkisë Tepelenë është janë caktuar personat të cilët do të merren me problemin e vjeljes së arkëtimeve dhe janë caktuar afatet përfundimtare për të filluar kërkimin në rrugë gjyqësore.

Gjatë auditimit rezultoi se bashkia Tepelenë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH *me shkresën nr. 610/55 Prot., datë. 04.12.2020,* konstatohet se disa nga masat nuk janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, si më poshtë vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Tepelenë nuk ka ngritur si duhet një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, përfshirë këtu edhe mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave elektronike (sistem rezervë back-up), rregulla për dorëzimin e detyrës në rastet e largimit të punonjësve nga puna, nuk është hartuar regjistri i riskut, lista e proceseve të punës, gjurma e auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori. Në fund të çdo viti vlerësimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk është bërë si duhet nga menaxherët kryesor, duke mos përcaktuar pikat e dobëta të këtij sistemi e marrjen e masave për përmirësimin e tij. Nga stafi nuk njihet mjaftueshëm ligji 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, si dhe manuali përkatës në zbatim të këtij ligji.

Njësia e auditimit të brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si prokurimet publike, ngritja, implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe efektiviteti i këtij sistemi, inspektorati i mbrojtjes së teritorit, asetet. Gjithashtu nga kjo njësi, në auditimin e kryer prej saj, nuk është bërë ndjekja e rekomandimeve pas 6 muajsh, sipas afatit të përcaktuar në manualin e auditimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, kërkesat e nenit nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit 114/2015, datë 22.10.2015 ñ*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*ò.

1.1. Rekomandim: Titullari i njësisë vendore, njësia e auditimit të brendshëm dhe menaxherët kryesor të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë edhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik, duke siguruar sisteme rezervë të IT (back-up). Të hartohet regjistri i riskut, gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës për secilin sektor dhe në nivel institucioni.

1.2. Rekomandim: Nga njësia e auditimit të brendshëm të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, duke i dhenë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Të ndiqet zbatimi brenda afateve të caktuara, i rekomandimeve të dhëna nga KLSH si dhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga vetë njësia e auditimit të brendshëm.

1.3. Nga verifikimi rezultoi se: *Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar është hartuar plani i veprimit për zbatimin e detyrave të rekomanduara nga KLSH-se, në funksion të së cilit janë nxjerrë edhe urdhrat e mëposhtëm:*

1. Urdhër nr. 5, datë 22.01.2020 "Për caktimin e personave përgjegjës për administrimin e dosjeve të projekteve dhe investimeve publike";

2. Urdhër nr. 6, datë 22.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale";

3. Urdhër nr. 7, datë 22.01.2020 "Për ngritjen e grupit te punës për ndjekjen, zbatimin dhe marrjen ne dorëzim të punimeve e shërbimeve";

4. Urdhër nr. 8, datë 22.01.2020 "Për gjurmën, standardet e prokurimit me vlerë më të vogël se 800 mijë lekë pa T.V.Sh.";

5. Urdhër nr. 9, datë 22.01.2020 "Për caktimin e personave përgjegjës për administrimin dhe dokumentimin e konsumit të karburantit";

6. Urdhër nr. 10, datë 22.01.2020 "Për menaxhimin e aktiveve";

7. Urdhër nr. 31, datë 20.02.2020 i Drejtorit të Drejtorisë "Për përmirësimin e nivelit të

punës në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit".

Në Proces

3. Gjetje nga auditimi: Vlera e faturave të pa likuiduara në 30.09.2019 është **48,674,646 lekë**, nga të cilat detyrime për investime në vlerën 12,220,490 lekë, në 13 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 32,435,561 lekë, në 33 raste; detyrime për vendimet gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 4,018,595 lekë, për 5 raste.
Vlera 48,674,646 lekë është e trashëguar sipas periudhave si më poshtë:
Vlera 9,026,517 e mbartur nga periudha para vitit 2017;
Vlera 6,242,576 është e krijuar gjatë vitit 2017;
Vlera 19,417,869 lekë është e krijuar gjatë vitit 2018;
Vlera 13,987,684 lekë është krijuar gjatë vitit 2019.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.*SH.ò, i ndryshuar, neni 40 ñ*E drejta për të kryer shpenzime*ò; UMF nr. 5, datë 27.02.2014 ñ*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*ò ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014; Udhëzimin plotësues nr. 2 të MF, datë 10.01.2018 ñ*Për buxhetin e vitit 2018*ò, pikat 82-91 ñ*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*ò; UMF nr. 22, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore*ò.
3.1. Rekomandim: Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, bazuar në Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 ñ*Për buxhetin e vitit 2018*ò, pikat 82-91 ñ*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*ò dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 ñ*Për buxhetin e vitit 2019*ò, pikat 106-110, ñ*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*ò dhe pikat 116-117, ñ*Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore*ò, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën 48,674,646 lekë, sipas aneksit bashkangjitur mbi gjendjen e faturave të pa likuiduara me datën 30.09.2019.
3.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Ky rekomandim do të konsiderohet në proces pasi Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria Ligjore ka paraqitur raportin e detyrimeve të prapambetura në Këshillin Bashkiak së bashku me grafikun e shlyerjes së detyrimeve konfirmuar sipas VKB nr. 90, Datë 20.12.2019 dhe VKB nr. 89, datë 20.12.2019 "Mbi miratimin e buxhetit afatmesëm2020-2022".*

Në Proçes

7. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar, llogaria 210 ñ*Toka, troje, terrene*ò dhe llogaria nr. 211 ñ*Pyje, kullota, plantacione*ò, nuk paraqesin vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, për shkak të mos marrjes së masave për rregjstrimin në ZVRPP të pasurive ekzistuese dhe të atyre të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Tepelenë.Në vitin 2018 llogaria 210 ñ*Toka, troje, terrene*ò ka vlerën 7,778,488 lekë dhe përbëhet nga vlera 250,910 lekë për parqe dhe lulishte, vlera 2,879,803 lekë për rehabilitim ambiente publike, vlera 3,279,917 lekë për sistemime të ambienteve publike, vlera 1,367,858 lekë për kënde lojërash për fëmijë. Llogaria nr. 211 ñ*Pyje, kullota, plantacione*ò në fund të vitit 2018 ka vlerën 96,200 lekë dhe paraqet vlerën e pemëve dekorative.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò, neni 15, pika 1 dhe 2, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò, kapitulli IV, pika 74 dhe 96 dhe të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò.

7.1. Rekomandim: Titullari i njësisë vendore,Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 210 ñ*Toka, Troje, Terrene*ò dhe llogarisë nr. 211 ñ*Pyje, kullota, plantacione*ò, duke bërë që në këto llogari të paraqitet vlera e saktë e pasurisë së njësisë vendore. Të inventarizohen këto prona, duke krijuar regjistrin e aktiveve me të gjitha të dhënat e nevojshme (vendndodhje, sipërfaqja etj.). Të merren masa për rregjistrimin e këtyre aseteve në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës.

7.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit e Financës me veprimin nr. 5 sipas ditarit të veprimeve të ndryshme dhjetor 2019 ka bërë sistemimi i llog, 210 "Toka, Troje, Terrene" dhe llog, nr. 211 "Pyje, kullota, plantacione", e konfirmuar me shkresën nr. 407 prot datë 27.02.2020 për mbyllja e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2019. Gjithashtu sipas urdhrit nr. 12 datë 14.02.2019 të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë "Për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin dhe pozicionimin e pasurive të paluajtshme të kërkuara për regjistrim në ZVRPP Tepelenë"; dhe Urdhrit nr. 48 datë 10.07.2019 "Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin faktik të tokave bujqësor të zotëruara nga familjet bujqësore", grupi i punës ka bërë vlerësimin e pronave të dhëna me qira dhe po vazhdohet me për rregjistrimin në ASHK të pasurive të evidentuara.*

Në proçes

8. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar, gjendja e llogarisë 431 ñ*Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa*ò, në 31.12.2018 paraqitet në vlerën 3,255,400 lekë, e cila përfaqëson detyrime të pa paguara të bashkisë ndaj buxhetit të shtetit për tatimin mbi pagë të personelit, e analizuar si më poshtë:

- vlera 351,466 lekë, dhjetor viti 2018;
- vlera 1,283,450 lekë, janar-dhjetor viti 2013 (pjesërisht);
- vlera 917,708 lekë, janar-dhjetor viti 2012 (pjesërisht);
- vlera 562,436 lekë, mars-dhjetor viti 2011 (pjesërisht);
- vlera 140,340 lekë, gusht-nëntor viti 2010. (pjesërisht).

Vlera 3,255,400 lekë nuk është analizuar sipas klasifikimit kontabël përkatësisht: -detyrime të vitit në vazhdim 2018 në vlerën 351,466 lekë, -detyrime të viteve të mëparshme për vitet 2010-2013 në vlerën 2,903,934 lekë, të trashëguara dhe të pa derdhura në llogari të buxhetit të shtetit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar ñ*Për mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë*ò, neni 6, ñ*Detyrimet e personave qe paguajnë kontributet*ò, neni 11, ñ*Afatet e deklarimit dhe të pagesës*ò; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñ*Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*ò; pika 1, ñ*Përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*ò, me cilësinë e sistemit kontabël të përgjithshëm, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, standardet dhe rregullat kontabël, kapitulli IV, llogaritë e të tretëve, klasa 4.

8.1. Rekomandim: Titullari i njësisë vendore dhe Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrin masa të menjëhershme për pagesën e detyrimeve të prapambetura në vlerën 3,255,400 lekë për tatimin mbi pagë të personelit, si dhe për zbatimin e procedurave ligjore për klasifikimin kontabël të llogarisë 431 ñ*Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa*ò.

8.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Janë bërë pagesat në vlerën totale 3,393,634 lekë. Në mbyllje të pasyrave financiare të vitit 2020, gjendja e llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa", paraqitet në vlerën 359,296 lekë, e cila përfaqëson vlerën e detyrimit të muajit dhjetor 2020, që si rregull paguhet gjatë muajit janar të vitit pasardhës.*

E zbatuar

Shlyerja e detyrimeve të prapambetura për TAP është paraqitur në anekse, pasqyra nr. 2.5.1.

11. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), nëpërmjet njësisë vendore, konstatohet se numri i subjekteve të regjistruara në QKB dhe me status aktiv, që zhvillojnë aktivitet në teritorin e Bashkisë Tepelenë, është 619, nga të cilat 155 subjekte të kategorisë person juridik dhe 464 subjekte të kategorisë person fizik. Por nga dokumentacioni që u paraqit nga zyra e taksave dhe tarifave vendore, konstatohet se numri i subjekteve të regjistruara në njësinë vendore, për të cilat llogariten taksa dhe tarifa, është 412, nga të cilat 87 subjekte të kategorisë person juridik dhe 325 subjekte të kategorisë person fizik, pra 207 subjekte më pak. Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore jepen shpjegime se diferenca vjen si rezultat i mbylljes së këtyre subjekteve dhe mos kryerjes prej tyre të deklarimeve dhe azhurnimeve në organet tatimore dhe QKB. Ky mos rakordim nuk jep siguri se numri i bizneseve të regjistruar në njësinë vendore për pagesën e taksave dhe tarifeve vendore është i saktë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 40, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, neni 40 ñ*Regjistrimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jo tregtare*ò, pika 4 ñ*Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit*ò shërben njëkohësisht si regjistrim në administratën tatimore.

<u>11.1. Rekomandim:</u>Me qëllim evidentimin e saktë të numrit të bizneseve që kryejnë aktivitet në Bashkinë Tepelenë, drejtoria ekonomike, zyra e taksave dhe tarifave vendore, të verifikojnë në terren numrin e bizneseve faktik që ushtrojnë aktivitet, si dhe të bashkëpunojnë me drejtorinë rajonale Tatimore Gjirokastër dhe QKB për të evidentuar subjektet e mbyllura, që nuk ushtrojnë aktivitet e nuk kanë bërë deklarim për këtë qëllim. Në fund të verifikimeve dhe rakordimeve të bëhen ndryshimet e nevojshme në regjistrin e taksapaguesve privat në Bashkinë Tepelenë. Çdo ndryshim të justifikohet me dokumentacion përkatës.

<u>11.2. Nga verifikimi rezultoi se:</u> *Nga sektori i taksave dhe tarifave vendore me shkresën nr. 379 prot date 28.02.2020 është njoftuar Drejtoria Rajonale Tatimeve Gjirokastër dhe Qendrën Kombëtare të Licencimit.*

Në Proçes

13. Gjetje nga auditimi: Bashkia Tepelenë është audituar nga KLSH në vitin 2016 dhe në vijim është bërë verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara në Bashkinë Tepelenë nga KLSH. Me shkresën nr. 1113/122, datë 1153/40 është rikërkuar zbatimi i masave të pa zbatuara. Për përmirësimin e gjendjes janë rikërkuar 11 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 11 masa, të cilat janë zbatuar.

Nga 25 masa për shpërblim dëmi, në vlerën 63,988,000 lekë, të cilat janë pranuar dhe kontabilizuar, deri me datë 30.09.2019 janë arkëtuar 1,619,316 lekë, ndërsa shuma 62,368,684 lekë nuk është arkëtuar.

Nga 25 masat e mësipërme, për 19 prej tyre në vlerën 9,106,270 lekë janë nxjerrë urdhrat e titullarit për zbatim, por nuk janë kryer veprime të mëtejshme për arkëtim, 5 masa për shpërblim dëmi në vlerën 46,209,883 lekë janë në proces gjyqësor dhe 1 masë shpërblim dëmi në vlerën 5,917,096 lekë, që i përket arkëtimit për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, nga njësia vendore janë nxjerrë urdhrat e bllokimit për llogaritë bankare, hipotekë dhe drejtorinë e transportit rrugor, por ende e pa arkëtuar.

- Për 11 masa administrative, nuk janë zbatuar penalitetet e vendosura nga APP mbi shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve në vlerën totale prej 1,900,000 lekë.
- Në lidhje me njoftimin e Komisionit të Licencave, pranë Ministrisë të Zhvillimit Urban për heqjen e liçensave për dy subjekte: -R. S. (në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës ñI.ò Sh.P.K.; - Ing. Gj. M. (në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve), nuk është bërë njoftimi nga ana e IMTV.

<u>13.1. Rekomandim:</u> Nga Kryetari i Bashkia Tepelenë, drejtoria juridike dhe ekonomike të

merren masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Për këtë të ndiqen të gjitha rrugët e mundshme ligjore deri në hapjen e proceseve gjyqësore. Nga titullari të hartohet një plan veprimi dhe të caktohen personat përgjegjës për zbatimin e tij. Të njoftohet KLSH për masat e marra.

13.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Me urdhrin nr. 14, datë 16/01/2020 është miratuar "Plani i zbatimin e detyrave të rekomanduara nga KLSH-ja". Gjendja e rekomandimeve paraqitet si më poshtë:*

Për masa shpërblim dëmi, Vlera 62,368,684 lekë do të konsiderohet në proces pasi drejtoria e financës ka bërë kontabilizimin e detyrimit në llog. 468 "Debitor të Ndryshëm", si dhe me shkresën nr. 121 prot datë 28.01.2020 ka kërkuar informacion mbi vijimin e procedurave penale për Operatorët Ekonomik.

Për masat administrative në vlerën totale prej 1,900,000 lekë. Nuk janë kontabilizuar në llogarinë 423-429 personeli, deficite dhe gjoba.

- Në lidhje me njoftimin e Komisionit të Licencave, pranë Ministrisë të Zhvillimit Urban për heqjen e liçensave për dy subjekte: -R. S. (në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës "I." Sh.P.K.; - Ing. Gj. M. (në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve), nuk është bërë njoftimi nga ana e IMTV. Masë e pa zbatuar.

Në Proçes

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò neni 15 germa b) dhe c) ñ*Të drejtat e KLSH-së*ò dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 ñ*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*ò, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò dhe pikën 93 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò, nga Titullari i Njësisë Publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 1,281,616lekë, si më poshtë:

Deri në datën 21.05.2021 ka mbetur pa u arkëtuar vlera prej 1,281,616 lekë, për subjektin A.Sh.P.K., për dy investime, për të cilat janë rinisur njoftimet për 2 rekomandimet por ende skanë filluar arkëtimet 1,281,616 lekë. Sa më sipër është caktuar data përfundimtare për fillimin e procedurave gjyqësore.

Në mënyrë tabelore rekomandimet, arkëtimet dhe natyra e rasteve të mosrealizimit janë paraqitur në anekse, pasqyra nr. 2.5.2.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatin Luzat NjA Qendër", Bashkia Tepelenë,* me vlerë të kontratës bazë 8,686,074 lekë me T.V.Sh. dhe shtesës së kontratës me vlerë 1,736,979 lekë me T.V.Sh., shpallur fitues operatori ekonomikë (OE) ñA.ò Sh.P.K., rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: ñ*Germim shkëmbi*ò; ñ*Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krahë, me seksion 0.75 m*^{2}ò; ñ*Germim tokë e zakonshme*ò; ñ*Mure betoni C 12/15*ò dhe ñ*Hidroizolim tubacion dy duar bitum*ò të kontratës bazë dhe zëri ñ*Veshje me beton C 16/20*ò që i përket shtesës së kontratës, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **825,098 lekë pa T.V.Sh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën bazë me nr. 46/1 Prot, datë 06.04.2017 dhe shtesës së kontratës me nr. 46/2 Prot, datë 07.06.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tepelenë dhe sipërmarrësit Operatorit Ekonomikë ñA.ò Sh.P.K.

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **825,098 lekë pa T.V.Sh.**nga OE ñA.ò Sh.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit të kontratën bazë

me nr. 46/1 Prot., datë 06.04.2017 dhe shtesës së kontratës me nr. 46/2 Prot., datë 07.06.2017, për kryerjen e punimeve me objekt ñ*Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatin Luzat NjA Qender*ò, Bashkia Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

2.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Tepelenë me shkresën nr. 149 date 28.01.2020, ka njoftuar OE* ñA.ò *Sh.P.K., për detyrimin e konstatuar nga KLSH-ja duke i kërkuar likuidimin vullnetar të detyrimit duke i nisur edhe faturën për arkëtim. Deri në datën e verifikimit 10.07.2020, nuk është kryer ndalesa ndaj OE "A." Sh.P.K.*

Në Proçes

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikonstruksion i qendrës së fshatit Veliqot", Bashkia Tepelenë,* me vlerë të kontratës 4,657,095 shpallur fitues operatori ekonomikë ñA.ò Sh.P.K., rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: ñ*Prishje shtresash*ò; ñ*Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m*^{2}ò; ñ*Shtresë binderi me granil gur kave 6 cm me makineri*ò; ñ*Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave, 4 cm, me makineri*ò, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **456,518 lekë pa T.V.Sh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën bazë me nr. 77/3 Prot, datë 13.06.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tepelenë dhe sipërmarrësit Operatorit Ekonomikë ñA.ò Sh.P.K.

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **456,518** lekë pa T.V.Sh. nga Operatori Ekonomik ñA.ò Sh.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 77/3 Prot, datë 13.06.2017 me objekt ñ*Rikonstruksion i qendrës së fshatit Veliqot*ò, Bashkia Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

3.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Tepelenë me shkresën nr. 149 date 28.01.2020, ka njoftuar OE* ñA.ò *Sh.P.K., për detyrimin e konstatuar nga KLSH-ja duke i kërkuar likuidimin vullnetar të detyrimit duke i nisur edhe faturën për arkëtim. Deri në datën e verifikimit 10.07.2020, nuk është kryer ndalesa ndaj OE "A." Sh.P.K.*

Në Proçes

B.1. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Tepelenë për periudhën objekt auditimi ka administruar për zbatim 7 vendime gjyqësore të formës së prerë (të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit) në vlerën 6,270,288 lekë, efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore. Nga vendimet e mësipërme tre raste janë për ñ*Dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna*ò, në vlerën 2,812,560 lekë, katër raste për ñ*detyrim kontrate*ò në vlerën 3,454,728 lekë, janë shtuar gjatë periudhës vlera 3,369,415 lekë, janë zbatuar (likuiduar) në vlerën 5,621,108 lekë, përkatësisht në vitin 2017 vlera 2,173,493 lekë, në vitin 2018 vlera 2,977,615 lekë dhe në vitin 2019 vlera 470,000 lekë, pra efekti real si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore për periudhën janar 2017 ï shtator 2019 është **5,621,108 lekë, efekt negativ financiar për buxhetin e njësisë vendore**. Mbeten për likuidim të mëtejshëm në buxhetin e vitit 2019, e në vijim vlera 4,018,595 lekë, zbatimi i vendimeve të mësipërme do të rëndoj shpenzimet e viteve në vazhdim. Përpara zbatimit të vendimeve gjyqësore nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me pikën 62 të UMFnr. 2, datë 06.02.2012 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò.

1.1. Rekomandim: Titullar i njësisë vendore të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore, të nxjerr arsyet dhe përgjegjësitë për efektin negativ që këto vendime kanë dhënë në buxhetin e njësisë vendore, ndërsa sektori juridik të ndjek proceset në të gjitha shkallët e gjykimit, duke bërë edhe rekurs. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit dhe të

pagesave të duhura, me qëllim që të ulen risqet e humbjes së proceseve gjyqësore. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor Titullari të nxjerrë përgjegjësitë administrative, si dhe aktin që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

1.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Kryesisht, këto vendime gjyqësore kanë qenë të prapametura nga periudhat para konsolidimit të pushtetit vendor dhe rrjedhimisht është e pamundur të bëhet analiza për të nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë për efektin negativ që këto vendime kanë dhënë në buxhetin e njësisë vendore. Gjithashtu, janë në proces dhe drejt përfundimit pagesat për këto vendime. Vlera vjetore e buxhetuar për këtë qëllim është 1,500 mijë lekë.*

Në Proces

B.2. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga puna e pamjaftueshme e Sektorit të Taksave dhe Tarifave VendorenëBashkinë Tepelenë, në fund të vitit 2019 janë krijuar debitorë për taksat dhe tarifat vendore në vlerën totale **12,618,921 lekë**. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 11,263,917 lekë nga subjektet private (principal 9,410,242 lekë, kamatëvonesë 1,826,675 lekë), si dhe detyrimi prej 1,355,004 lekë nga 953 subjekte familjare, sipas rakordimit që njësia vendore ka me ñ*Ujësjellësin Tepelenë*ò SHA. Vlera debitore e taksapaguesve privat është e ndarë si më poshtë:

- për vitin 2017 vlera e debisë 2,739,025 lekë, nga e cila principali 2,212,959 lekë, kamat vonesa 526,066 lekë, numri subjekteve debitor 112, nga të cilat 16 subjekte biznes i madh dhe 96 subjekte biznes i vogël;
- për vitin 2018 vlera e debisë 3,987,683, nga e cila principali 3,268,040 lekë, kamatëvonesa 719,643 lekë, numri subjekteve debitorë 143 nga të cilat 31 subjekte biznes i madh dhe 112 subjekte biznes i vogël;
- për vitin 2019 vlera e debisë është 4,537,209 lekë, nga e cila principali 3,722,074 lekë, kamatëvonesa 815,135 lekë, numri subjekteve debitor 205, nga të cilat 32 subjekte biznesi i madh dhe 173 subjekte biznesi i vogël.

Nga zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore, për arkëtimin e debitorëve veprim në kundërshtim me nenet 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, nenet 91, të ligjit nr. 9920 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI ñ*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore*ò.

1.1. Rekomandim: Drejtoria ekonomike, zyra e taksave dhe tarifave vendore, bazuar në nenin 70 pika 3 ñ*E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor*ò, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, *për të gjitha subjektet e private* për vlerën e detyrimit prej **11,263,917 lekë** të nxjerrë njoftim vlerësimet tatimore dhe në vazhdim të marren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Tu dërgohen të gjitha bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

b- Tu dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, si dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, kërkesat për vendosjen e barrës siguruese respektivisht për mjetet dhe për pasuritë e paluajtshme, bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò.

c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim

penal.
d- Për debitorët e kategorisë familjare bazuar në akt-marrëveshjen e lidhur me ñUjësjellësò ShA, të kërkojë nga kjo e fundit në cilësinë e agjentit tatimor, të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej 1,355,004 lekë nga 953 subjekte familjare.
1.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore është bërë njoftimi për likuidim të detyrimeve të prapambetura të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, në total 218 subjekteve. Nuk janë dërguar urdhër bllokime për llogaritë bankare të subjekteve debitore si dhe nuk është vendosur barra siguruese dhe hipotekore mbi pasurinë e tatim paguesit debitor. Nga auditimi i fundit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH nuk ka pasur ndryshime.*
Nga vlera e rekomanduar nga KLSH për 173 subjekte të biznesit të vogël, 45 subjekte të biznesit të madh dhe 24 subjekte debitorë të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën totale ***1,106,955 lekë,*** *deri më datën 10.07.2020 është arkëtuar shuma prej* ***28,847*** *lekë ose në masën 2.6%, duke mbetur debitorë deri në datën 10.07.2020, në total edhe 21 subjekte subjekte në shumën* ***1,078,108lekë.***

Në Proçes

2. Gjetje nga auditimi: Nga drejtoria e planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit dhe sektori i taksave dhe tarifave vendore, Bashkia Tepelenë, nuk është llogaritur saktë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, me pasojë **të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore në vlerën 7,429,682 lekë.** Kjo vlerë është detyrim nga tre pronarët e lejeve të ndërtimit si më poshtë:
- z. Xh. N. në vlerën 43,920 lekë, leje ndërtimi në vitin 2017;
- z. R. T. në vlerën 782,818 lekë, leje ndërtimi në vitin 2018;
- z. I. H. dhe B. H. në vlerën 6,603,574 lekë leje ndërtimi në vitin 2019.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 ñ*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*ò, të ndryshuar, neni 46, Udhëzimin e KM nr. 4, datë 30.9.2015 ñ*Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2015*ò, Udhëzimin KM nr. 3, datë 28.12.2016, ñ*Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016*ò, VKB nr. 2, datë 20.01.2017, nr. 41, datë 21.12.2017 dhe nr. 74, datë 28.12.2018 ñ*Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Tepelenë*ò.
2.1. Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore, drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, zyra e taksave vendore, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit prej **7,429,682 lekë** nga pronarët e lejeve të ndërtimit si më poshtë:
- z. Xh. N. në vlerën 43,920 lekë;
- z. R. T. në vlerën 782,818 lekë;
- z. I. H. dhe B. H. në vlerën 6,603,574 lekë.

2.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Ky rekomandim do të konsiderohet në proces pasi Bashkia Tepelenë me shkresën nr. 166 prot., datë 28.01.2020 z. Xh. N. për arkëtimin e detyrimit sipas lejeve të ndërtimit të vitit 2017, me shkresën nr. 168 prot., datë 28.01.2020 z. R. T. për arkëtimin e detyrimit sipas lejeve të ndërtimit të vitit 2018 dhe me shkresën nr. 169 prot datë 28.01.2020 z. I. dhe z. B. H. për arkëtimin e detyrimit sipas lejeve të ndërtimit të vitit 2019. Dhe deri në datën 10.072020 të verifikimit nuk është arkëtuar asnjë lekë. Nga auditimi i fundit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH nuk ka pasur ndryshime.*

Në Proçes

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, nga dhënia me qira e aseteve të Bashkisë Tepelenë subjekteve private, të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga ñ*Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes*ò, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e

tyre për qëllime biznesi, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019, u konstatua se:
- Në një rast nuk është lidhur kontratë qiraje me subjektin ñK.ò Sh.P.K. me NIPT K59723510ŭ , pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror, me vendndodhje në fshatin Luzat, Tepelenë, me sipërfaqe 1 (një) ha, me pasojë mos llogaritjen dhe mos arkëtimin e detyrimit në vlerën 1,209,994 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore.
- Në një rast është lidhur kontratë qiraje me subjektin ñC.ò Sh.P.K. me NIPT K02715414M, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror, me vendndodhje në Bënçë, Tepelenë me sipërfaqe 3,3 ha, por nga detyrimi total që rrjedh nga kontrata e lidhur nuk është arkëtuar vlera 3,570,600 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore.
- Në një rast, është lidhur kontratë qiraje nr. 53, datë 11.04.2011, me subjektin ñI.ò Sh.P.K., me objekt dhënie në përdorim nga fondi Pyjor/kullosor një sipërfaqe prej 2,253 ha, për ndërtimin e Hidrocentralit ñBregu i Lerësò, me vendndodhje në fshatin Mezhgoranò, Tepelenë, por nga subjekti nuk është kryer pagesa e plotë e detyrimit në vlerën 185,873 lekë.
Tre rastet e mësipërme i kanë shkaktuar buxhetit të njësisë vendore të ardhura të munguara në vlerën 4,966,467 lekë. Veprimi dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 391, datë 21.06.2006, ñ*Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*ò, i ndryshuar, lidhja nr. 2, pikat 6 dhe 11.
<u>3.1. Rekomandim:</u>Nga titullari i njësisë vendore, drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit në vlerën **4,966,467 lekë**, përkatësisht nga subjektet ñK.ò Sh.P.K. në vlerën 1,209,994 lekë, ñC.ò Sh.P.K. në vlerën 3,570,600 lekë dhe nga ñI.ò Sh.P.K. në vlerën 185,873 lekë.
<u>3.2. Nga verifikimi rezultoi se:</u> *Ky rekomandim do të konsiderohet në proces pasi Bashkia Tepelenë sipas konstatimit të bërë nga KLSH ka bërë njoftimin e subjekteve debitorë si më poshtë:*
- Me shkresën nr. 148 prot date 28.01.2020 ka njoftuar subjekti "Koci" për shlyerjen e detyrimit, dhe deri në datën 10.07.2020 nuk janë kryer veprime të tjera ligjore për kërkimin e detyrimit.
Subjektet I. dhe C. e kanë likuiduar vlerën debitore.

Në Proçes

4. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, në 4 raste nuk ka përllogaritur saktë dhe nuk ka arkëtuar tarifën për dhënien dhe rinovimin e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse (karburante), që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, me pasojë **të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore në vlerën 3,950,000 lekë.** Konkretisht janë subjektet: ñK.ò Sh.P.K., ñO.ò Sh.P.K. ñS.ò Sh.P.K., ñK.ò ShA. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò, i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 ñ*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, "për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kapitulli II, pika 1; germa "b"; pika 9*ò.
<u>4.1. Rekomandim:</u>Nga titullari i njësisë vendore, drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit prej **3,950,000 lekë** për mos rinovimin e licencave nga subjektet e tregtimit të karburanteve si më poshtë:
Subjekti ñK.ò Sh.P.K. në vlerën 950,000 lekë, subjekti ñO.ò Sh.P.K. në vlerën 1,000,000 lekë, subjekti ñS.ò Sh.P.K. në vlerën 1,000,000 lekë, subjekti ñK.ò ShA, në vlerën 1,000,000 lekë.
<u>4.2. Nga verifikimi rezultoi se:</u> *Ky rekomandim do të konsiderohet në proces pasi Bashkia Tepelenë sipas konstatimit të bërë nga KLSH ka bërë njoftimin e subjekteve debitorë si më*

poshtë:
-Me shkresën nr. 142, datë 28.01.2020 është njoftuar subjekti "K." Sh.P.K. për shlyerjen e detyrimit dhe me shkresën nr. 333 prot datë 25.02.2020 është lidhur akt marrëveshje me Bashkinë për likuidimin me këste. Sipas akt marrëveshjes është likuiduar kësti i parë në vlerën 200,000 lekë duke mbetur pa u arkëtuar vlera 800,000 lekë.
-Me shkresën nr. 144, date 28/01/2020, është njoftuar subjekti "O." Sh.P.K., për shlyerjen e detyrimit dhe me shkresën nr. 937 prot datë 24.06.2020 është lidhur akt marrëveshje me Bashkinë për likuidimin me këste të detyrimit.
-Me shkresën nr. 143, date 28/01/2020 është njoftuar subjekti "S." Sh.P.K., për shlyerjen e detyrimit dhe me shkresën nr. 936 prot date 24.06.2020 është lidhur akt marrëveshje me Bashkinë për likuidimin me këste.
-Me shkresën nr. 145, date 28/01/2020, është njoftuar subjekti "K." Sh.P.K. për shlyerjen e detyrimit, dhe sipas postës bankare të datës 17.02.2020 është bërë arkëtimi i vlerës 950,000 lekë.

Në Proçes

5. Gjetje nga auditimi: Nga IMTV për periudhën janar 2017 deri më 30.09.2019 janë vendosur 4 masa administrative me gjobë në vlerën totale 1,900,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 500,000 lekë, ndërsa vlera prej **1,400,000 lekë** është ende e pa arkëtuar, e cila përbën **të ardhura të munguara në buxhetin e njësisë vendore**.
Gjobat e pa arkëtuara janë për z. R. S., me objekt rritje fiktive të çmimeve në vlerën 500,000 lekë, si dhe për subjektin ñ*E.*ò Sh.P.K., në vlerën 100,000 lekë, me objekt prishje e infrastrukturës, subjektin ñ*K."*Sh.P.K. në vlerën 800,000 lekë me objekt ndërtim pa leje. Afati ligjor i pagesë së gjobave (10 ditë) ka përfunduar, por nga njësia vendore nuk është bërë kërkesa në gjykatë për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, me qëllim arkëtimin e gjobave, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 ñ*Për kundërvajtjet administrative*ò, neni 9 ñ*Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative*ò, neni 22 ñ*Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv*ò, neni 24 ñ*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv*ò dhe neni 30 ñ*Arkëtimi i shumave të detyrimeve*ò.
5.1. Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore, drejtoria juridike dhe ekonomike të merren masa për arkëtimin e vlerës 1,400,000 lekë, duke kërkuar pranë organeve përkatëse (përmbarim, gjykatë), kthimin e tre vendimeve për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv.
5.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Ky rekomandim do të konsiderohet në proces pasi Bashkia Tepelenë me shkresën nr. 327, date 17.02.2020, ka njoftuar OE "E." Sh.P.K. për shlyerjen e detyrimit dhe sipas postës bankare të datës 10.05.2020 është bërë arkëtimi i vlerës 100,000 lekë, i cili e ka likuiduar detyrimin. Për dy subjektet e tjera "K." Sh.P.K. dhe z. R. S. edhe pse janë njoftuar për shlyerjen e detyrimit sipas procesverbaleve të gjobës, deri në datën 10.07.2020 nuk kanë paguar detyrimin në vlerën totale 1,300,000 lekë. Edhe pse kanë kaluar 5 muaj nga njoftimi i fundit Bashkia Tepelenë nuk ka nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobës) të përcaktuara në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", përkatësisht: neni 9 "Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative"; neni 22 "Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv" dhe neni 30 "Arkëtimi i shumave të detyrimeve".*

Në Proçes

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit dhe realizimit të të ardhurave, konstatohet se nga drejtoria e planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Gjirokastër. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI ka dërguar Bashkisë Tepelenë, konstatohet se deri më 30.09.2019, janë posedues të

lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë 24 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 7065 m^2, duke krijuar **të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore, në vlerën 1,106,995 lekë**, sipas listës në aneksin e paraqitur në në fund të Raportit të auditimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016 ñ*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*ò, i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 ñ*Për përcaktimin e mënyrës se mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim*ò i ndryshuar dhe Vendimet e Këshillit të Bashkisë nr. 2, datë 20.01.2017, VKB nr. 41, datë 21.12.2017 dhe VKB nr. 74, datë 28.12.2018 ñ*Për miratimin e taksave dhe tarifat vendore", pika 10, të Bashkisë Tepelenë*ò.

6.1. Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore dhe drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe drejtoria e planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit, në bashkëpunim me ALUIZNI dhe ZVRPP (Agjencia Shtetërore e Kadastrës) Tepelenë të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit **në vlerën 1,106,995 lekë,** sipas listës së paraqitur në aneksin e Raportit të Auditimit.

6.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Ky rekomandim do të konsiderohet në proces pasi nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit janë njoftuar subjektet debitorë me shkresat respektive. Mbas njoftimit të bërë nga Bashkia kanë shlyer detyrimet 3 subjekte në vlerën 28,847 lekë, duke mbetur pa u arkëtuar dhe vlera 1,106,955 lekë.*

Në Proçes

7. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Tepelenë në 16 raste, nuk është arkëtuar detyrimi që rrjedh nga kontratat e lidhura në periudhën 2008-2011, për dhënien me qira nga njësia vendore të tokave bujqësore të pandara, me afat 9 vjet, si dhe nuk janë llogaritur kamat vonesat për çdo ditë vonesë për mosarkëtimin në kohë të detyrimeve, me **pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore në vlerën 961,491 lekë** (principal 304,710 lekë, kamat vonesë 656,781 lekë). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 531, datë 21.8.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, i ndryshuar, UKM nr. 1, datë 18.7.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò, kreu V, pika 1,2,4,5, kërkesat e kontratës së lidhur mes palëve.

7.1 Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore, drejtoria juridike, drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit prej **961,491 lekë,** për 16 kontratat e lidhura për dhënien me qira të tokës bujqësore.

7.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Ky rekomandim do të konsiderohet në proces pasi nga sektori i taksave dhe tarifave vendore janë njoftuar subjektet debitorë me shkresat respektive. Mbas njoftimit të bërë nga Bashkia kanë shlyer detyrimet 8 subjekte në vlerën 103,950 lekë, duke mbetur pa u arkëtuar dhe vlera 857,541 lekë. Në mënyre të përmbledhur paraqiten si më poshtë.*

Në Proçes

Kriteri: Neni 15, germa j) dhe neni 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit*ò; Vendimi nr. 128, datë 24.11.2020, i Kryetarit të KLSH-së, për rikërkimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi në Bashkinë Tepelenë, Shkresa nr. 610/55 Prot., datë. 04.12.2020 ñ*Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Tepelenë*ò.

Ndikimi/Efekti: Mos arkëtimi i detyrimeve për masa shpërblim dëmi në shumën 1,281,616 lekë dhe të ardhura të munguara në shumën 29,795,715 lekë.

Shkaku: Veprime të pamjaftueshme nga ana e strukturave drejtuese.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë,Drejtoria ligjore dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomiktë vazhdojë ndjekja me përgjegjësi e procedurave ligjore, për masat shpërblim dëmi dhe të ardhura të munguara të konsideruara në proces zbatimi, me qëllim arkëtimin e vlerës në buxhetin e bashkisë. Për këtë të ndiqen të gjitha rrugët e mundshme ligjore deri në hapjen e proceseve gjyqësore. Për masat organizative dhe të tjera, nga titullari të monitorohet zbatimi i planit të veprimit dhe personat përgjegjës për zbatimin e tij.

2.6. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit

Drejtimi nr. 6 i Programit të auditimit konsiderohet i paezauruar dhe do të auditohet në auditimin e ardhshëm.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Tepelenë për komponentët dhe implementimin e parimeve të MFK-së, u konstatua se raporti për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të dy vitet e audituara nuk është dërguar në përputhje me kriteret e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar.
U auditua funksionimi i pesë elementëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informimi dhe komunikimi, monitorimi dhe në përfundim të auditimit arrihet në konkluzionin se edhe pse është bërë një punë e mirë në drejtim të plotësimit dhe administrimit të dokumentacionit përkatës sipas kuadrit ligjor, përveç Rregullores së Funksionimit të Brendshëm të Njësisë, nuk është hartuar një paketë e plotë rregullash të tjera të shkruara për të siguruar një funksionim më të mirë të kontrollit të brendshëm.
Mjedisi i Kontrollit: Nga auditimi rezultoi se janë plotësuar pesë parimet e tij.
Menaxhimi i Riskut: Nga auditimi rezultoi se referuar pyetësorit në lidhje me krijimin e mekanizmave për vlerësimin e riskut, raportohet se të gjithë sektorët dhe drejtoritë përkatëse të Bashkisë Tepelenë evidentojnë në përgjithësi risqet. Pavarësisht punës së kryer prej NjAB-së, nuk është kryer një auditim i posaçëm mbi menaxhimin e riskut. Lidhur me komponentët nr. 9 - 13 të cilët i referohen performancës së njësisë publike, raportimit të dobësive dhe të metave të konstatuara nga kontrolli i brendshëm, si dhe masave të marra për mangësitë e vërejtura, rezulton se mbikqyrja e performancës kryhet bazuar në procesverbalet e mbajtura dhe raportet vjetore. Për sa i përket mangësive të konstatuara ato analizohen pjesërisht, pasi **Bashkia Tepelenë nuk disponon një regjistër risku**. veprime të cilat bien ndesh me kërkesat dhe parimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar si dhe Udhezimit nr. 16, datë 20.07.2016 ñ*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".* Të gjitha takimet mbahen me protokoll dhe firmosen nga të gjithë të pranishmit.
Tre parimet e tjera janë plotësuar.
Aktivitetet e Kontrollit: Për sa i përket komponentëve 7 dhe 8 lidhur me regjistrin e aktiveve të njësisë si dhe përditësimin dhe vlerësimin e tyre, rezulton se Bashkia Tepelenë nuk ju është përgjigjur në mënyrë të detajuar këtyre 2 pyetjeve, nëse është ndjekur ose jo aplikimi pranë ASHK-së për të gjitha pasuritë e Bashkisë Tepelenë, si dhe nëse është kryer përditësimi periodik në bazë të Udhëzimit të Ministrise se Financave me nr. 30/2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*ò, i ndryshuar.
Lidhur me parimin nr. 11, rezultoi se Bashkia Tepelenë nuk ka një sistem back-up dhe plan emergjencash i cili të sigurojë vazhdimësinë e veprimeve kundrejt risqeve të ndryshme si ndërhyrja e paautorizuar në të dhënat e Bashkisë, nuk disponohet një rregullore e veçantë që të sigurojë sistemin IT.
Gjithashtu, lidhur me parimin nr. 12, rezultoi se ky komponent ka të bëjë kryesisht me përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit, si për personelin por edhe për rangun drejtues nga ku rezulton se është i pa plotësuar.
Informimi dhe komunikimi:Lidhur me parimin nr. 14, rezultoi se ky komponent është ndarë në 2 pyetje, çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me mënyrën sesi informohen menaxherët dhe personeli i njësisë publike lidhur me vendimet/projektet. Sa më sipër rezulton se këta

komponent janë të pa plotësuar.
Monitorimi:Nga auditimi rezultoi se janë plotësuar dy parimet e tij.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 26-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
1.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, si Kryetar i GMS, si dhe nga Nëpunësi Autorizues dhe Koordinatori i Riskut, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK-në dhe komponentët e tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, si dhe miratimin e gjurmëve të auditimit, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurohen programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Të hartohen dhe të zhvillohen programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit. Të vendoset një sistem komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Tepelenë, u konstatua se NjAB funksionon vetëm me një punonjës.
Nuk janë zhvilluar auditimet në sektorët me risk siç janë prokurimet apo dhe drejtoritë e IMTV-së dhe DPKZH-së. Për sa i përket auditimit i cili duhej të kryej në drejtorinë e DPKZHT-së rezulton se nuk është gjetur mirëkuptimi midis Drejtuesit të DPKZHT-së dhe kësaj njësie.
NjAB ju është përmbajtur pjesërisht objektivave të vendosur prej saj në lidhje me auditimet e kryera, pasi nuk janë audituar çështje me risk të lartë, siç janë prokurimet, lejet e ndërtimit etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 26-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
2.1. Rekomandimi: Nga kryetari i Bashkisë Tepelenë, të merren masa për të plotësuar strukturën e sektorit të auditimit të brendshëm, si dhe të ngrihet një komision i cili të adresojë problemin e refuzimit të auditimit nga drejtori i DPKZHT-së.
Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, të merren masa që në të ardhmen të zbatohen kriteret ligjore dhe nënligjore për auditimin e sektorëve më me risk në Bashkinë Tepelenë, si dhe planifikimi i auditimeve të bëhet duke filluar nga sektorët me risk më të lartë. Gjithashtu, në përfundim të procesit të auditimit në njësitë e audituara, të kryhet monitorimi i zbatimit të rekomandimeve. Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm të vendosë dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit, sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Tepelenë, për vitet 2019 dhe 2020, ka miratuar programin buxhetor me Vendime të Këshillit Bashkiak, brenda afateve ligjore si dhe në fund të viti ushtrimor, ka miratuar realizimin e buxhetit faktik në zbatim të kërkesave të nenit 46, të ligjit nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore".*
Për vitin 2019, buxheti është realizuar në total në masën 96,2% ose nga 335,977 mijë lekë të programuara, është realizuar 323,300 mijë lekë. Zëri investime, llogaria ekonomike 231, është realizuar në masën 86,7% ose nga 37,613 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 32,616 mijë lekë nga të cilat nga të ardhurat e veta në vlerën 3,443 mijë lekë ose 10,5% të totalit të investimeve.
Të ardhurat e veta të programuara, janë 42,099 mijë lekë ose 12,5% të programit buxhetor.
Në buxhetin e vitit, nuk janë programuar si zë më vete, likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditoretë trashëguara nga viti paraardhës që sipas pasqyrave financiare, për vitin 2018 janë në shumën totale 54,927,944 lekë nga të cilat:
- 31,109,492 lekë, llogaritë 401-408 ñ*Furnitorë e llogari të lidhura me to*ò dhe

- 23,818,452 lekë, llogaria 467 ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò.
Për vitin 2020, buxheti është realizuar në total në masën 81.32% ose nga 401,283 mijë të programuara, realizuar 326,235 mijë lekë. Zëri investime, llogaria ekonomike 231, është realizuar në masën 18.2% ose nga 84,585 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 15,421 mijë lekë të gjitha nga fondet e deleguara.
Të ardhurat e veta të programuara, janë 42,500 mijë lekë ose 10.5% të programit buxhetor.
Në buxhetin e vitit, nuk janë programuar si zë më vete, likujdimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës 2019 që sipas pasqyrave financiarë janë në shumën totale 82,305 mijë lekë nga të cilat:
- 26,834 mijë lekë detyrime furnitorë e llogari të lidhura me to, llogaritë 401-408,
- 4,088 mijë lekë detyrime ndaj shtetit për tatim taksa, llogaria 431,
- 11,409 mijë lekë detyrime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore, llogaritë 435 dhe 436,
- 39,974 mijë lekë kreditorë të tjerë, llogaria 467.

Mos programimi si zë më vete në buxhet të detyrimeve të vitit paraardhës, ka sjellë për pasojë rritjen e detyrimeve kreditore dhe përkeqësim të gjendjes financiare, procedurë ***në kundërshtim*** me kërkesat e pikës 101 të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 ñ*Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit*ò, pika 107 e UMF nr. 1, datë 17.01.2019 ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019*ò dhe pika 104 e UMF nr. 2, datë 20.01.2020 ñ*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020*ò.
(Më hollësisht trajtuar në pikat 2.2. dhe 2.3., faqe 30-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
3.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, të marrë masat për përmirësimin e treguesve financiarë duke programuar në buxhetet vjetore si zë më vete detyrimet kreditore të trashëguara si dhe pagesën e tyre në zbatim të kërkesave ligjore.
Të miratojë një program të detajuar mbi zvogëlimin gradual të detyrimeve kreditore, shoqëruar me reduktimin e shpenzimeve të tjera dhe rritje të performancës në vjeljen e të ardhurave lokale.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat për programimin e buxheteve vjetore si dhe analiza mbi gjendjen financiare të Bashkisë Tepelenë, u konstatua se buxhetet nuk kanë qenë të balancuar shpenzimet me të ardhurat dhe gjendja financiare vlerësohet ñ***me probleme financiare***" pasi detyrimet janë mbi 15% të shpenzimeve të programuara referuar përcaktimeve në nenin 55 të ligjit nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, konkretisht:
Për vitin 2019, gjendja e llogarive kreditore është në shumën totale 82,305 mijë lekë, sipas llogarive;
- 26,833 mijë lekë, llogaritë 401-408, ñ*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*ò,
- 4,088 mijë lekë, llogaria 431, ñ*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksat*ò,
- 11,409 mijë lekë, llogaritë 435 dhe 436, ñ*Sigurimet shoqërore* dhe *Sigurimet shëndetësore*ò,
- 39,974 mijë lekë, llogaria 467, ñ*Kreditorët të ndryshëm*ò.

Shpenzimet e programuara vjetore sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Tepelenë, janë në shumën 335,977 mijë lekë. Në këtë rast, detyrimet e konstatuara janë mbi 24% të shpenzimeve të programuara.
Për vitin 2020, gjendja e llogarive kreditore është në shumën totale 58,057 mijë lekë, sipas llogarive;
- 26,767 mijë lekë, llogaritë 401-408, ñ*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*ò,
- 31,290 mijë lekë, llogaria 467, ñ*Kreditorët të ndryshëm*ò.

Shpenzimet e programuara vjetore, sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, janë në shumën 401,283 mijë lekë. Në këtë rast, detyrimet e konstatuara janë 15% të shpenzimeve të

programuara.
Mos programimi i buxheteve vjetorë të balancuara duke mos marrë në konsideratë detyrimet kreditorë të trashëguara në vite si dhe mos marrja e masave të nevojshme për përmirësimin e gjendjes financiare të Bashkisë, ***janë në shkelje të kërkesave*** të nenit 34 të ligjit nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, neni 40/3, germa *"dh"* të ligjit nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore"* dhe pika 101 e UMF nr. 2, datë 06.02.2012 ñ*Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit".*
(Më hollësisht trajtuar në pikat 2.2. dhe 2.3., faqe 30-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
4.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, të marrë masat, të rishikojë buxhetin vjetor me synim përmirësimin e situatës financiare duke programuar pagesën e detyrimeve të trashëguara si dhe për të patur një buxhet të balancuar.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi:Në Bashkinë Tepelenë, për vitin 2020, numri i përgjithshëm i punonjësve dhe niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 91, datë 20.12.2019, e konfirmuar nga Prefekti Gjirokastër me shkresën nr. 1794/1 Prot., datë 06.01.2020, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, në përbërje të së cilës është Sektori i zhvillimit ekonomik, përgjegjës për të ardhurat Vendore. Ky Sektor ka në përbërje 3 punonjës, nga të cilët 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Vendi i Përgjegjësit të sektorit ka qenë vakant për të gjithë periudhën e audituar, duke ndikuar shumë në problematikat e krijuara në lidhje me mënyrën e menaxhimit dhe vjeljes së detyrimeve vendore, përfshirë edhe njoftimet e debitorëve, zbatimin e masave shtrënguese, gjë që ka shkaktuar nivele të larta detyrimesh të pa arkëtuara, si nga biznesi, ashtu edhe nga popullata. Në njësitë administrative nuk ka persona të ngarkuar posaçërisht me vjeljen dhe ndjekjen e taksave e tarifave vendore.
Gjithashtu, struktura e IMTV-së funksionon vetëm me një punojës, ndihmësinspektor dhe nuk ka kryeinspektor, gjë që ka shkaktuar mangësi totale në procedurat që duhet të kryhen me qëllim kontrollin e territorit.
Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015, ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, neni 9 ñ*Të drejtat dhe përgjegjësitë*ò, pika 1.1, germa c); neni 54 ñ*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*ò, germa ç); neni 64, ñ*Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë*ò, germa j); ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, nenet 1, 2, 7, 42, 54, ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, nenet 2, 4, 5, 13, 15, VKB për miratimin e strukturës dhe pagave në Bashkinë Tepelenë, etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 30-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
5.1. Rekomandimi:Këshilli Bashkiak, të marrë masat e duhura për të rishikuar organikën, duke krijuar një strukturë të posaçme tatimore, të veçuar nga struktura e menaxhimit dhe mbledhjes së të ardhurave të tjera, (siç është aktualisht në varësi të drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar), në mënyrë që të mos krijohen mangësi në mbledhje e të ardhurave tatimore dhe të minimizohet numri dhe vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat. Kryetari i Bashkisë Tepelenë, deri në rishikimin dhe miratimin e strukturës së posaçme tatimore nga Këshilli Bashkiak, të marrë masa për të plotësuar vendet vakante në strukturën aktuale, deri në miratimin e strukturës së re nga Këshilli Bashkiak.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi (të dhënat e pasqyrës 2.2.6.1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar), u konstatua se *<u>për vitin 2019</u>,* të ardhurat nga 42,099,000 lekë të planifikuara janë realizuar 35,707,696 lekë, pra me një mosrealizim në shumën 6,391,304 lekë ose 15.2%

dhe *<u>për vitin 2020</u>*, të ardhurat nga 42,500,000 lekë të planifikuara janë realizuar 37,591,480 lekë, pra me një mosrealizim në shumën 4,908,520 lekë ose 11.6%.
Për sa i përket përdorimit të ardhurave, janë përdorur sipas planifikimit buxhetor, ndërsa pjesa e papërdorur është mbartur në buxhetin e vitit pasardhës.
Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 ñ*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*ò i ndryshuar, neni 5, ñ*Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore*ò, neni 54, ñ*Raportimi financiar*ò nënpika c, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për Sistemin e Taksave Lokale*ò, i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar; UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV ñ*Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave*ò pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 30-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
<u>6.1. Rekomandimi:</u> Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, Sektori i zhvillimit ekonomik (tatim-taksa) në Bashkinë Tepelenë gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Disa nga llogaritë kontabël të pasqyrave financiare ***të vitit 2019***, nuk pasqyrojnë gjendjen reale:
- Në formatin nr. 1 ñ*Pasqyra e pozicionit financiar*ò, llogaritë e Aktiveve Afatgjatë materiale; 212- ñ*Ndërtesa e konstruksione*, 213- *Rrugë, rrjete, vepra ujore*, 214- *Instalime teknike, makineri pajisje,* 215- *Mjete transporti* dhe 218- *Inventar ekonomik,* pasqyrojnë gjendjen kontabël me vlerën bruto të tyre dhe jo me vlerën neto çka është ***në kundërshtim*** me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësite e qeverisjes së përgjithshme*ò, Kap. III, pika 60.
Në pasqyrat financiare ***të viti 2020***, kjo shkelje është evituar, në formatin nr. 1 ñ*Pasqyra e pozicionit financiar*ò, llogaritë e Aktiveve Afatgjatë material, janë pasqyruar me vlerën neto të tyre.
-***Për vitin 2019***, nuk janë mbajtur llogaritë e investimeve në proces për shumën totale 34,434 mijë lekë, përkatësisht llogaritë; 230- *Investime për Aktive Afatagjatë jo material* për 1,818 mijë lekë dhe 231- *Investime për Aktive Afatagjatë material,* për 32,616 mijë lekë.
Në këto raste, shumat e investimeve në proces, janë kontabilizuar direkt në llogaritë e investuara duke i konsideruar si investime të përfunduara.
Përsa më sipër, ***janë shkelje e kërkesave*** të Kap. II, pikat 16, 18, 26, Kap. III, pika 60, Kap. IV, pika 100 të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 46-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
<u>7.1. Rekomandimi:</u>Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrë masat për evidentimin e transaksioneve financiare të sipërcituara në llogaritë përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarive kontabël të pasqyrave financiare, konstatohet:

Për vitin 2019.
- Gjendja e llogarive debitore është në shumën totale 135,278 mijë lekë përkatësisht;
Llogaria 468, ñ*Debitorë të ndryshëm*ò për shumën 134,024 mijë lekë e cila është e analizuar për 1052 subjekte juridike dhe persona fizikë nga të cilat për 10,449 mijë lekë janë evidentuar debitorë për tatim taksat lokale nga viti 2008 dhe diferenca debitorë të tjerë nga viti 2013.
Llogari 429, ñ*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*ò për shumën 1,254 mijë lekë, është e analizuar për 43 subjekte debitorë nga viti 2000-2008.
- ***Gjendja e llogarive kreditore*** në pasqyrat financiare të fund vitit është në shumën totale 82,305 mijë lekë.
Nga auditimi u konstatua ***se nuk janë evidentuar si detyrim në llogaritë kreditore në dy raste për shumën 6,663 mijë lekë,*** përkatësisht faturat nr. 38, datë 10.07.2019 subjekti ñN.ò Sh.P.K. dhe nr. 49, datë 04.09.2018 subjekti ñN.ò Sh.P.K.
Llogaritë 401-408, ñ*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*ò për shumën totale 26,834 mijë lekë është e analizuar për 58 subjekte kreditorë nga viti 2016.
Llogaria 431, ñ*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksat*òpër shumën 4,088 mijë lekë, tatim mbi të ardhurat personale për disa mujorë.
Llogaritë 435, 436, ñ*Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore*ò për shumën 11,409 mijë lekë për periudha disa mujore.
Llogaria 467, ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò për shumën 39,974 mijë lekë e analizuar për 19 subjekte kreditorë nga viti 2015.
Për vitin 2020.
- ***Gjendja e llogarive debitore*** është në shumën 136,967 mijë lekë përkatësisht:
Llogaria 468 për shumën 135,713 mijë lekë e cila është e analizuar për 1129 subjekte juridike dhe fizike nga të cilat për 13,412 mijë lekë janë evidentuar debitorë për tatim taksat lokale nga viti 2008 dhe diferenca janë debitorë të tjerë nga viti 2013.
Llogaria 429 për shumën 1,254 mijë lekë.
- ***Gjendja e llogarive kreditore*** në pasqyrat financiare të fundvitit është në shumën totale 58,057 mijë lekë përkatësisht:
Llogaritë 401-408, ñ*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*ò për shumën totale 26,767 mijë lekë është e analizuar për 151 subjekte kreditorë nga viti 2017.
Llogaria 467, ñ*Kreditorë të ndryshëm"* për shumën 31,290 mijë lekë e analizuar për 151 subjekte kreditorë nga viti 2018.
Nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për vjeljen e kërkesave debitore në vite si dhe nuk janë marë masat e duhura për shlyerjen e detyrimeve kreditore ***në kundërshtim*** me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar si dhe UMF nr. 5, datë 27.02.2014 ñ*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*ò, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 46-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
8.1. Rekomandimi: Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, bazuar në kërkesat ligjore, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material analizë për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke përcaktuar radhën e pagesave.
Të procedojë në rrugë gjyqësore ndaj debitorëve, për vjeljen e detyrimeve të krijuara në vite.
Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak

9. Gjetje nga auditimi: U konstatua se për vitin 2019 dhe 2020, janë përgatitur pasqyrat financiare, pa kryer më parë inventarizimin e të gjitha Aktiveve Afatgjata, ***në kundërshtim*** me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò, neni 15, pikat 1 dhe 2, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik*ò i ndryshuar, pika 74 dheUMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për*

*procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, Kap. III, pika 30 dhe Kap. IV, pika 104. Konkretisht, për vitin 2019 dhe 2020, me urdhër të Titullarit të Institucionit, janë ngritur komisionet ñ*Për kryerjen e inventarizimit te aktiveve të qëndrueshme, inventarit të imët dhe materialeve*ò.
Inventarizimi është kryer për llogaritë inventariale 31, ñ*Materiale*ò, 32, ñ*Inventar i imët*ò dhe 218, ñ*Inventar ekonomik*ò.
Nuk janë verifikuar me inventarizim fizik gjendja e llogarive të tjera kontabël të Aktiveve Afatgjatë materiale si:
- Llogaritë 210, ñ*Toka, troje, terrene*ò, e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 145,030,295 lekë, 211, ñ*Pyje, kullota, plantacione*ò, cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 237,999,902 lekë, 212, ñ*Ndërtesa e konstruksione*ò, e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 406,093,379 lekë, 213, ñ*Rrugë, rrjete, vepra ujore*ò, e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 941,072,134 lekë, 214, ñ*Instalime teknike, makineri pajisje*ò, e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 11,738,947 lekë dhe 215, ñ*Mjete transporti*ò, e cila në fund të vitit ushtrimor rezulton për vlerën historike 11,738,947 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 46-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
9.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, të marrë masat e nevojshme, të kryejë inventarin fizik për gjithë asetet në pronësi të saj. Për këtë është e nevojshme të ngrejë komisione me specialistë të fushës.

Brenda vitit 2021

10. Gjetje nga auditimi: Nga testimi i disa llogarive të shpenzimeve, në 3 raste u konstatuan procedura jo të plota në përdorimin e fondeve të vlerësuara me risk, konkretisht:
1- Evidentimi i shpenzimeve për karburant, në disa raste nuk është i plotë, pasi në rastet e shpenzimeve për automjetin e Policisë Bashkiake, të kamionit për transport të dherave dhe mbetjeve urbane si dhe të shpenzimeve të kryera me mjetet e Njësive Administrative, në fletët e udhëtimit, nuk është përcaktuar qëllimi i shërbimit ose objekti i punës si dhe nuk janë të firmosura nga personi udhëtues ose personi që ndjek kryerjen e shërbimit sipas projektit, ***praktikë në kundërshtim*** me pikat 35/b dhe 36 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*ò i ndryshuar.
2- Për vitin 2020, janë alokuar fonde për ñ*Futboll Klub Tepelena*ò me NIPT L32608791F, për 13 raste në shumën totale 4,542,000 lekë, sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 90, datë 20.12.2019.
Nga auditimi i procedurave mbi llogaritjen e fondeve limit për financimin e aktivitetit të ñ*Futboll Klub Tepelena*ò, të paraqitur për miratim në Këshillin e Bashkisë, konstatohet se nuk ka analiza dhe preventiv për mënyrën e llogaritjes së këtij fondi.
Në këtë rast, ***nuk janë zbatuar kërkesat*** e neneve 8, 19, 39 të ligjit nr. 79/2017 ñ*Për sportin*ò, i ndryshuar dhe VKM nr. 1720, datë 29.10.2008 ñ*Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sporteve që i arrijnë këto nivele si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sporteve*ò.
3- Me Vendimin nr. 22 datë 02.04.2020 të Këshillit Bashkiak ñ*Për trajtimin me bonus qiraje për familjet në nevojë të cilat nuk mund ta përballojnë qiranë e tregut të lirë*ò, janë miratuar për të përfituar financiarisht 44 familje. Vendimi miratues, është referuar në mbështetje të ligjit 139/2015 ñ*Për vetqeverisjen vendore*ò, ligjit 22/2018 ñ*Për strehimin social*ò si dhe akteve të tjera nënligjore.
Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020, janë paguar bonus qira banese për ***27 raste në shumën totale 2,411,800 lekë.***
Pagesa është përballuar tërësisht nga fondet buxhetore pa kontributin e Bashkisë Tepelenë, ***në kundërshtim*** me kërkesat e pikave 2, 3 të VKM nr. 459, datë 3.07.2019 ñ*Për rregullat për*

*Administrimin e kërkesave të Vetëqeverisjes Vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvensionimin e qirasë ose uzurfruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehimin*ò.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 46-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
10.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masat e nevojshme me qëllim përmirësimin e procedurave ligjore për mirë menaxhimin e fondeve publike për rastet e sipërcituara.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të fund vitit 2020, gjendja e llogarisë 466 *"Kreditorë për mjetet në ruajtje*ò, sipas analizës të rakorduar me Degën e Thesarit Tepelenë, është për ***vlerën 3,294,275 lekë***, e analizuar sipas objekteve për 11 raste.
Nga analiza e përmbajtjes së kësaj llogarie, konstatohet së për 3 objekte në shumën 1,310,514 lekë ***gjenden në ngurtësuara fonde nga viti 2018*** për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës dhe nuk është bërë zhbllokimi i tyre.
Drejtoria e Financës, nuk ka kryer asnjë veprim, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me Subjektet Sipërmarrëse, për zhbllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin për interes publik.
Përsa më sipër, ***nuk janë zbatuar kërkesa***t e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 ñ*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*ò i ndryshuar, Kap. II, pika 10.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 46-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
11.1. Rekomandimi: Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar fondet si garanci për punimet e kryera dhe për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës.
Të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Tepelenë për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Brenda datës 31.12.2021

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratave me nr. 895/3 prot., datë 25.06.2019, me objekt ñ*Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit), Bashkia Tepelenë*ò dhe me nr. 1185/4 prot., datë 06.11.2020, me objekt ñ*Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit), Bashkia Tepelenë*ò, nuk është dhënë leja e ndërtimit, në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 ñ*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*ò, neni 39, ñ*Leja e ndërtimit*ò.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 65-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
12.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa që para fillimit të punimeve, të shqyrtohen të dhënat teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes nga auditimi i fundit i kryer në Bashkinë Tepelenë, KLSH ka njoftuar Bashkinë Tepelenë me shkresën nr. 610/55 Prot., datë. 04.12.2020 ñ*Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Tepelenë*ò. Bashkia Tepelenë për zbatim e rekomandimeve të KLSH, ka kthyer përgjigje brenda afatit prej 20 ditësh nga data e shkresës për zbatimin e rekomandimeve. Rekomandimet janë raportuar në Këshillin Bashkiak dhe në VKB-në nr. 14, datë 26.02.2021, me nr. 408/3 Prot., datë 01.03.2021, ñ*Për miratimin e raportit vjetor të*

*zbatimit të buxhetit për vitin 2020*ò, në pikën I, germa c) është përfshirë edhe raporti mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. Nga verifikimi i zbatimit të detyrave të lënë nga auditimi i fundit, për rikërkimin e zbatimit të rekomandimeve, u konstatua se nga 6 Masa Organizative të rikërkuara për zbatim 1 masë është zbatuar plotësisht dhe 5 masa vazhdojnë të jenë në proces zbatimi; nga 2 masa për shpërblim dëmi të ri kërkuara, të dyja vazhdojnë të jenë në proces, por nuk është arkëtuar detyrimi dhe nuk kanë filluar procedimet gjyqësore për vlerën **1,281,616 lekë** nga zbatimi i kontratave ñ*Rikonstruksion i qendrës së fshatit Veliqot*ò, Bashkia Tepelenë, për vlerën **456,518 lekë** pa T.V.Sh. dhe ñ*Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatin Luzat NjA Qendër*ò, Bashkia Tepelenë, për vlerën **825,098 lekë** pa T.V.Sh.; 1 masë për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike e rikërkuar vazhdon të jetë në proces; 7 masa të rikërkuara për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), vazhdojnë të jenë në proces. Aktualisht, nga totali prej **31,578,552 lekë** është arkëtuar vlera totale prej **1,811,644 lekë** dhe ka mbetur për tû arkëtuar vlera **29,795,715 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 75-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë,Drejtoria ligjore dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomiktë vazhdojë ndjekja me përgjegjësi e procedurave ligjore, për masat shpërblim dëmi dhe të ardhura të munguara të konsideruara në proces zbatimi, me qëllim arkëtimin e vlerës në buxhetin e bashkisë. Për këtë të ndiqen të gjitha rrugët e mundshme ligjore deri në hapjen e proceseve gjyqësore. Për masat organizative dhe të tjera, nga titullari të monitorohet zbatimi i planit të veprimit dhe personat përgjegjës për zbatimin e tij.

Brenda 6 muajsh nga data e Raportit Përfundimtar të Auditimit

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 ñ*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*ò, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, dhe pikën 93, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò, nga ana e Titullarit të njësisë publike Bashkia Tepelenë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi Zbatues të ndiqet procesi me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 4,934,957 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Tepelenë ushtrojnë aktivitetin 5 subjekte të cilat tregtojnë hidrokarbure, karburante. Subjekte të licencuar për tregtimin e lëndëve djegëse nuk ka. Subjektet A. Sh.P.K. dhe Skënderi-G Sh.P.K. nuk e ushtrojnë më aktivitetin, pasi janë prishur për shkak të ndërtimeve të infrastrukturës. Subjektet K. Sha, B. Sh.P.K. dhe A. Sh.P.K. vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet të papajisur me autorizimet përkatëse, ndërsa subjektet O. Sh.P.K. dhe K. Sh.P.K. vazhdojnë aktivitetin ndërsa pagesat e autorizimit janë bërë të pjesshme dhe do të vazhdojnë të shlyhen me këste për një periudhë 5 vjeçare.

Pagesat e pakryera deri në momentin e auditimit dhe vlerat debitore, të cilat pavarësisht se në disa raste është rënë dakord që të paguhen me këste, gjithsesi përbëjnë detyrime të pa arkëtuara dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Tepelenë janë paraqitur në Anekse, **Pasqyra 2.2.6.30**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në vlerën **4,400,000 lekë** e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Tepelenë.

Sa më sipër, është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa ñbò, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 30-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për paisje me autorizime, për shumën debitore prej **4,400,000 lekë,**sipas Anekseve,**Pasqyra 2.2.6.30** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik, të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñ*Pastrimi i rezervuarit dhe rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj*ò, Bashkia Tepelenë, me vlerë të kontratës (me T.V.Sh.) 11,966,064 lekë, me kontraktor ñSh.ò Sh.P.K., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 393,306 lekë pa T.V.Sh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 895/3 prot., datë 25.06.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë dhe kontraktorit ñSh.ò Sh.P.K.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 65-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **393,306lekë pa T.V.Sh.** nga kontraktori ñSh.ò Sh.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 895/3 prot., datë 25.06.2019, me objekt ñ*Pastrimi i rezervuarit dhe rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj*ò, Bashkia Tepelenë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñ*Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit)*ò, Bashkia Tepelenë, me vlerë të kontratës (me T.V.Sh.) 20,899,027 lekë, kontraktuar me ñSh.ò Sh.P.K., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 141,651 lekë pa T.V.Sh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1185/4 prot., datë 06.11.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë dhe kontraktori ñSh.ò Sh.P.K.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 65-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **141,651 lekë pa T.V.Sh.** nga kontraktori ñSh.ò Sh.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1185/4 prot., datë 06.11.2020, me objekt ñ*Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit)*ò, Bashkia Tepelenë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i kontratave të qirasë për terrenet shtetërore (troje, lulishte, trotuare, etj.), u konstatua se për vitin 2019 janë lidhur gjithsej 21 kontrata, me të ardhura të pritshme në vlerën 3,013,157 lekë, ndërsa për vitin 2020, janë lidhur 20 kontrata, shuica e të cilave ekzistuese nga viti 2019, me të ardhura të pritshme në vlerën 2,831,157 lekë. Gjatë vitit 2019 janë arkëtuar 2,786,697 lekë ndërsa gjatë vitit 2020 janë arkëtuar 1,487,611 lekë. Diferenca prej **1,570,006 lekë**, (226,460 lekë nga viti 2019 dhe 1,343,546 lekë nga viti 2020), përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë.
Gjatë viteve 2019 dhe 2020, në Njësinë Administrative Lopës, pjesë e Bashkisë Tepelenë janë lidhur gjithsej 30 kontrata qiraje për tokë bujqësore, me afat nga 6 muaj, deri në 1 vit. Nga auditimi i kontratave, u konstatua se nuk kanë paguar detyrimet 2 qiramarrës për vitin 2019, në vlerën totale 20,000 lekë dhe 11 qiramarrës për vitin 2020, në vlerën totale 269,600 lekë. Vlera prej **289,600 lekë** (20,000 lekë nga viti 2019 dhe 269,600 lekë nga viti 2020), përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, nga mos vjelja e qirasë së tokave bujqësore në Njësinë Administrative Lopës.
Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 ñ*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*ò i ndryshuar; ligjin nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò; ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 ñ*Për tokën*ò, i ndryshuar; ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, ñ*Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*ò, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për tôu lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò, etj.
Për vlerat debitore nga Bashkia Tepelenë nuk janë llogaritur kamatëvonesat, sipas kërkesave të kontratës tip dhe VKM-së nr. 373, datë 20.06.2018, ñ*Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*ò, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò, etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 30-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
<u>1.1. Rekomandim:</u>Sektori i zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa) në Bashkinë Tepelenë, në bashkëpunim me Njësitë Administrative dhe Drejtorinë ligjore dhe të shërbimeve organizative, të marrin masa për të nxjerrë njoftim-vlerësimet për detyrimet e papaguara nga qiramarrësit e listuar në pasqyrat 2.2.6.5 dhe 2.2.6.6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në vlerën **1,859,606 lekë,** duke llogaritur kamatëvonesat dhe sanksionet e tjera përkatëse (nëse ka), për secilin rast, si dhe të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara, për të gjitha detyrimet kontraktuale të pa mbledhura.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara, u konstatua se gjatë vitit 2019, nuk e kanë paguar këtë taksë 3 persona, në vlerën totale 21,772 lekë dhe gjatë vitit 2020 nuk e kanë paguar 5 persona në vlerën totale 99,143 lekë.
Vlera prej **120,915 lekë** (21,772 lekë për vitin 2019 dhe 99,143 lekë për vitin 2020) përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, nga mos vjelja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, ñ*Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*ò i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar; VKB Tepelenë ñ*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Tepelenë*ò, etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 30-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
2.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë nëpërmjet bashkëpunimit institucional tëi kërkojë ASHK-së, Drejtoria Tepelenë, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Tepelenë. Drejtoria e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga individët e listuar si debitorë në Pasqyrat 2.2.6.9. dhe 2.2.6.10, bazuar në legjislacionin tatimor.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Numri i debitorëve nga biznesi si në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesat përkatëse), nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu fund të vitit 2019 numri i debitorëve ishte 197 subjekte në vlerën 10,341,288 lekë, ndërsa në fund të vitit 2020 numri i debitorëve ishte 247 subjekte në **vlerën 13,364,487 lekë**. Kamatëvonesa për këtë shumë detyrimesh është në **vlerën 2,926,822 lekë.** Vlera debitore për vitin 2020 ka qenë 3,023,199 lekë, e cila përfaqëson taksat dhe tarifat vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Tepelenë.
Nga auditimi i pagesave të kryera nga institucionet që operojnë në Bashkinë Tepelenë, u konstatuan detyrime të pa vjela nga 4 institucione, në vlerën **499,741 lekë**, konkretisht 343,600 lekë detyrime dhe 75,248 lekë kamatëvonesa për periudhën 2012-2019 dhe 66,360 lekë detyrime dhe 14,533 lekë kamatëvonesa për vitin 2020).
Vlera prej **16,791,051 lekë** (13,364,487 lekë detyrime dhe 2,926,822 lekë kamatëvonesa nga biznesi dhe 409,960 lekë detyrime dhe 89,781 lekë kamatëvonesa nga institucionet), përbën të ardhura të munguara (borxh tatimor) për buxhetin e Bashkisë Tepelenë.
Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore*ò, me ndryshime, Kreut XI, ñ*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*ò, ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 ñ*Kodi Penal i RSh*ò me ndryshime neni 181, ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, i ndryshuar neni 9 ñ*Të drejtat dhe përgjegjësitë*ò pika 1.3., neni 35, ñ*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*ò, ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 30-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
3.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pavjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj 247 subjekteve dhe 4 institucioneve në vlerën prej **16,791,051 lekë***(sipas **Pasqyrave** në Anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit)*, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:
a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.
b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).
c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të

angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.
Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Tepelenë, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave për taksën e tokës bujqësore, u konstatua se rezulton një numër mjaft i madh i familjeve debitore për taksën e tokës, gjithsej 2,292 familje, për një vlerë totale **10,468,765 lekë**, konkretisht 5,008,132 lekë për NjA Qendër, 2,176,081 lekë për NjA Kurvelesh dhe 3,284,552 për NjA Lopës, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë.
Regjistrat e familjeve fermere, duhet të ishin përditësuar sipas të dhënave që duhet të disponojë ZAMT në Bashki, nga ZAMT në Qark apo nga AKSH Tepelenë për numrin e familjeve që kanë përfituar tokë në bazë të ligjit për ndarjen e tokës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, nenet 23 dhe 24.
Referuar akt-rakordimeve të bashkisë Tepelenë me UK sha Tepelenë, rezulton se për periudhën objekt auditimi për <u>taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit,</u>**vlera debitore është 3,979,274 lekë**, e ndarë në 1,138,711 taksë ndërtese dhe 2,840,563 lekë tarifë pastrimi, ku debia për taksën e ndërtesës është 540,711 lekë për vitin 2019 dhe 598,000 lekë për vitin 2020, ndërsa debia për tarifën e pastrimit është 1,388,563 lekë për vitin 2019 dhe 1,452,000 lekë për vitin 2020.
Nga auditimi i pagesave për taksat dhe tarifat vendore nga familjarët, u konstatua se këto detyrime llogariten vetëm për Njësinë Adminstrative Tepelenë, pasi për NjA Qendër, Kurvelesh dhe Lopës, për periudhën objekt auditimi 2019-2020 nuk është planifikuar dhe realizuar e ardhura nga **taksa e ndërtesës** dhe **tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit** për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sha Tepelenë, pasi kanë munguar të dhënat nga Administratorët e Njësive Administrative se bashku me Kryetarët e Fshatrave, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë detyrimet vendore.
Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 30-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
<u>4.1. Rekomandimi:</u>Bashkia Tepelenë, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për të hartuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marrë nga institucionet përgjegjëse (AKSH Tepelenë dhe Qarku Gjirokastër). Për familjet fermere debitore të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën e papaguar për vlerën **10,468,765 lekë** dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.
<u>4.2. Rekomandimi:</u>Bashkia Tepelenë, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore,

të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerave debitore. Gjithashtu Bashkia Tepelenë të bashkëpunojë me UK sha për arkëtimin e vlerës debitore prej **3,979,274 lekë** dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative këtij agjenti tatimor.

4.3. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Tepelenë, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRRT-në, ASHK-në, etj.), për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Sektorit të zhvillimit ekonomik, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit, të pajisur me leje ndërtimi nga Bashkia Tepelenë 6 subjekte, nga të cilët 3 prej tyre nuk kanë paguar detyrimet vendore në vlerën totale **75,360 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Tepelenë.

Nga detyrimet vendore të papaguara prej kontraktorëve të punëve civile të cilët zbatojnë investimet e ndryshme në territorin e Bashkisë Tepelenë rezulton një vlerë debitore prej **1,981,440 lekë,** e cila përbën të ardhura të munguara (borxh tatimor) për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit pa e regjistruar adresën sekondare dhe mospagimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore*ò neni 40, ñ*Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare*ò, pika 1, neni 43 ñ*Përditësimi i të dhënave të regjistrimit*ò pika 1/1; ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 ñ*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*ò, i ndryshuar, neni 22, ñ*Detyrimi për regjistrim*ò, pika 4; ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar; ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, VKB, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 30-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit që kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokuruara për vitet 2019-2020, pavarësisht nëse kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Tepelenë dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, si dhe të nxjerrin njoftim detyrimet për taksat dhe tarifat vendore. Sipas listimit në Anekse, Pasqyrat 2.2.6.26., 2.2.6.28. dhe 2.2.6.29, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të ndjekin të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës totale **2,056,800 lekë** nga këto detyrime vendore**.**

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 1185/4 prot., datë 06.11.2020 me objekt *"Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (pastrimi i rezervuarit), Bashkia Tepelenë,* me vlerë të kontratës (me T.V.Sh.)20,899,027 lekë, kontraktuar me ñSh.ò Sh.P.K., rezultoi se është bërë çmontimi dhe largimi i një tubacioni me Ø 609.6 mm x 6.3 mm, me vlerë të situacionuar 2,296,800 lekë pa T.V.Sh., si tubacion i amortizuar dhe jashtë funksionit. Çmontimi dhe largimi i këtij tubacioni, pas konstatimit si i amortizuar, i bllokuar

dhe jashtë funksionit, ishte i panevojshëm, pasi vlera e skrapit, nëse do të ishte shitur, është më e vogël se shpenzimet e kryera dhe për pasojë është rritur kostoja e objektit me vlerën **2,296,800 lekë**.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 65-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
6.1. Rekomandimi: Titullar i njësisë vendore të analizojë, të nxjerrë përgjegjësitë për efektin negativ që ka sjellë realizimi i panevojshëm i këtij zëri pune dhe të marrë masa që për marrjen në dorëzim të projekteve të realizuara në Bashkinë Tepelenë, të ngrejë grupe pune të specializuara, në mënyrë që të implementohen projekte cilësore dhe sa më afër gjendjes reale.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 895/3 prot., datë 25.06.2019 me objekt *"Pastrimi i rezervuarit dhe rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj, Bashkia Tepelenë*",me vlerë të kontratës (me T.V.Sh.) 11,966,064 lekë, kontraktuar me "Sh.P.K., rezultuan se punimet kanë përfunduar 34 ditë jashtë afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, duke përfshirë edhe amendamentin e kontratës nr. 895/7 prot., datë 23.09.2019, i cili ka bërë shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 45 ditë. Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se nuk janë mbajtur penalitete për vonesa në përfundimin e punimeve në masën **481,562 lekë** (0.004 x 34 ditë x 3,540,900 lekë (pjesa e mbetur e kontratës, deri në përfundim të afatit kontraktual të punimeve).
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 65-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
7.1. Rekomandimi: Titullari i AK të marrë masa që për kontratat publike, të caktojë nëpunës për monitorimin e kontratës, i cili të pasqyrojë gjendjen faktike të realizimit të kontratës, cilësinë e punimeve dhe grafikut të punimeve, para certifikimit të punimeve të realizuara. Gjithashtu, të nxjerrë përgjegjësitë për efektin negativ prej **481,562 lekë**, që ka sjellë mosrespektimi i nenit 27 të kontratës, që ka të bëjë me penalitetet për shkak të vonesave në përfundimin e punimeve sipas afatit kontraktual, me qëllim që objektet të realizohen për të shërbyer komunitetit në kohë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE.

Në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë, për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil:
Mbështetur në nenin 15, shkronja (c), të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nenin 58 të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë**, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën (*01.01.2019 deri 31.12.2020*), të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për punonjësit e mëposhtëm:

Për probleme të komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve e afatgjata materiale, i ngritur me urdhër të titullarit, si më poshtë vijon;

1. ***Z. S. K.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar;*
2. ***Znj. M. N.***, me detyrë Specialiste Finance;

Për problematikat e konstatuara në lidhje me auditin e brendshëm dhe Menaxhimin Financiar e Kontrollin, si më poshtë vijon;

3. ***Z. S. K.**,* me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit

Financiar;

4. ***Znj. J. K.***,me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative;
5. ***Znj. A. S.***, specialiste e auditimit të brendshëm;
6. ***Z. L. B.***, me detyrëDrejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit
7. ***Z. S. S.***, me detyrë Drejtor i Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare, Mjedisore

Për mangësi në zbatimin e përgjegjësive të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e ligjitnr. 114/2015 datë 06.11.2015 ñ*Për auditimin e Brendshëm në Sektorin publik*ò, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñ*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*ò, ñ*Manualittë auditimit të brendshëm*ò i miratuar me urdhërin e ministrit të financave me nr. 100, datë 25.10.2016 ñ*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*ò.

<u>Për problematikat e konstatuara në lidhje me të ardhurat, si më poshtë vijon;</u>

8. ***Z. G. G.***, me detyrë Specialist në Sektorin e zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa);
9. ***Z. R. H.***, me detyrë Specialist në Sektorin e zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa).

Për mos zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 ñ*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*ò i ndryshuar; Ligjit nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò; Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 ñ*Për tokën*ò, i ndryshuar; Ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, VKM-sënr. 531, datë 21.08.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM-sënr. 373, datë 20.06.2018, ñ*Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*ò, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për tôu lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM-sënr. 54, datë 5.2.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò; UKM-sënr. 1, datë 18.07.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò, etj.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT